

# STRATEGJIA RAJONALE E ZHVILLIMIT TE QARKUT TE FIERIT

NË PËRPUTHJE ME OBJEKTIVAT E MIJËVJEÇARIT  
DHE STRATEGJINË KOMBËTARE  
PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK E SOCIAL



**Ky raport u përgatit me ndihmën e:**

Znj.Vasilika Kume, Z. Sabri Llaci, Z. Eno Dodbiba/ ECAT,  
Znj. Manuela Murthi, Znj.Edlira Haxhiymeri, Znj. Ilir Gëdeshi  
and Z.Mihallaq Qirjo/ REC.

## Parathënie

**S**trategjia e Zhvillimit Rajonal (SZHR) të Qarkut të Fierit përfaqëson një dokument të rëndësishëm jo vetëm për administratën e Këshillit të Qarkut apo komunat e bashkitë, por shumë me gjerë, me pretendimin që të bëhet e vlefshme dhe konkrete për gjithë komunitetin e Qarkut, mbasi ky i fundit do të jetë edhe përfituesi masiv i saj. Me këtë synim janë përcaktuar drejtimit dhe tendencat e zhvillimit e ç'ka është më e rëndësishme rrugët, mënyrat dhe kohët e përshtatshme të realizimit.

Hartimi i SZHR, si një proces shumë delikat dhe shumë i vështirë, nuk mund të arrihej pa angazhimin maksimal të aktorëve pjesëmarrës, të cilëve dua t'u dedikoj titullin e këtyre rrjeshtave dhe përgëzimet për kontributin e paçmuar të tyre.

Komuniteti, përfaqësuesit e institucioneve dhe të shoqërisë civile me angazhimin maksimal kanë demonstruar njëherazi një përgjegjësi të lartë qytetare, duke merituar pa hezitim respektin dhe ndjenjën e mirënjohjes.

Me SZHR Qarku ynë shkëputet përfundimisht nga politika tashmë e kapërcyer e punëve emergjente, duke synuar cilësi në realizimet përmes planifikimeve afatmesme dhe afatgjate dhe njëherazi mundësi të besueshme investimi e që padyshim garantojnë një të ardhme të qartë e positive.

Kjo shkon në harmoni me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim Social Ekonomik dhe Procesin e Stabilizim-Asocimit me Bashkimin European.

Falenderojmë Qeverinë Shqiptare për dokumentin e rëndësishëm që na kanë vënë në dispozicion dhe për oponencën e vlefshme të eksperteve të dikastereve të saj për SZHR e Qarkut tonë.

SZHR është në linjë me Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit, madje identifikimi i objektivave të zhvillimit në Qark dhe përcaktimi i programeve parësore janë realizuar mbështetur te ky dokument me vlera e që na vjen në kohë.

Do veçoja edhe përkushtimin dhe profesionalizmin e grupit kryesor të specialistëve të Këshillit të Qarkut të Fierit dhe atyre të PNUD/LGP, puna e të cilëve nuk do arrinte parametrat e kërkuara, që jam i sigurt që ky dokument i disponon, pa angazhimin e zotërinjve Shaqir Kurti e Roberts M. Losslo.

Komisioni Këshillor, Grupi "Task force" i përbërë nga të zgjedhur të pushtetit vendor, grupi koordinues i përbërë nga OJF-të aktive në Qark, mediat vizive e të shkruara, Këshilli i Qarkut Fier, institucionet rajonale dhe Prefektura Fier, ekspertet rajonale, kombëtare dhe ata të huaj, instituti për Kooperim dhe Bashkëpunim drejtuar nga deputetet e zgjedhur në Qarkun Fier Z. Kastriot Islami e Ylli Bufi dhe gjithë publiku që ka reflektuar përgjegjësi dhe nivel të admirueshëm angazhimi e rezultati, të gjithë së bashku përfaqësojmë atë elitë, ndaj së cilës unë personalisht dhe bashkëpunëtorët e afërt në hartimin e Strategjisë do të ndjehemi kurdoherë të detyruar.

Nëse sot kemi në dorë këtë dokument, nëse ky disponon vlera dhe nëse këto vlera do reflektohen në praktikë, e për këtë jemi të sigurt, padyshim kjo i dedikohet bashkëpunimit me PNUD-in dhe mbështetjes profesionale dhe pa rezerva të përfaqësuesve të tij.

**Illir Dano**  
Head Fier Regional Council  
September 2003

--	--

## Parathënie

**N**ë Samitin e Mijëvjeçarit të Kombeve të Bashkuar në Shtator 2000, udhëheqësit botëror e vendosën zhvillimin në zemër të axhendës globale duke adaptuar Deklaratën e Mijëvjeçarit. Kjo deklaratë përmëban një bashkësi angazhimesh globale, Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM), për pesëmbëdhjetë vitet e para të shekullit 21. Një numër i madh vendesh, duke përfshirë Shqipërinë, kanë premtuar të ndërmarrin gjithçka është e nevojshme për të arritur këto objektiva.

Gjatë dy viteve të fundit, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara është vënë në krye të procesit për të ndërtuar një mbështetje politike mbi OZHM. Pakti global mbi OZHM kërkon për botën në zhvillim që të skicohen plane, dhe të krijohen sisteme dhe të përcaktohen fonde për arritjen e OZHM. Në Shqipëri, UNDP përgëzon përpjekjet e qeverisë për të integruar Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit në të gjitha strategjitë kryesore kombëtare, një detyrë që është bërë akoma më e fokusuar qëkur Kuvendi i Shqipërisë kaloi një rezolutë mbi Deklaratën e Mijëvjeçarit në Korrik 2003. UNDP ndihmon gjithashtu në krijimin e sistemeve të përgjegjshmërisë dhe të mobilizimit të burimeve për OZHM. Brenda mandateve të tyre specifike, agjensi të tjera të OKB-së po punojnë mbi një numër objektivash; të gjitha agjensitë po ndihmojnë qeverinë për të përmbushur kërkesat e raportimit.

Objektivat dhe synimet ndihmojnë individët, grupet, kombet dhe organizatat ndërkombëtare të punojnë bashkë në mënyrë më të fokusuar dhe të koordinuar. Megjithatë për të qënë domethënës në kontekstin vendor, këto objektiva duhet të përshtaten sipas çdo situatë specifike zhvillimi. Bazuar në parimin se përfshirja e komuniteteve lokale është e detyrueshme për një zhvillim të qëndrueshëm afat-gjatë, UNDP, në bashkëpunim me autoritetet rajonale ka provuar – në këtë Strategji Rajonale të Zhvillimit të Fierit – dobinë e OZHM si një tregues për përparim real dhe konkret. Në një ushtrim që zgjati gjysëm viti, i gjithë procesi i përgatitjes u drejtua nga Këshilli i Qarkut bashkë me ekspertët lokalë dhe u aprovua përmes përfshirjes së qytetarëve nga të gjitha rrethet e qarkut.

Ka ardhur koha për të bërë një zhvillim ndryshe, më të fokusuar, më të koordinuar dhe më të përgjegjshëm. Besoj se Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit sigurojnë një mundësi të jashtëzakonshme për të bërë pikërisht këtë.

**Anna Stjærnerklint**  
Përfaqësuese e Përhershme  
UNDP, Shqipëri

--	--

## Falenderim

Ne, qytetaret e Qarkut Fier, kemi kultivuar Strategjine Rajonale Fier (SZHR) ne perputhje me Strategjine Kombetare per Zhvillim Social Ekonomik (SKZHSE) edhe ne linje me Objektivat e mijeveçarit. Kjo ndermarrje eshte nje hap perpara jo vetem per vizionin tone rajonal me nje te ardhme vertet te frytshme dhe te sigurte, por edhe nje progres drejt vizionit tone kombetar. Objektivi i saj eshte te japë nje kuader per zhvillim te qendrushem per rajonin dhe te mbeshtesi futjen e Shqiperise ne Bashkimin Europian. Strategjia jone do te udheheqi aktivitetet per zhvillim ne arritjen e vizionit per te ardhmen dhe drejt permiresimit te kushteve te jeteses se qytetareve tane.

Nepermjet nje bashkepunimi me Qeverine Shqiptare, fieraket dhe Programi i Kombeve te Bashkuara per Zhvillim (PNUD), pergatiten kete strategji qe eshte nje eksperience mjaft pozitive duke strukturuar objektivat rajonale ne nje vizion afatgjate, duke i shnderruar ne nje platforme te qendrushme per te rritur interesin dhe burimet ne zbatimin e programeve dhe identifikimin e problematikave qe duhet te gjejne zgjidhje ne Qarkun Fier.

Qe nga viti 2001 Keshilli i Qarkut ka filluar pergatitjen e bazes se te dhenave dhe nje sere informacionesh te pergjithshme qe pershkruajne situaten dhe zhvillimi e sektoreve te veçante. Ne mes te vitit 2002 Programi i Qeverisjes Vendore PNUD filloi mbeshtetjen e tij per hartimin e strategjise, duke punuar se bashku me Seksin e Programim Zhvillimit ne Qark.

Drejtimi pjesemarrës i perdorur per pergatitjet e strategjise perfshiu nje sere takimesh konsultuese me aktore lokal dhe kombetar per te identifikuar zonat prioritare objektivat, synimet dhe programet. Mbledhjet e hapura me publikun, perfshire edhe nje sondazh, dhane opinionin e qytetareve per perspektiva dhe prioritete te pergjithshme per zhvillimin rajonal. Jam i ndergjegjishem qe kjo Strategji perfaqeson pikepamjet dhe interesat e te gjithëve sektoreve te shoqerise ne rajon.

Shpresoj qe ju do ta lexoni kete raport me kujdes pasi permban dy pjese kyçe informuese. Fillimisht permban nje analize social-ekonomike ne Qark. Se dyti dhe me e re desishme ajo prezanton strategjine qe vendos synimet dhe propozon nje sere programesh per te ndihmuar procesin reformues, duke dhene nje liste treguesish qe do te perdoren per te matur zhvillimin.

Strategjia Rajonale e Fierit eshte nje proces dinamik. Monitorimi dhe zbatimi i saj duhet te vazhdoje te kete pjesemarrjen e aktoreve dhe qytetareve. Nje proces i vazhdueshem konsultues do te sjelle rekomandime shtese qe do te pershtatin Strategjine me situata te reja dhe kerkesa nga komuniteti. Sondazhet dhe studimet qe do te ndermerren do te sjellin nje informacion me te sakte e dhe do te lejojne nje analize me te thelle te situates. Kjo do te siguroje mungesat e raportit te pare per shkak te te dhenave qe evoluojne e plotesohen me tej gjate zbatimit se kesaj strategjie.

Ne e vleresojme mbeshtetjen e PNUD-it ndaj Keshillit te Qarkut per te qene nje strukture qeverisese lokale efektive dhe efçente. Presim te vazhdojme dhe ta zgjerojme partneritetin tone per nje periudhe te gjate.

Suksesi vjen nga vullneti i shumices dhe une jam i vendosur qe ne, qarku i Fierit do te arrijme ate. Strategjia Rajonale e Zhvillimit shenon fillimin e nje procesi te gjate per zhvillimin. Ne kemi arritur kete plan duke punuar se bashku dhe duke hapur rruget e komunikimit. Ky proces do te jete i suksesshem vetem nese ne, Qeveria, OJF-t, komuniteti, shoqeria civile dhe aktore te tjere vazhdojne te bashkepunojne. I mirepres kontributet dhe mbeshtetjen nga te gjithë partneret qe punojne per zhvillim te na ndihmojne te ndertojme kete strategji dhe ta bejne vizionin per Fierin nje realitet.

## Akronime

<b>OBK</b>	Organizata me baze komuniteti
<b>DHTI</b>	Dhoma e Tregtise dhe Industrise
<b>KEDKG</b>	Konventa mbi Eleminimin e te Gjitha Formave te Diskriminimit kunder Grave.
<b>ZNHKE</b>	Zyra e Ndhemes Humanitare te Komisionit European
<b>SIM</b>	Sistemet e Informacionit Mjedisor
<b>BE</b>	Bashkimi European
<b>MFG</b>	Masat e Fuqizimit te Gruas
<b>IZhNj</b>	Indeksi i Zhvillimit Njerezor
<b>PBP</b>	Prodhimi i Brendshem i Pergjithshem
<b>SGJI</b>	Sistemet Gjeografike te Informacionit
<b>RZhNj</b>	RAPORTI I ZHVILLIMIT NJEREZOR
<b>ITI</b>	Informacioni dhe Teknologjia e Informacionit
<b>INSTAT</b>	Instituti i Statistikave
<b>IShP</b>	Instituti i Shendetit Publik
<b>PVML</b>	Plani i Veprimit Mjedisor Lokal
<b>PQV</b>	Programi i Qeverisjes Vendore
<b>OZhm</b>	Objektivat e Zhvillimit te Mijevjecarit
<b>MeSh</b>	Ministria e Shendetesise
<b>MeRrTT</b>	Ministria e Rregullimit te Territorit dhe Turizmit
<b>KShAM</b>	Kuadri i Shpenzimeve Afat Mesem
<b>OJF</b>	Organizatat Jo Fitimprurese
<b>SKZhES</b>	Strategjia Kombetare e Zhvillimit Ekonomik dhe Social
<b>OSBE</b>	Organizata per siguri dhe Bashkepunim ne Europe
<b>PBAI</b>	Pikat Publike te Aksesit ne Internet
<b>KQ</b>	Keshilli i Qarkut
<b>KKZhQZhQ</b>	Komisioni Keshillimor i Zhvillimit te Qarkut mbi Zhvillimin e Qendrueshem
<b>SZhQ</b>	Strategjia e Zhvillimit te Qarkut
<b>QMQ</b>	Qendrat Mjedisore te Qarkut
<b>PSA</b>	Procesi i Stabilizim Asocijimit
<b>SME</b>	Ndermarjet e Vogla dhe te Mesme
<b>OKB</b>	Organizata e Kombeve te Bashkuara
<b>UNDP</b>	Programi i Kombeve te Bashkuara per Zhvillim
<b>UNEP</b>	Programi i Kombete te Bashkuara per Mjedisin
<b>UNICEF</b>	Fondi i Kombeve te Bashkuara per Femijet
<b>WB</b>	Banka Boterore
<b>WHO</b>	Organizata Boterore e Shendetit



Përmbledhje	<b>10</b>
<b>KAPITULLI 1</b>	
Hyrje	<b>15</b>
<b>KAPITULLI 2</b>	
Profili i Qarkut të Fierit	<b>23</b>
<b>KAPITULLI 3</b>	
Strategjia	<b>73</b>
<b>KAPITULLI 4</b>	
Zbatimi dhe Monitorimi	<b>111</b>
<b>SHTOJCA 1</b>	<b>115</b>
<b>SHTOJCA 2</b>	<b>119</b>
<b>SHTOJCA 3</b>	<b>123</b>

## Përmbledhje

Kjo strategji nuk është një dokument ligjor, ajo është më tepër një kornizë elastike për zhvillimin e qarkut, prandaj rishikimi dhe monitorimi pjesëmarrës vështrohen si një proces, i cili vazhdon gjatë gjithë periudhës që mbulon strategjia dhe përgjegjësia e aktorëve e bashkësisë.

### Hyrje

Raporti mbi Strategjinë Rajonale të Zhvillimit (SRZH) jep një kornizë afatgjatë për zhvillimin e Qarkut të Fierit. Kjo është një përvojë pilot, që përdor Objektivat e Mijëvjeçarit (OM) për të ndërtuar synime rajonale brenda një kuadri afatgjatë.

SRZH e Fierit është njëkohësisht një zotim politik i pushtetit vendor për të përmirësuar kushtet ekonomike e shoqërore të Qarkut, si dhe një platformë e shëndoshë për popullsinë që të ndjekë përparimin dhe të përkrahë veprimet.

Strategjia është hartuar në përputhje si me Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik e Social, ashtu edhe me procesin e Bashkimit Europian për Asociim-Stabilizim (PSA). Integrimi i strategjive rajonale dhe kombëtare do të sjellë që të arrihen synimet kombëtare në nivelin rajonal. Kjo do të mbështesë plotësimin e kriterëve për asociimin e Shqipërisë në BE, siç është përcaktuar në procesin e Bashkimit Europian për Asociim-Stabilizim. Gjithashtu Raporti merr parasysh strategjitë sektoriale që tashmë janë përgatitur nga një varg ministrish dhe procesin e decentralizimit, që është duke u bërë.

Ashtu siç e thotë nëntitulli: *Pjesëmarrja e popullit për një të ardhme më të mirë të përbashkët*, edhe procesi i përgatitjes së Strategjisë i bashkoi organizatat e shoqërisë civile, qytetarët, sektorin privat dhe përfaqësuesit e qeverisë në një rrjedhë veprimtarie, që përcaktoi e vendosi përparësitë e synimeve kyç të zhvillimit dhe programet për qarkun. U organizuan mbledhje me publikun dhe sondazhe të opinionit publik me 2000 qytetarë për t'i përfshirë njerëzit në procesin e vendimmarrjes. U organizuan fushata intensive për ndërgjegjësim, që të informoheshin qytetarët lidhur me procesin e SRZH dhe për OM-it. Për të depërtuar te qytetarët në të gjitha pjesët e të tre rrethëve të Qarkut, u përgatitën dokumentarë në televizion, pro-

grame me biseda në radio, fletëpalosje dhe pllakate.

Sfidat e Raportit lidhen kryesisht me vështirësitë për të mbledhur të dhëna të besueshme, cilësore dhe të shpërndara, gjë që e kufizonte në një farë mase analizën e gjendjes, duke përfshirë parashikimet dhe përpunimin e treguesve. Strategjia rekomandon një varg studimesh për ta mbushur këtë zbrazëti me qëllim që të ketë një informacion më të mirë kur të rishikohet ky dokument.

Raporti është ndarë në shtatë krerë. I pari, *Hyrja*, jep një përshkrim të procesit të SRZH. *Kapitulli 2* paraqet profilin e Qarkut të ndarë në katër pjesë, të cilat gjurmojnë kuadrin ekonomik, shoqëror, institucional dhe të mjedisit. Po përmendim disa nga mundësitë e rajonit, të cilat i ilustron: përmirësimin e bujqësisë, zhvillimin e turizmit dhe zgjerimin e sektorit privat. *Kapitulli 3* paraqet objektivat dhe synimet për trajtimin e nevojës për sisteme ujësjellësish e ujërash të zeza, për degradimin e mjedisit për shkak të industrive e të transportit, si dhe problemet e lidhura me kujdesin shëndetësor, frekuentimin e dobët të shkollës, papunësinë e lartë dhe trafikimin e grave e të fëmijëve. Në të propozohen treguesit e një varg programesh për t'i plotësuar synimet dhe për të arritur Vizionin e Fierit për vitin 2015. Kreu i fundit, *Kapitulli 4* nxjerr në dukje çështjet e rëndësishme për zbatimin dhe mbikëqyrjen e SRZH.

## Profili i Qarkut

### Kuadri shoqëror

Lëvizja e popullsisë është një tregues i kushteve ekonomike dhe shoqërore të kësaj zone. Fieri, si rajoni i dytë më i madh nga numri i popullsisë në vend, me 12% të shifrës totale, po përjeton një shtim të shpejtë të popullsisë në qendrat qytetare, me gjithë rënien e përgjithshme të numrit të popullsisë për shkak të emigrimit jashtë vendit dhe në qytetet e tjera gjatë 12 vjetëve të shkuara. Kjo lëvizje e popullsisë ka prekur cilësinë e shërbimeve sociale, si arsimi e shëndetësia, duke i ngarkuar infrastrukturën dhe shërbimet ekzistuese, si dhe institucione të tilla, si pushteti vendor, që detyrohet t'i përgjigjet urbanizimit të shpejtë dhe të sigurojë një baraspeshë zhvillimi në zonat fshatare.

Ka edhe sfida të tjera që duan përballuar për zhvillimin në këtë Qark. Pakica rome vijon të ndeshet me

vështirësi ekonomike, vërehet një përparim i ngadaltë drejt barazisë gjinore – burrat mbisundojnë në organet ekzekutive dhe postet vendimmarrëse, zonat fshatare nuk kanë shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe reforma arsimore është e nevojshme për të përmirësuar frekuentimin dhe cilësinë e shkollave.

## Prirjet ekonomike

Ndër faktorët që ndikojnë për rënien e ekonomisë dhe rritjen e varfërisë bëjnë pjesë: pasiguria e pronësisë mbi tokën – d.m.th. feramat e mëparshme prona të shtetit dhe ish kooperativat që u kthyen në ekonomi të vogla bujqësore dhe u lanë të pazhvilluara; niveli i pakënaqshëm i industrive për përpunimin e produkteve bujqësore, si dhe privatizimi i copëzuar i ndërmarrjeve publike, që shkaktoi rritjen e madhe të papunësisë. Migrimi dhe ndihma sociale nga shteti janë dy mekanizmat kryesorë për të përballuar varfërinë. Sipas statistikave shtetërore afërsisht 6 për qind të familjeve në Fier varen nga sistemi i ndihmës ekonomike shtetërore, duke marrë 0,76 dollarë në ditë.

Afërsisht 60 për qind e popullsisë së qarkut banon në zonat fshatare, bujqësia është sektori parësor në rajon për të rritur të ardhurat dhe për të pakësuar varfërinë. Arsytet që tregohen dhe që janë përcaktuar në Fier për zhvillimin e ulët të fshatit janë kryesisht mungesa e infrastrukturës rurale, mundësia e pamjaftueshme për të marrë kredi e për të dalë në treg, copëzimi i tokës dhe mekanizmi i ulët.

Për shkak të vendosjes gjeografike, të burimeve natyrore e njerëzore, qarku i Fierit i ka mundësitë, ndër të tjera, për t'u zhvilluar si një nga qendrat më të rëndësishme të agrobiznesit në vend. Roli i sektorit privat për ngritjen e industrive të përpunimit të produkteve bujqësore do të ishte me rol strategjik për zhvillimin e ekonomisë së rajonit.

## Kushtet natyrore e të mjedisit

Fieri është i njohur për larminë dhe gjerësinë e zonave bujqësore e të pyllëzuara. Ndër vlerat pozitive të burimeve të rajonit të Fierit bëjnë pjesë vija bregdetare, plazhet, rezervatet me larmi të madhe biologjike dhe pjelloria e lartë e tokës së punueshme. Këto vlera e bëjnë edhe më të qenësishme që rajoni të përqendrohet në gjendjen e mjedisit të vet. Trajtimi i dobët nga ana mjedisore e ujërave të zeza dhe e kanalizimi-

meve, ndotja industriale, shpyllëzimi, mbeturinat e ngurta urbane dhe zhvillimi urban pa plan janë aspektet negative, që kanë sjellë degradimin e mjedisit.

Ndër zonat që kërkojnë vëmendje të posaçme përfshihen fushat e naftës të Marinzës e Patosit, rafineria e naftës në Ballsh dhe uzina e plehrave të azotuara. Këto janë pranuar si nëntë “pikat e nxehta” të mjedisit prej një vlerësimi mjedisor, të kryer nga UNEP. Ndotja e ajrit, ujit dhe truallit është pasojë e industrive të naftës dhe energjetike. Për shembull, përmbajtja totale e lëndëve (SO<sub>2</sub>, NO<sub>x</sub>, Ozon, CO dhe e metaleve të rënda) i kapërcen shifrat e rekomanduara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) dhe del tri herë më e lartë sesa mesatarja vjetore e lejuar.

Edhe infrastruktura e shërbimet publike kanë nevojë për përmirësim. Shtimi i shpejtë i popullsisë në zonat urbane dhe mungesa e mirëmbajtjes së rrjetit ujor në zonat fshatare kanë sjellë që sistemi i furnizimit me ujë të jetë i papërshtatshëm. Në të vërtetë vetëm 30% e familjeve kanë ujë brenda banesave të tyre. E njëjta gjë mund të thuhet për rrjetin e ujërave të zeza dhe strukturat për trajtimin e ujërave të përdorura, të cilat nevojiten për të pakësuar ndotjen e mjedisit dhe për të ngritur kushtet shëndetësore të popullsisë së Qarkut të Fierit.

## Gjendja e institucioneve dhe e pushtetit vendor

Në Qarkun e Fierit ka një kërkesë të madhe për qeverisje të mirë. Aktorët dhe qytetarët kanë përcaktuar e kanë pranuar Vizionin e vitit 2015 për rajonin, i cili paraqet nevojën për institucione publike të frytshme dhe për pjesëmarrjen më të madhe të qytetarëve në vendimmarrje. Bashkësia e Qarkut të Fierit e ka veçuar qeverisjen e mirë si një ndër pesë fushat me përparësi për zhvillimin e rajonit. Janë bërë disa përpjekje gjatë muajve të kaluar për ta përmirësuar qeverisjen në Qark, si Strategjia e Zhvillimit për bashkinë e Fierit e të Ballshit, që përfshinte mendimet e qytetarëve për përcaktimin e përparësive në të ardhmen. Me gjithë përpjekjet e bëra për ta zgjeruar pjesëmarrjen e publikut në proceset politike dhe gatishmërinë e institucioneve vendore për të futur praktika të reja, që të sigurojnë qeverisje të frytshme e të drejtë, përsëri ka ende shumë veprimtari që duhen ndërmarrë dhe ndër to janë: shtimi i mekanizmave për pjesëmarrjen e publikut, transparencja dhe efektiviteti i pushtetit lokal.

## Strategjia

Deklarata e Vizionit për Fierin 2015 thotë: “Fieri është një rajon i përshtatshëm për mundësitë e punësimit dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik; është një vend pa varfëri ku e gjithë popullsia me arsim të lartë mund të zhvillojë barabar mundësitë e plota për mjedis të pastër e të shëndetshëm; një rajon në të cilin shërbimet publike kryhen me frytshmëri nga një administratë e kualifikuar dhe vendimet merren me pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve.”

Duke shfrytëzuar Vizionin 2015 aktorët dhe bashkësia kanë përcaktuar përparësitë e rajonit, që u lidhën me OM-it si pjesë të kornizës afatgjatë për Strategjinë Rajonale të Zhvillimit (SRZH). Synimet e përcaktuara afatgjata janë: *pakësimi i varfërisë, përmirësimi i kushteve të arsimit, nxitja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave, sigurimi i qëndrueshmërisë së mjedisit dhe përmirësimi i qeverisjes vendore*. Për secilin synim aktorët dhe qytetarët kanë përcaktuar objektivat, pikarritjet e programet që të arrihen synimet. Gjithashtu janë përgatitur treguesit, të mbështetur në të dhënat në dispozicion për të ndihmuar që të vendosen piketat. Nevojiten përmirësime për të dhënat në dispozicion që të mbikëqyret më mirë përparimi i SRZH.

Pikat kryesore të Strategjisë për secilën zonë me përparësi jepen më poshtë.

### • Të pakësohet varfëria

#### Të nxitet zhvillimi rural i integruar

Një nga fushat kryesore të shqetësimit, e përcaktuar në këtë Strategji është shtimi i varfërisë në zonat fshatare dhe mungesa e një politike të integruar për zhvillimin rural. Shtimi i prodhimit bujqësor dhe i marketimit për të pakësuar varfërinë në zonat rurale, përmirësimi i zhvillimit të infrastrukturës, shtimi i përdorimit të inputeve dhe mekanizimit, si dhe mundësia për kredi janë bazat që të krijohen kushtet e nevojshme për të rritur prodhimin bujqësor në Strategjinë e Fierit.

#### Të rritet zhvillimi i industrisë dhe tregtisë

Zgjerimi i mundësive ekonomike nëpërmjet zhvillimit të sektorit të industrisë e të tregtisë, veçanërisht atij të lidhur me përpunimin e ushqimeve, vështrohet si për-

parësi në Strategjinë e Fierit. Fushat kryesore të cilat do të trajtohen nëpërmjet programeve janë: mbështetja për të përmirësuar klimën e biznesit, forcimi i institucioneve të tregut, shtimi i aftësive të krahut të punës nëpërmjet kualifikimit profesional, për t’iu përgjigjur kërkesave.

### • Të përmirësohen kushtet e arsimit

#### Të përmirësohet cilësia e infrastrukturës shkollore

Infrastruktura e papërshtatshme e shkollave në rajonin e Fierit është një nga problemet kryesore dhe ka ndikim mbi motivimin e mësuesve e të nxënësve. Ka fare pak shkolla në Qark që janë të pajisura me të gjitha mjediset për laboratore, veprimtari sportive e çlodhje. Në Strategji paraqiten programet që synojnë të rivlerësohet hapësira dhe të pajisen më mirë shkollat me mjediset për çlodhje e veprimtari kulturore.

#### Të përmirësohet cilësia e arsimit

Cilësia e arsimit shihet si një pikë kritike në Qarkun e Fierit. Për ta zgjidhur këtë problem, programet e përcaktuara janë përqendruar në përmirësimin e teksteve shkollore dhe shtimin e numrit të mësuesve të kualifikuar, duke i kualifikuar me metodat e reja të mësimdhënies.

#### Të rritet frekuentimi i shkollës

Synime të rëndësishme për qarkun e Fierit janë ngritja e nivelit të frekuentimit të shkollës, sidomos në shkollat e mesme në zonat fshatare dhe përgjysmimi i shkollës së analfabetizmit, me qëllim që të sigurohet zhvillimi i ardhshëm i rajonit. Strategjia për ta arritur këtë objektiv përqendrohet në fuqizimin e lidhjes ndërmjet bashkësisë dhe shkollave, duke shtuar pjesëmarrjen e punonjësve socialë, mbështetjen për familjet e varfra dhe ngritjen e ndërgjegjësimit të bashkësive rurale për frekuentimin e shkollave. Në Strategji gjithashtu janë paraqitur programe për të trajtuar nevojat që të shtohet mbështetja për arsimin “jozyrtar” nëpërmjet veprimtarive kulturore e të çlodhjes.

### • Të nxitet barazia e gjinive dhe të fuqizohen gratë

Të nxitet ndërgjegjësimi i gjerë i publikut për çështjet e barazisë së gjinive në familje dhe në shoqëri

Një nga përparësitë e kësaj Strategjie është të rritet ndërgjegjësimi dhe të kuptuarit e burrave e të grave për çështjet e lidhura me barazinë e gjinive, si bazë për të ndryshuar qëndrimet. Për më tepër, për të përcaktuar çështje të tilla, si mundësia për të zotëruar pasuri, informacion e shërbime ka rëndësi themelore që të ketë të dhëna të shumanshme për mbajtjen e shtëpisë, që të kuptohet më mirë pozita e grave brenda familjes.

### *Të shtohet pjesëmarrja e grave në procesin e marrjes së vendimeve*

Është e kuptueshme që gratë ende luajnë një rol të dorës së dytë në marrjen e vendimeve si në gjithë vendin, edhe në në këtë rajon. Është e nevojshme të rritet roli drejtues i grave. Në këtë Strategji propozohen si veprimtari shtimi i aftësive të grave nëpërmjet kualifikimit të përqendruar, të sigurohen mundësi të barabarta për burrat dhe për gratë nëpërmjet politikave e procedurave të përshtatshme.

### **•Të sigurohet qëndrueshmëria e mjedisit**

#### *Të rehabilitohen zonat e ndotura dhe të zhduket ndotja në Qarkun e Fierit*

Ndotja e mjedisit në Fier është e lidhur ngushtë me naftën, energjetikën e industrinë e tjera, të cilat e kanë degraduar rëndë truallin, ujin dhe ajrin. Për të përmirësuar kushtet e mjedisit, kjo Strategji propozon që problemi të trajtohet nga tre drejtime: (i) të pakësohet ndotja që në burim, duke investuar në teknologjitë e reja që janë të shëndetshme për mjedisin, (ii) të rehabilitohen trualli i ndotur dhe rrjedhat ujore, dhe (iii) të shtohen sistemet e mbikëqyrjes për ndotjen e ajrit e të ujit pranë burimit dhe në zonat e prekura. Ky objektivi është një sfidë e madhe, me të cilën rajoini i Fierit duhet të përballet, duke bërë bashkërendimin ndërmjet gjithë aktorëve të përfshirë në të.

#### *Të përmirësohet infrastruktura dhe planifikimi urban, si dhe të zvogëlohet degradimi i mjedisit*

Një sfidë e rëndësishme për rajonin e Fierit është administrimi i urbanizimit të shpejtë për të mbrojtur shëndetin publik dhe për të siguruar mundësitë e pasjes së infrastrukturave bazë, si uji e higjiena. Kjo Strategji propozon hartimin e planeve urbane dhe të planeve të tjera sektoriale të integruara, si transporti, trajtimi i

plehrave, uji dhe higjienizimi. Edhe ndryshimet në pronësinë e tokës kanë krjuar një trysni mbi mjedisin, duke sjellë humbjen e mjedisit jetësor për shkak të shpyllëzimit, gërryerjes, vërshimeve dhe shterimit të burimeve të ujit të pijshëm. Në këtë Strategji propozohet ripyllëzimi si fushë strategjike për të përmirësuar cilësinë e mjedisit dhe shëndetin e qytetarëve.

### **•Të përmirësohet qeverisja vendore**

Të zvogëlohet korrupsioni dhe të shtohet pjesëmarrja e qytetarëve në marrjen e vendimeve

Kjo Strategji përqendrohet në arritjen e këtij objektivi nëpërmjet shtimit të mekanizmave për pjesëmarrjen dhe institucionalizimin e saj si një rrugë që të shtohet transparenca. Përveç kësaj, të rritet ndërgjegjësimi i qytetarëve ndaj korrupsionit dhe të shtohen instrumentet publike për të njoftuar rastet e korrupsionit.

#### *Të përmirësohet frytshmëria e qeverisjes*

Përmirësimi i frytshmërisë së qeverisjes në Strategji trajtohet nëpërmjet rishikimit dhe sqarimit të strukturës e të roleve të pushtetit, si dhe të zhvillimit të aftësive të personelit të punëve shtetërore.

### **Zbatimi dhe mbikëqyrja**

SRZH e Fierit ka për qëllim të vendosë një kornizë për zhvillimin e vërtetë dhe administrimin e Qarkut, si dhe për të udhëhequr vendimmarrjen në të ardhmen lidhur me zhvillimin e rajonit. Suksesi i SRZH varet nga zbatimi, mbikëqyrja dhe proceset e rishikimit nga të gjitha nivelet e pushtetit, të organizatave rajonale dhe bashkësia. Duhet ngritur një strukturë organizative e bashkërenduar mirë për zbatimin dhe mbikëqyrjen e SRZH. Pjesëmarrja publike në këto veprimtari do të jetë me rëndësi që të ruhen mbështetja dhe ligjshmëria e SRZH. Kjo do të sigurojë gjithashtu përdorimin e frytshëm e transparent të burimeve. Përveç kësaj, informacioni i të dhënave bazë të Këshillit të Qarkut do të kërkojë krijimin dhe përditësimin e vazhdueshëm të një programi për kompjuter. Ky program do të përbajë informacionin drejtues themelor për mbikëqyrjen e treguesve të përzgjedhur në procesin e planifikimit të SRZH që të arrihen synimet rajonale.

--	--

# Kapitulli I

## hyrje

*Strategjia Rajonale e Zhvillimit të Fierit e solli qeverinë më pranë banorëve të tij duke përcaktuar së bashku përparësitë për të përmirësuar të ardhmen e Qarkut.*



## Informacion i përgjithshëm

Qarku i Fierit përbëhet nga rrethet Fier, Lushnje e Mallakastër dhe ndodhet në jugperëndim të Republikës së Shqipërisë. Popullsia e tij është 382.544 banorë, duke u renditur i dyti në Republikë për nga popullsia, pas Qarkut të Tiranës. Dendësia e popullsisë është 202 banorë për km<sup>2</sup>, pothuajse sa dyfishi i dendësisë mesatare kombëtare prej 106,7 banorë/km<sup>2</sup>, dhe vjen i treti pas Tiranës e Durrësit. Popullsia e Qarkut të Fierit lidhet me një histori të pasur. Rrënojat antike të qytetit ilir Bylis dhe të qytetit të Apollonisë (588 p.e.s) përbëjnë një nga dëshmitë më të rëndësishme kulturore të rajonit. Shumë festa përkujtojnë ngjarjet dhe trimërinë e fierakëve për mbrojtjen e trojeve të tyre gjatë gjithë historisë. Megjithëse të lidhur ngushtë me vlerat familjare dhe traditat e tyre, fierakët punojnë për zhvillimin në të ardhmen të rajonit të tyre.

Fieri është i njohur për burimet e tij natyrore dhe potencialet ekonomike. Fushat e shtrira dhe kodrat e ulëta janë pjesë e territorit të Qarkut. Fushat e ulëta pjellore janë të përshtatshme për prodhimin bujqësor, konsiderohen si një nga zonat bujqësore më të rëndësishme të Shqipërisë. Laguna e Karavastasë, Divjakë, një Park Kombëtar prej 4200 ha dhe 75 km vijë bregdetare janë një potencial i madh ekonomik, turistik dhe shkencor. Zonat kodrinore janë një mjedis ideal për mbjelljen e ullinjve dhe vreshtave që janë gjerësisht të përhapura kryesisht në rrethin e Fierit dhe të Mallakastrës. Tre lumenjtë kryesorë të Shqipërisë: Shkumbini, Semani dhe Vjosa përshkojnë rajonin dhe territori është gjithashtu i pasur me burime ujore. Fieri bën pjesë në zonën me klimë Mesdhetare, me verë të thatë e të nxehtë dhe dimër të butë e të lagësht. Temperaturat mesatare vjetore luhaten nga 15,1°C në Rrethin Fier deri në 16,1°C në Lushnje. Rezervat më të mëdha të naftës si dhe industria e naftës dhe e gazit janë përqendruar në rrethin e Fierit. Si pasojë e pozitës së tij gjeografike, Fieri është një nyjë lidhëse në telekomunikacion dhe transport, që lidh pjesët Qendrore, Jugore dhe Jugperëndimore të vendit. Tri rrugë kryesore kalojnë në Qarkun e Fierit, rruga nacionale Veri-Jug (Korridor i 10-të) që lidh Tiranën me Gjirokastrën, dhe segmentet hekurudhore Tiranë-Vlorë dhe Tiranë- Ballsh.

Megjithëse Qarku i Fierit është i dyti për nga treguesi i Burimeve Njerëzore në vend<sup>1</sup> - në bazë të një analize

<sup>1</sup> Raporti i burimeve njerëzore PNUD: Sfidat e Pushtetit Lokal dhe Zhvillimi Rajonal, Shqipëri 2002

mbi treguesit e jetëgjatësisë, arsimit dhe PBB, si dhe potencialeve të mëdha për zhvillim, ka një varg sfi-dash që duhen përballuar nga Qarku. Varfëria dhe papunësia, emigrimi i popullsisë që po shteron krahun e punës dhe degradimi i rëndë i mjedisit janë disa nga shembujt e çështjeve që Qarku i Fierit duhet t'i rishikojë për të krijuar të ardhmen e tij të qëndrueshme.

Ligji mbi decentralizimin i vitit 2000 u dha Qarqeve detyrën për hartimin e politikave rajonale dhe bashkërendimin e interesave po në nivel rajonal. Në

**Treguesi i BNJ për Shqipërinë është 0,735, sipas RBNJ 2003. Me këtë tregues BNJ, Shqipëria renditet e 95-ta në klasifikimin e KB për 175 shtete, dhe renditet midis vendeve me tregues mesatar për zhvillim njerëzor.**

prill 2001 Këshilli i Qarkut Fier filloi procesin për hartimin e strategjisë së tij rajonale dhe kreu një sondazh për të vlerësuar gjendjen e zhvillimit rajonal në sektorë të ndryshëm për periudhën 1990-2000. Përpjekjet e Këshillit të Qarkut vazhduan edhe më 2002 kur Programi i Qeverisjes Vendore - PNUD, filloi të jepte mbështetjen e tij për përgatitjen e Strategjisë Rajonale të zhvillimit (SRZH).

## Qëllimi i SRZH të Fierit

Objektivi kryesor i SRZH të Fierit është të hartojë një kuadër për zhvillim të qëndrueshëm dhe të përmirësojë cilësinë e jetesës në rajon. Strategjia përbën një vizion të përbashkët për të ardhmen e Fierit, i cili do të arrihet nëpërmjet OM-it. SRZH përpiqet të jetë një plan për rajonin dhe jo një plan për Këshillin e Qarkut. Kjo nënkupton rëndësinë e inputeve të bashkësisë, ashtu si dhe pjesëmarrje të plotë institucionale në të gjitha nivelet në zhvillimin dhe zbatimin e planit. Megjithëse përgjegjësia kryesore bashkërenduese do të jetë e KQ, kjo SRZH mund të vihet në zbatim plotësisht përmes institucioneve të brendshme dhe që kanë ndikim në rajon, qofshin ato të sektorit publik, privat apo të shoqërisë civile. Mënyra pjesëmarrëse që është përdorur është hapi i parë drejt pasjes së një plani edhe për bashkësinë.





## Hartimi i SRZH për Fierin: Procesi planifikues i pjesëmarrjes

Procesi filloi me hartimin e profilit të qarkut, i cili analizozi tendencat dhe mundësitë e rajonit për zhvillimin e tij. Analizimi i situatës, së bashku me inputin e bashkësisë së rajonit, siguroi bazën për krijimin e vizionit deri më 2015 për qarkun dhe për identifikimin e zonave prioritare të strategjisë, të cilat ishin të lidhura edhe me OM-it. OM-it të lokalizuara në Fier përbëhen nga çështjet prioritare kryesore që ndikojnë në rajon, dhe të cilat do të kenë ndikimin më të ndjeshëm në arritjen e vizionit të përcaktuar për vitin 2015. Pesë përparësi janë përfshirë në këtë Strategji, të cilat janë:

- zbutja e varfërisë,
- përmirësimi i arsimit,
- barazia gjinore,
- mjedisi i qëndrueshëm, dhe qeverisja e mirë.

OM-it të identifikuarat u rishikuan më tej dhe u detajuan për të përfshirë objektivat rajonale, treguesit dhe programet për të trajtuar çështjet e veçanta. Procesi për përgatitjen e kësaj SRZH të Fierit tregohet edhe në Fig 1.

### Sfidat dhe kufizimet e procesit planifikues

Gjatë gjithë periudhës së hartimit të SRZH, të shumta ishin sfidat që përballoi grupi i punës si përgjegjësi kryesor për bashkërendimin e procesit. Vështirësitë në mbledhjen e të dhënave cilësore, të besueshme dhe të

shpërndara mund të kenë kufizuar cilësinë e analizës së të dhënave, duke përfshirë parashikimet dhe vendosjen e treguesve. Strategjia rekomandon një varg studimesh për ta mbushur këtë zbrastë, pasi të rishikohet dokumenti. Megjithatë, ky raport është përpjekja e parë për të pasur një kornizë të zhvillimit afatgjatë, dhe ai do të rishikohet e do të përmirësohet gjatë periudhës që mbulon.

Për më tepër, meqë nocioni i planifikimit pjesëmarrës është një praktikë e re që po përdoret në Shqipëri, u deshën kohë dhe përpjekje nga ana e gjithë aktorëve të përfshirë për të marrë pjesë dhe për t'iu përshtatur këtij procesi.

## Tiparet kryesore të SRZH Fier në përputhje me OM-it


Karakteristikat bazë në hartimin e SRZH Fier janë:

- Përqendrimi në çështjet prioritare me të cilat do të përballlet Qarku në 12 vitet e ardhshme;
- Proces dinamik, që synon të pasqyrojë dhe të arrijë përmirësime;
- Ndërthurja me kornizat për zhvillim në nivel kombëtar;
- Përfshirja e aktorëve dhe qytetarëve në përcaktimin e përparësive;

### Përqendrimi në përparësitë me të cilat do të përballlet Qarku gjatë periudhës prej 12 vjetësh

SRZH Fier nuk përpiqet t' përfshijë të gjitha çështjet

Figura 1: Procesi për përgatitjen e kësaj SRZH të Fierit



rajonale. Në përcaktimin e çështjeve strategjike rajonale, siç janë identifikuar nga specialistët rajonale dhe bashkësia, SRZH ka përcaktuar një objektiv afatgjatë strategjik bazuar tek Objektivat e Mijevçarit (OM-të) dhe synimet, gjithashtu edhe tregues afatshkurtër dhe afatmesëm për të udhëhequr dhe monitoruar procesin e zbatimit.

### **Proces dinamik, që është gjithmonë në ndryshim**

Vlera e SRZH Fier do të përcaktohet gjerësisht nga fakti se me sa sukses programet do të zbatohen dhe mbështeten në të gjitha nivelet e qeverisjes në Shqipëri, nga organizatat kombëtare e rajonale dhe bashkësia. Zbatimi i Strategjisë do të sjellë si përfundim shtimin e informacionit, të dhënave dhe rekomandimeve nga të gjithë aktorët e përfshirë në proces për t'i trajtuar më mirë nevojat që ndryshojnë të shoqërisë në Qarkun e Fierit. Strategjia nuk është një dokument i natyrës ligjore ose statike, por është një kuadër elastik për zhvillimin e Qarkut, domethënë rishikimi dhe monitorimi pjesëmarrës vështrohen si një proces i vazhdueshëm e i nevojshëm në kornizën e Strategjisë, dhe gjithashtu është përgjegjësi e aktorëve dhe e bashkësisë.

### **Ndërthurja me kornizat për zhvillim në nivel kombëtar: OM-it, SKZHES dhe PSA-it**

SRZH të Fierit synon të nxisë Zhvillimin Njerëzor në rajon. Sipas këtij parimi të përgjithshëm, SRZH e Fierit, angazhimet politike dhe Strategjia në nivel Kombëtar, përbëjnë një kuadër të plotë, nëpërmjet të cilit veprimet mund të bashkërendohen dhe të sjellin ndryshime në nivel lokal dhe kombëtar.

Objektivat e Mijevçarit (OM-it) janë një program politik afatgjatë për pakësimin e varfërisë dhe përmirësimin e jetesës së njerëzve në 191 vende, përfshirë këtu edhe Republikën e Shqipërisë, të cilat janë zotuar t'i arrijnë ato deri në vitin 2015. OM-të u përdorën në SRZH të Fierit në procesin planifikues si kornizë konkrete për të strukturuar përparësitë dhe objektivat rajonale brenda një kuadri afatgjatë. SRZH të Fierit në përputhje me OM-it është në të njëjtën kohë një angazhim i pushtetit vendor për të përmirësuar kushtet ekonomike dhe sociale në Qark, dhe një platformë e fortë nga ku njerëzit mund të monitorojnë përparimin dhe të përkrahin veprimet

që mund të ndërmerren. SRZH të Fierit do të shërbejë si një dokument udhëzues për investime lidhur me programet e përcaktuara për të arritur OM-it të lokalizuar në Fier.

Mundësia e lidhjes së përparësive rajonale me OM-it, do të thotë krijimi i një rrjeti burimesh (informative, njerëzore, financiare, etj.) nga qeveritë, organizatat ndërkombëtare dhe shoqëria civile në mbarë botën, i cili do të forcojë ndikimin që veprimet në nivel rajonal mund të kenë në zhvillimin njerëzor lokal.

**“Zhvillimi Njerëzor është përkufizuar si zgjerimi i lirisë së zgjedhjes” - Amartya Sen.**

**Do të thote krijimi i nje mjedisi te përshtatshem për kedo qe te jetoj jete te gjatë krijuese dhe të shëndetshme.**

Zonat prioritare në Fier përputhen me objektivat kryesorë të identifikuar në Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik dhe Social (SKZHES), d.m.th. ulja e varfërisë përmes rritjes së prodhimit bujqësor, zhvillimit të industrisë dhe tregtisë, përmirësimin të infrastrukturës dhe kushteve të mjedisit, si dhe përmirësimin të arsimit e të qeverisjes. Programet dhe etapat e identifikuar në Fier gjithashtu pasqyrojnë objektivat dhe treguesit kombëtarë, ashtu si dhe kornizën kohore të dhënë në SKZHES. Me këtë kuptohet që ndërthurja e strategjisë kombëtare me atë rajonale, do të mbështesë plotësimin e kriterëve për asociimin e Shqipërisë në BE, siç është përcaktuar në procesin e Stabilizimit e të Asociimit të BE-së dhe më tej për anëtarësimin e plotë në BE.

### **Përfshirja e aktorëve dhe e bashkësisë**

Këshilli i Qarkut Fier bashkërendoi procesin e hartimit të SRZH duke përdorur një mënyrë gjerësisht pjesëmarrëse, e cila solli përfshirjen e aktorëve në nivel Rajonal dhe Kombëtar, ashtu si dhe të qytetarëve nga të tre rrethet në Qark. Kjo punë, e cila vazhdoi në mars –gusht 2003, e solli qeverisjen më afër njerëzve dhe forcoi praktikën e qeverisjes së mirë në rajon. Veç kësaj, procesi planifikues i përdorur është fillimi i një procesi që mund të çojë në fuqizimin e bashkësisë për çështjet e zhvillimit vendor, i cili po të ketë sukses,

mund të japë ndihmesë për mbështetje më të madhe të veprimtarive qeveritare. Kjo mbështetje është një nga kërkesat për qëndrueshmeri afatgjatë dhe zbatim efektiv të strategjive dhe programeve për të arritur Objektivat Rajonale.

### Analiza e aktorëve

Një vlerësim i detajuar i aktorëve në Qarkun e Fierit u krye për të përcaktuar ata dhe rolin e tyre në procesin planifikues të SRZH. Me qëllim që të sigurohej një përfshirje e gjerë në bashkësinë e Fierit, Këshilli i Qarkut përfshiu mbi 100 institucione të caktuara dhe afër 200 njerëz, nga sektorët publikë, privatë dhe shoqëria civile, që morën pjesë edhe në takimet konsultuese gjatë gjithë procesit. Anëtarët e Këshillit të Qarkut u konsideruan si pjesë e grupit, dhe morën pjesë gjithashtu gjatë gjithë procesit të konsultimit. (shih listën e plotë në Aneks).

### Struktura organizative për përgatitjen e SRZH

Zyra e Programimit e Zhvillimit (ZPZH) në KQ me mbështetjen e PQV të PNUD-it, luajti rolin e njësisë


bashkërenduese në procesin planifikues (shih Fig 2). Stafi i ZPZH punuan së bashku me ekspertë nga fushat e mjedisit, ekonomike dhe sociale, krijuan Grupin e punës që ishte përgjegjës për mbledhjen e të dhënave dhe përgatitjen e raportit mbi SRZH-OM-it. Departamentet e KQ siguruan mbështetjen teknike për Grupin e punës në të gjithë fazat e përgatitjes së SRZH-OM-it.

KQ krijoi një Komision Këshillimor mbi Zhvillimin e Qendrueshem (KKZHQ) në nivel qarku si strukturë e përhershme në Këshillin e Qarkut, me anëtarë të zgjedhur nga një grup i madh aktorësh. Anëtarësia në këtë grup këshillimor siguroi përfaqësimin e gjithë sektorëve të shoqërisë dhe mbajti parasysh ekuilibrin rajonal midis rretheve Lushnje, Mallakastër dhe Fier

Ky komision pati si detyrë dhënien e opinionëve në procesin planifikues dhe të hartimit për SRZH-OM-it. Anëtarë të këtij komisioni morën pjesë në të gjitha takimet konsultuese.

Grupi i madh i aktorëve u nda sipas sektorëve të interesit dhe u formuan grupet tematike për arsimin, problemet gjinore, mjedisin, zhvillimin ekonomik dhe qever-

► Figura 2: Struktura organizative e përgatitjes së SRZH



isjen, zonat me prioritet për zhvillimin e Qarkut të Fierit. Detyra e këtyre grupeve ishte të verifikonin besueshmërinë e të dhënave, rishikimin e konkluzioneve para-prake të një seminari konsultues me një grup të madh aktorësh, dhe të tregonte programet me përparësi për të arritur synimet e përcaktuara.

## Procesi i konsultimit për përcaktimin e përparësive

Procesi i konsultimit filloi me kërkesën që një grup i madh aktorësh nga bashkësia të mbledheshin për të dhënë vizionin e vitit 2015 për qarkun e Fierit. Pasi u përvijua një vizion i zhvillimit të qarkut dhe një kuadër i përgjithshëm, çështjet kryesore në rajon u renditën sipas përparësisë dhe u lidhën edhe me OM-it. OM-it, synimet përkatëse, treguesit dhe programet paraprakisht u përcaktuan nga seminari me grupin e madh të aktorëve dhe u analizuan më tej nga grupet tematike, bazuar në analizimin e situatës dhe tendencave për Qarkun e Fierit. Përfundimet e këtij procesi u ripanë nga publiku i gjerë, përmes mbledhjeve të hapura publike për të siguruar pjesëmarrjen e qytetarëve në të gjitha komunat dhe bashkitë. Përveç kësaj, u krye një sondazh i opinionit publik për të siguruar aprovimin e qytetarëve për vizionin, zonat e prioritetit dhe programet e përcaktuara gjatë procesit të konsultimit.

Procesi i konsultimit vazhdoi më tej për të verifikuar programet dhe treguesit për secilën zonë prioriteti, me një seminar ku u ftuan specialistë nga grupi i Kombeve të Bashkuara dhe përfaqësues nga qeveria qendrore. Së fundi, u organizuan takime të veçanta me përfaqësues nga Ministrinë e Financave, Ekonomisë, Bujqësisë, Mjedisit, Punës, Turizmit e Arsimit, si dhe Komitetin e Rregullimit të Territorit, Komitetin e Çështjeve Gjinore dhe pushtetin vendor.

Anëtarëve të Këshillit të Qarkut, të Grupit këshillimor për zhvillim të qëndrueshëm dhe pjesëmarrësve të grupeve tematike iu kërkua të jepnin mendimet e tyre për përfundimet e çdo faze të konsultimit dhe projekt-dokumentet, me qëllim që të sigurohej cilësia e informacionit i cili do të paraqitej në dokumentin përfundimtar. Përfaqësuesve nga grupi i organizatave të OKB-së dhe ministrinë iu kërkua gjithashtu të jepnin komente mbi projektin përfundimtar. Përfundimisht SRZH u vlerësua nga një grup i madh aktorësh dhe u miratua nga Këshilli i Qarkut Fier.

## Sondazhi i opinionit publik

Një sondazh i opinionit publik u organizua me rreth 2000 banorë të qytetit e të fshatit në 21 komuna dhe 6 bashkitë në të tre rrethet në Qark. Synimi i sondazhit ishte të njihet mendimi i bashkësisë lidhur me vendimet që u morën në procesin e përgatitjes së SRZH-OM. U përgatitën pyetësorë dhe u lidhën marrëveshje me OJQ-të vendore për të kryer sondazhin. Përveç shpërndarjes së pyetësorëve dhe grumbullimit të tyre, OJQ-të u dhanë edhe informacion me gojë e me shkrim njerëzve që pyetën për SRZH-it dhe OM-it. Prej 2000 pyetësorëve të shpërndarë, u kthyen të plotësuar 1969. Si rrethe, Fieri ktheu të plotësuar 1002 pyetësorë, ndërsa Lushnja dhe Mallkastra përkatësisht 533 dhe 433 pyetësor të plotësuar.

Sondazhi përfshinte intervista me grupet e pakicave, me gra e burra prej grupeve të ndryshme moshore, të niveleve të ndryshme të kategorive të punësimit e të arsimit. Pyetësorët ishin ndërtuar me 10 pyetje gjithsej; pesë të parat synonin të merrej informacion demografik e gjeografik. Pesë pyetjet e fundit synonin të mësohej mendimi i secilit qytetar pjesëmarrës për vizionin dhe fushat me përparësi, siç ishin përcaktuar nga grupi i aktorëve. Gjithashtu qytetarëve u kërkohet të bënin komente për çfarëdo çështje që mungonte në listën e paraqitur.

Rezultati i sondazhit dëshmoi e përforcoi vizionin dhe fushat me përparësi të përcaktuara në procesin e konsultimit, 99% e të intervistuarve ishin përgjigjur "po", pajtoheshin me vizionin e paraqitur nga grupi i aktorëve. Gjithë qytetarët e intervistuar pajtoheshin me fushat e përcaktuara si përparësore dhe veç kësaj, vunë në dukje çështje të tjera që gjithashtu kërkojnë vëmendje. Ndër çështjet e përcaktuara bëjnë pjesë: përfshirja e bashkësisë romë në strategjitë për pakësimin e varfërisë dhe të arsimit, mungesa e infrastrukturës, zhvillimi i dobët në zonat fshatare, papunësia etj. Çështjet e ngritura nga qytetarët u shqyrtuan me kujdes dhe u përfshinë tërësisht në pjesën e strategjisë të këtij dokumenti. Shihni raportin në Aneks.

## Zhvillimi i kapaciteteve

U përgatit një seri njësisish trajnimi si dhe u bënë disa sesione trajnimi për të rritur aftësinë e nëpunësve publikë dhe organizatave të shoqërisë civile, prërfshirë

edhe mediat, rreth nocioneve të planifikimit strategjik dhe OM-it. U bënë sesione ndërvepruese trajnimesh rreth OM-it me organizatat me bazë në bashkësitë për të rritur ndërgjegjësimin e tyre rreth çështjeve të politikave në nivele rajonale e kombëtare, dhe për lidhjen e OM-it me një kuadër konkret veprimesh për të përmirësuar cilësinë e jetesës së qytetarëve. Këto aktivitete për zhvillimin e aftësive sigurojnë përvetësimin e SRZH dhe rritjen e ndërgjegjësimin për përgjegjësinë e përbashkët gjatë zbatimit dhe monitorimit të saj.

## Fushata për informimin e publikut

Me qëllim që të mbështej dhe të nxitej pjesëmarrja e aktorëve e qytetarëve, u ndërмор një fushate masive informimi dhe ndërgjegjësimi. Fushata filloi në mars 2003 me shpërndarjen e gjerë të fletëpalosjeve dhe u bë një programi televiziv për të informuar qytetarët e aktorët rreth procesit planifikues të SRZH, si dhe për t'u bërë thirrje për pjesëmarrje aktive. Veç kësaj, u transmetuan reklama në radio dhe TV gjatë qershorit e korrikut për t'i informuar qytetarët rreth OM-it dhe ndikimit të tyre në zhvillimin e Fierit.

Në maj dhe korrik u transmetuan dy dokumentarë mbi procesin e planifikimit të SRZH dhe konkluzionet, të cilët përfshinin intervista me qytetarët për SRZH dhe OM-it. Me qëllim që të përfshiheshin banorët në fshatrat e largëta të Qarkut, u zhvillua intervista direkte në studio për radion. Fletëpalosje dhe pllakate iu shpërndanë gjithë komunave e bashkive në Qark për t'i vënë në dijeni qytetarët mbi procesin dhe konkluzionet e SRZH, si dhe për t'i ftuar që të merrnin pjesë në marrjen e vendimeve.

## Qendra për të hyrë publiku në Internet

Në Qarkun e Fierit u krijuan tri qendra për të hyrë në internetin (QHI): në Këshillin e Qarkut, në bibliotekën publike dhe në qendrën komunitare në bashkinë e Ballshit. Objektivi kryesor i këtyre QHI ishte të forcohej lidhja midis qytetareve dhe autoriteteve të pushtetit, të zgjerohej përfshirja e publikut në debatet rreth çështjeve me rëndësi rajonale, të ngrihej niveli i shpërndarjes së informacionit për OM-it dhe çështje të tjera rajonale, dhe së fundi, të trajtoheshin çështjet e qeverisjes në zonë. Ndër të tjera, QHI do t'u japin mundësinë njerëzve të përdorin internetin si mjet për të marrë informacion dhe për të pasur shërbime on-line që sigurohen nga institucionet publike. Në Fier u kriju

një faqe interneti e Qarkut të Fierit me mundësi të hapur për kontakte me adresa e-maili. Duke e parë në një prespektivë më të gjerë, krijimi i QHI përbën një nga objektivat më të rëndësishëm të Strategjisë Kombëtare ICT dhe për zhvillimin e Shoqërisë së Informacionit në Shqipëri.<sup>2</sup>

## Struktura e Raportit

Raporti ndahet në tre kapituj – kapitulli i parë: një analizë e sfidave dhe mundësive; kapitulli dy: shpërgjim më i detajuar i strategjisë së zhvillimit, ndërtuar në konsultim me aktorët; dhe kapitulli i tretë: paraqitja e programeve monitoruese që do ta mbështesin dhe udhëheqin këtë strategji.

Kapitulli i parë ndahet në katër pjesë, të cilat trajtojnë kuadrin ekonomik, social, si dhe atë mjedisor dhe institucional. Ai nxjerr në pah çështjet më kryesore të qarkut lidhur me prodhimin bujqësor, nevojën për sisteme ujësjellësish dhe të ujërave te zeza, pabarazinë gjinore, mundësinë për zhvillimin e sektorit privat, mundësitë për turizëm, dhe ndër të tjera, problemet e shëndetësisë. Kapitulli i dytë rreth proceseve të strategjisë paraqet OM-it për qarkun, synimet dhe treguesit, si dhe propozon një seri programesh që trajtojnë synimet dhe objektivat në zhvillimin rajonal. Siç përmendet me lart, shumë nga programet e Strategjisë Rajonale të zhvillimit (SRZH) përfshijnë qëndrimet e përcaktuara nga Strategjia Kombëtare për Zhvillim Social Ekonomik dhe Pakti i Asocim-Stabilizimit i Bashkimit European. Kapitulli i fundit do të ngrejë një mekanizëm për monitorimin e procesit të zbatimit. Dokumente të tjera të bashkangjitura përfshijnë tabela që nxjerrin në pah synimet, treguesit dhe programet e sugjeruara.

<sup>2</sup> PNUD 2002. Dokumenti i Projektit QHI.

# Kapitulli 2



## Profili i Qarkut të Fierit

*Fieri është një rajon i mundësive të mëdha ekonomike, me burime të pasura natyrore dhe njerëzore.*





harta 2






## Kuadri social

### Popullsia e Fierit

Fieri është rajoni i dytë në vend përsa i përket popullimit me 382.544 banorë; përfshin tridhjetë e gjashtë komuna e gjashtë bashki për të tre rrethet e Fierit, Lushnjes e Mallakstrës. Rajoni ka 12% të popullsisë në vend.

Gjatë 10 viteve të kaluara mesatarisht popullsia totale është zvogëluar. Në periudhën prej 1997 deri më 2001 Zyrat e gjendjes civile kanë njoftuar një rënie të popullsisë me 17% (siç tregohet në Grafikon 1. Shih gjithashtu hartën 2). Lidhur me prirjet e ndryshimit të popullsisë për secilin rreth të qarkut të Fierit, shifrat tregojnë se gjatë periudhës 1998 - 2002 popullsia e rrethit të Fierit është zvogëluar me 2,48 %, ndërsa në rrethin e Mallakastrës me 3,41 %. Megjithatë, pavarësisht nga rënia në rrethet e tjera, në rrethin e Lushnjes ka një rritje prej 7,2 % për të njëjtën periudhë.

Popullsia e rajonit të Fierit .



Marrë nga: Zyra e Gjendjes Civile 2001

Disa faktorë kanë kontribuar në prirjen për rënie të normës së rritjes natyrale të popullsisë në rajonin e Fierit midis viteve 1990 dhe 2001, ndër ta niveli i lartë i emigrimit dhe lëvizja drejt qyteteve të mëdha (sidomos drejt Durrësit dhe Tiranës). Për më tepër edhe futja e metodave të planifikimit familjar ka ndikuar gjithashtu në uljen e numrit të lindjeve. Më 2001 rritja natyrale e popullsisë së rajonit u vu re se ishte 2,2 herë më e vogël sesa ajo e vitit 1999.

Megjithatë, ndërsa shtimi i popullsisë në rajonin e Fierit ka rënë, densiteti i popullsisë është 202,7 banorë për km<sup>2</sup>, gati dy herë më tepër sesa shifra e mesatares së vendit me 106,7 b/km<sup>2</sup>. Sipas botimit të UNICEF-it “Vlerësimi i Kushteve Ekonomike dhe Sociale të rretheve të Shqipërisë”, rajoni i Fierit radhitet i treti për nga dendësia e popullsisë në vend pas Tiranës me 344 banorë për km<sup>2</sup>, dhe Durrësit me 324 banorë për km<sup>2</sup>.

Të dhënat statistikore përsa i përket dendësisë së popullsisë në Shqipëri, tregojnë se gjatë 12 vjetëve të kaluar ka patur rënie të numrit të popullsisë në zonat rurale dhe rritje në zonat urbane. Afërsisht 32,4% e popullsisë së rajonit të Fierit sot jeton në zonat urbane Kushtet më të mira të jetesës si dhe mundësitë më të mëdha ekonomike janë faktorët që kanë çuar në ndryshimin e shpërndarjes gjeografike të popullsisë. Tendenca kombëtare reflektohet në Qarkun e Fierit, veçanërisht në rrethin e Fierit, ku densiteti i popullsisë është 253,5 banorë/km<sup>2</sup>, ndërsa në Mallakaster është 100 banorë/km<sup>2</sup>, dhe në rrethin e Lushnjes është 202 banorë /km<sup>2</sup>. Bashkia e Fierit ka patur rritjen më të madhe të numrit të popullsisë, 106% në periudhën 1990-2001, qyteti me rritje më të shpejtë në vend<sup>3</sup>.

“Në 10 vitet e fundit, popullsia u rrit në Tiranë (Tiranë, Kamëz, Vorë, Paskuqan), në Durrës (Durrës, Katundi i Ri) dhe Fier 2 herë më tepër sesa rritja e vet natyrore, ndërsa nivelet e popullimit në Kukës, Shkodër dhe Dibër u ulën.” Marrë nga publikimi i UNICEF-Shqipëri më 2000 “Assessment Of Social & Economic Conditions Of Districts In Albania”

Edhe madhesia e familjes në Shqipëri ka ndryshuar. Në 2001, numeroheshin 726,895 familje në Shqipëri me njëmesatare prej 4.2 anëtarësh, një rënie kjo që prej vitit 1989 ku mesatarja ishte 5.6 anëtare. Familjet e rajonit të Fierit numeroheshin në 88,232 me një mesatare prej 4.3 anëtarësh në 2001. Në zonat rurale familjet vazhdojnë të jenë të mëdha për shkak të traditës Shqiptare të kujdesit për të moshuarit. Familjet me 6 ose më tepër anëtare llogariten të përbëjnë 18.2% të familjeve në Fier dhe 25.56% në Mallakastër. Zonat rurale të rajonit të Fierit kanë një mesatare të madhesisë së familjes prej 4.58 anëtarësh, ndërsa në zonat urbane është me e ulët 3.33 anëtare.

<sup>3</sup> Popullsia e Shqipërisë, Instat 2002

## Grupet e pakicave

Bashkësia e romëve përbën grupin më të madh minoritar në rajonin e Fierit, me një popullsi prej afërsisht 10.300 njerëz<sup>4</sup>, të përqendruar në disa fshatra të Fierit dhe Lushnjes. Bashkësia përbëhet nga katër fise të mëdha që ndryshojnë nga njëri-tjetri përsa i përket dialektit të gjuhës, mënyrës së jetesës, te kaluarës sociale dhe profesionale. Grupi më i madh është ai i Meçkarëve, të cilët tradicionalisht janë përfshirë në prodhimin bujqësor dhe janë marrë me muzikë. Ndërsa fiset e tjera, Cergarë, Bamill dhe Kurttof, janë marrë me tregtimin e kuajve, artizanat dhe muzikë. Zona e Levanit brenda rrethit të Fierit konsiderohet kryeqendra e romëve për shkak të përqendrimit të madh të kësaj popullsie.

Procesi i tranzicionit nuk ka sjellë ndryshime pozitive për jetën ekonomike e shoqërore të shumicës së popullsisë rome. Mbyllja e shumë ndërmarrjeve në qytet dhe transformimi i fermave shtetërore si dhe i kooperativave bujqësore nëpër fshatra gjatë viteve të para të tranzicionit, sollën papunësi masive në radhët e romëve. Sipas pyetësorëve, për numrin më të madh të familjeve rome, problemet e ushqimit, strehimit, shëndetësisë dhe shërbimeve mjekësore janë përkeqësuar. Gati 80 për qind e familjeve rome u përkasin grupeve “shumë të varfra” dhe “të varfra” të familjeve në rajon

Një nga problemet më të mëdha brenda bashkësisë së romëve e përbën arsimimi i fëmijëve. Gati 52,7% e popullsisë mbi moshën 7 vjeç është analfabete. Penge-satt kryesore për arsimimin e tyre lidhen me faktorët ekonomikë. Rreth 50 për qind e familjeve rome nuk i dërgojnë fëmijët e tyre në shkollë për shkak të mungesës së fondeve të duhura për të blerë libra, mjete shkollore dhe rroba të përshtatshme. Një faktor tjetër shtesë është ai i transportit; shkolla shpesh është shumë larg shtëpive të fëmijëve. Një anketim i bërë së fundi nga Qendra për Studime Sociale dhe Ekonomike në Tiranë ka treguar që 13 për qind e prindërve i detyrojnë fëmijët të punojnë në mënyrë që të ndihmojnë familjet e tyre.

Ndërsa kërkojnë zgjidhje për varfërinë, shumë familje rome i janë drejtuar emigrimit afatshkurtër ilegal, kryesisht në Greqi. Sipas anketimit të përmendur më sipër, 84,7% e të intervistuarve romë në Fier, thonë që ata

<sup>4</sup> AMARODROM Albanian Roma Union, 2001

vetë ose ndonjë anëtar tjetër i familjes së tyre kanë emigruar. Përveç kësaj, emigrimi i paligjshëm është bërë akoma më i vështirë dhe ka qenë shkak i një stresi të vazhdueshëm në strukturën sociale të familjeve.

## Romët jetojnë në Shqipëri që para 600 vjetësh. Ata mbërriten këtu qysh para pushtimit osman. Nga studimet e bëra, kjo popullsi erdhi nga India në Ballkan. – Strategjia Kombëtare për Romët

Megjithatë, duhet thënë se asnjë nga këto burime nuk sjell të ardhura të mjafta për familjet e emigrantëve për të zvogëluar varfërinë.

Ajo që përbën një pikë edhe më kritike ë kufizimi i programeve të sugrimit social, që sot nuk i mbështetin gjithnjë familjet e varfra rome.

Një problem tjetër vërtet i rëndë ndër familjet Rome të rrethit të Fierit është trafikimi i femrave për prostituium. Arsyeja kryesore e këtij fenomeni është varfëria ekstreme e familjeve Rome dhe martesat e vajzave në moshë të mitur (14-16 vjeç). Sipas të dhënave të një anketimi bërë më 2003, 83,1% e grupeve Rome në rrethin e Fierit e pranojnë se trafikimi i femrave është problem në bashkësinë e tyre. Megjithatë, nuk ka të dhëna të sakta për numrin e viktimave, gjë që e kufizon kuptimin e problemit.

Fëmijët e disa familjeve janë gjithashtu viktimat e trafikimit, sepse trafikantët i përdorin ata si lypës, veçanërisht në Greqi. Ka kryesisht tre mënyra të trafikimit të fëmijëve: 1) ata merren “me qira” nga familje të tjera për qëllime përfitimi; 2) dërgohen nga familjet për të punuar në qytetet më të afërta; ose 3) emigrojnë jashtë shtetit së bashku me familjet e tyre dhe punojnë si emigrantë të paligjshëm.

Strategjia Kombëtare e vitit 2003 për Përmirësimin e kushteve të jetesës së popullsisë Rome, ka si objektiva rritjen e numrit të fëmijëve Romë që shkojnë në shkollë, të nxisë trashëgiminë kulturore dhe vlerat e familjes, të rrisë mundësitë për punësim dhe të ulë varfërinë, të përmirësojë shëndetin e nënave dhe fëmijëve. Kjo strategji është një kuadër i nevojshëm për të ndërmarrë veprime për përmirësimin e kushteve të jetesës së romëve.

## Çështjet e gjinive

Nxitja e barazisë gjinore dhe fuqizimit të gruas është i treti në Objektivat e Mijëvjeçarit. Zhdukja e pabarazisë gjinore në arsimin fillor dhe të mesëm deri më 2005 dhe në gjithë nivelet më 2015, është synimi kryesor i këtij objekti. Tregusit që kanë të bëjnë me këtë synim lidhen me raportin midis vajzave dhe djemve që ndjekin shkollën fillore dhe të mesme, si dhe me përfshirjen e grave në rolet e vendimmarrjes. Gratë përbëjnë 49.9% të popullsisë së Qarkut të Fierit (Fier, Lushnje, Mallakastër).

Një çështje me rëndësi që duhet trajtuar në qarkun e Fierit lidhet me dhunën kundër grave, e cila përfshin trafikimin dhe dhunën brenda familjes. Sipas OSBE-së (maj 2002) ka 6 çështje të mbyllura dhe 20 në proces në Gjykatë për trafikimin e grave me qëllim prostitucioni e shfrytëzimi të prostitucionit me rrethana rënduese. Departamenti i Çështjeve Sociale në Fier ka regjistruar 153 raste prostitucioni dhe 210 çështje të dhunës në familje, që të gjitha për vitin 2002. Informacioni në dispozicion tregon vetëm një tablo të pjesshme të gjendjes, sidomos për shkak të diferencave ndërmjet rasteve të njoftuara dhe numrit real të grave viktime. Dihet fare mirë se shumica e grave, sidomos në zonat fshatare, nga vijjnë shumica e rasteve të njoftuara, nuk e denoncojnë dhunën. Në qarkun e Fierit nuk ka qendra për gratë, të cilat do të jepnin këshilla e mbështetje për viktimat aktuale dhe ato të mundshme.

## Arsimimi i grave

Ligji i arsimit në Shqipëri garanton të drejta të barabarta për djemtë dhe vajzat. Në Shqipëri, shkolla fil-

lore është e detyrueshme për të gjithë fëmijët, pavarësisht prej gjinisë (femër apo mashkull) dhe nuk ka diferencë thelbësore përsa i përket ndjekjes së shkollës nga të dyja gjinitë.

Gjendja e regjistrimit në shkolla për vitin 2002-2003 është pozitive. Nga 61.398 nxënës të regjistruar në nivelin fillor të arsimimit (shkolla 8-vjeçare) në këtë Qark, 30.211 prej tyre janë vajza dhe 31.187 janë djem (raporti 0.969).

Raporti djem-vajza në nivelin fillor të arsimimit është i njëjtë me raportin meshkuj-femra të popullsisë totale të qarkut. Vetëm në rrethin e Lushnjes numri i vajzave që ndjekin shkollën fillore është më i lartë se ai i djemve (raporti 1.011). Anasjelltas, ky raport është më i ulët për vajzat në rrethin e Mallakastrës (raporti 0.901) (shih tabelën 1).



Numri i vajzave që ndjekin nivelin e dytë të arsimimit është më i lartë se ai i djemve në të gjithë Qarkun (raporti 1,133). Ka 6.135 vajza dhe 5.413 djem që ndjekin këtë nivel në shkollë qarku. Megjithatë ka një përqindje femrash që nuk e ndjekin shkollën e mesme në zonat e largëta fshatare për arsye të ndryshme, ndër të cilat hyjnë largësia nga shtëpitë e tyre në shkollë. Shpenzimet për libra e transport, si dhe zakonet që e kufizojnë vajtjen e vajzave në shkollë.

Një krahasim në bazë rrethi tregon se rrethi i Lushnjes dallohet për numrin më të madh të vajzave (2446 krahasuar me atë të djemve 1291; raporti 1.894). Pastaj vjen rrethi Fier me 2991 vajza krahasuar me 3201 djem (raporti 0.934) dhe e fundit Mallakastra me 698 vajza krahasuar me 921 djem (raporti 0.75). Numri më i madh i vajzave që ndjekin shkollat e

► Tabela 1: Popullsia femra në Qarkun e Fierit

Rrethet	Popullsia totale	Numri i femrave	% e femrave
Fieri	199 082	100 187	50.3
Lushnja	143 933	71 501	49.7
Mallakastra	39 529	19 264	48.7
Qarku	382 544	190 952	49.9

Burimi: Regjistrimi i INSTAT-it 2001



**Tabela 2: Regjistrimi në nivele të ndryshme të arsimit në Qarkun e Fierit**

	Arsimi Fillor			Arsimi i Mesëm		
	femra	meshkuj	raporti F/M	femra	meshkuj	raporti F/M
Fier	15 374	16 156	0.951	2991	3201	0.934
Lushnje	11 637	11 508	1.011	2446	1291	1.894
Mallakastër	3200	3523	0.901	698	921	0.75
Qarku	30211	31187	0.969	6135	5413	1.133

Marrë nga: Departamenti i Arsimit: Gjendja më 2002 - 2003

mesme në Qark shpjegohet me faktin që arsimimi i vajzave ende konsiderohet si një investim që mund të lehtësojë më vonë punësimin e tyre dhe sigurimin e një jete financiarisht më të mirë. Numri i ulët i djemve që ndjekin shkollat e mesme mund të shpjegohet me faktin që shumë prej tyre ose lënë vendin për arsye emigrimi menjëherë pas mbarimit të shkollës 8-vjeçare, ose përfshihen në biznesin e familjes, ose punojnë në fushë, veçanërisht kur burrat e tjerë të familjes janë jashtë shtetit.

Megjithatë, pavarësisht nga shifrat pozitive për shkollat e mesme, mbetet fakti që në Qarkun e Fierit vetëm 1/5 e vajzave që përfundojnë nivelin e parë të arsimimit, ndjekin nivelin e mesëm. Kjo rënie e dukshme e numrit të nxënësve që ndjekin arsimin e mesëm mund të vijë për një varg shkaqesh, ndër të cilat distanca e gjatë nga banesat e vajzave në godinat e shkollave, mungesa e sigurisë, veçanërisht për vajzat, mungesa e transportit publik ose zakonet e rrënjësura, që i largojnë vajzat nga nevoja për të kërkuar arsimin e lartë (shih tabelën 2).

Megjithëse përqindja e vajzave analfabete në Qarkun e

Fierit, 1,3 % mund të konsiderohet e ulët, në krahasim me normën kombëtare (tabela 3), analiza krahasuese ndërmjet rretheve tregon se Lushnja ka shkallën më të madhe të analfabetizmit për femrat, ndërsa Fieri ka më të ultën.

### Gratë në tregun e punës

Gratë përbëjnë 74.7% të të punësuarve në Qarkun e Fierit, ose nga 144.615 të punësuarit në Qark, 108.084 janë femra. Kjo pasqyrohet mirë në vlerat e Treguesit të zhvillimit të gjinive (TZHGJ) dhe në Matjet e Fuqizimit të Gjinive (MFGJ), përkatësisht 0,783 dhe 0,438, duke e renditur Fierin ndërmjet rretheve me Tregues të lartë të Zhvillimit dhe të Fuqizimit të Gjinive, i dyti pas Tiranës.

Situata për çdo rreth të qarkut është si më poshtë: në Mallakastër gratë përbëjnë 80,4 % të të punësuarve, në Fier 72,3 % dhe në Lushnje 70,4 %.

Me gjithë munrin e madh të grave të punësuar në Qarkun e Fierit, krahasuar me numrin e burrave, problemi i diskriminimit të grave në vendet e punës ende

**Tabela 3: Shkalla e analfabetizmit 2001 (Popullsia mbi 6 vjeç)**

	Popullsia totale	Vajza
Fieri	0.8	1.1
Lushnja	2.1	1.5
Mallakastra	1.1	1.4
Qarku	0.9	1.3
Shqipëria	1.6	1.9

Marre nga: Census 2001

**Tabela 4: Numri i të punësuarve dhe fondi i pagesave për vitin 2002**

	Fieri Total	Fem	% Fem	Lushnja Total	Fem	% Fem	Mallakastra Total	Fem	% Fem	Qarku Total	Fem	% Fem
Punonjës Total	11070	3936	35.5	3796	2061	54.2	2981	972	32.6	17847	6969	39
Poste drejtuese	661	193	29.1	345	142	41.1	201	28	14	1207	363	30
Specialistë me arsim të lartë	2248	1292	57.5	1190	682	57.3	312	153	49	4113	2127	51.7
Teknikë me arsim të mesëm	1945	1225	63	1226	879	71.7	519	282	54.3	3690	2386	64.6
Punonjës të zakonshëm	423	256	60.5	174	112	64.4	85	36	42.3	682	404	59.2
Punëtorë	5793	970	16.7	861	246	28.6	1864	473	25.4	8518	1689	19.8
Buxhetorë	4301	2731	63.5	3109	1874	60.2	912	490	53.7	8322	5095	61.2
Jo buxhetorë	6769	1205	17.8	687	187	27.2	2069	482	23.3	9525	1874	19.7
<b>Fem - Femra</b>												

Marrë nga Zyra e Punës e Fierit

ekziston. Të dhënat nga fondet mujore të pagesave në Qarkun e Fierit, për vitin 2002 tregojnë që nga 11 070 të punësuar ne total 35,5 % janë gra. Megjithatë, vetëm 29,1 % nga numri total i grave që punojnë janë në poste drejtuese.

Në rrethin e Lushnjes nga 3 796 nëpunës 54,2 % janë gra, nga të cilat 57,3 % kanë nivelin më të lartë arsimor, por vetëm 41,1 % janë në poste drejtuese. Mallakastër ka shifrën më të ulët. Nga 2 981 nëpunës për vitin 2002, 32,6 % janë femra, 49 % e të cilave me arsim të lartë, por 14 % kanë poste drejtuese. Në Mallakastër gratë përbëjnë 54,3 % të nëpunësve me arsim të lartë dhe 42,3 % të nëpunësve të tjerë (shih tabelën 3).

Përqindja e grave të punësuar në sektorin jo bujqësor është një nga treguesit e lidhur me qëllimin për të nxitur barazine gjinore dhe fuqizimin e gruas. Një pjesëmarrje më e madhe dhe më aktive e grave në sektorin jo bujqësor, jo vetëm u hap mundësi më të mëdha pavarësie por gjithashtu ofron një rreze më të gjerë për kontributin e tyre në shoqëri. Të dhënat e vitit 2002 tregojnë që gratë vazhdojnë të kontribuojnë me efektivitet në sektorë të ndryshëm, të tillë si arsimi, shëndetësia, administrata publike, aktivitetet financiare, telekomunikacioni, etj. Të dhënat tregojnë një pjesë-

marrje më të ulët te sektorë të tillë si tregtia, ndërtimi dhe industria e përpunimit.

### Gratë në poste ekzekutive

Në përgjithësi, në nivel kombëtar, numri i grave në poste ekzekutive është i kufizuar, vetëm 20,9% të posteve në këtë kategori (Raporti për zhvillimin njerëzor në Shqipëri i vitit 2002). Në Qarkun e Fierit ka 5,2% të grave në postet administrative në sektorin publik. Në Lushnje janë 142 gra në poste ekzekutive në sektorin publik dhe 2016 gra në sektorin privat.

Sektori privat duket se ka krijuar më tepër mundësi për gratë që të jenë në pozicione drejtuese, por e vlen të përmendet se ky rol kufizohet vetëm te disa aktivitetet, kryesisht në tregti.

### Gratë në poste vendimmarrëse

Pjesëmarrja e grave në strukturat politike dhe vendimmarrëse është e ulët në nivel kombëtar. Ndonëse kemi një sasi të kufizuar të dhënash për këtë fushë në Qarkun e Fierit, shihet se edhe këtu po ashtu është e ulët pjesëmarrja e grave në partitë politike, dhe për pasojë pak prej tyre janë përfshirë edhe në strukturat drejtuese politike të qarkut.

**Tabela 5: Gratë në poste drejtuese**

	Gra në poste drejtuese në sektorin publik	Gra punëdhënëse
Fier	193	3936
Lushnje	142	2061
Mallakastër	28	972
Qarku	363	6969

Burimi: Këshilli i Qarkut, Fier

**Tabela 6: Pjesëmarrja e grave në vendimmarrje në nivel kombëtar**

	Kuadri Kombëtar			Qarku i Fierit	
	Total	Femra	%	Femra	%
Deputetë të Parlamentit	140	8	5.7	-	-
Komisione Parlamentare	13	-	-	-	-
Ministra	19	2	10.5	1	5.2
Zëvendësministra	23	1	4.3	-	-
Anëtarë të Gjykatës së Lartë	11	5	45.4	-	-

Burimi për kuadrin kombëtar: Përgjigjja Shqiptare për OM-it (2002), Për Fierin: Baza e të dhënave të Këshillit të qarkut

Numri i grave që kandidojnë për në parlament dhe drejtuese të pushtetit lokal është i kufizuar. Nga 12 parlamentaëe të cilet përfaqësojnë Qarkun e Fierit, vetëm një është grua. Gjatë zgjedhjeve të fundit parlamentare të 2201, në të gjithë Qarkun e Fierit, ishte vetëm një grua që kandidonte. Parlamenti Shqiptar ka vetëm nëntë gra deputete, nga të cilat dy janë zëvendëskryetare parlamenti, por asnjëra prej tyre nuk drejton ndonjë komision parlamentar. Këshilli i tanishëm i Ministrave i Republikës së Shqipërisë ka 3 gra ministre nga 19 ministra, një nga të cilat është në të njëjtën kohë zëvendëskryeministre. Së fundi, ka 4 gra zëvendësministre të cilat drejtojnë ministri të ndryshme.

Gjatë dhe pas zgjedhjeve të fundit parlamentare (qershor 2001) u ngrit si çështje rritja e pjesëmarrjes së gruas në fushën politike. Përmbushja e këtij qëllimi kërkon një strategji kombëtare që do të tregonte mundësitë për të inkurajuar gratë të kandidojnë për poste politike si dhe për të marrë pjesë më shumë në aktivitetet e partive politike. Meqë partitë politike nuk janë shumë aktive për ta arritur këtë qëllim lidhur me ngritjen e femrave në organizatat e tyre, pjesëmarrja e grave në organizatat politike mbetet e ulët. Sot për sot fusha e politikës edhe mbetet fusha në të cilë burrat e kapërcejnë shumë numrin e grave.

Megjithatë, pas zgjedhjeve parlamentare të 2001 (ku u shënuar pjesëmarrja më e ulët e grave që prej vitit 1920) organizatat e grave pranë partive politike po ndërmarrin hapa konkretë për të inkurajuar pjesëmarrjen e grave dhe për një përfaqësim më të mirë brenda partive politike.

Të dhënat e mësipërme tregojnë që roli i grave në strukturat e pushtetit lokal është i kufizuar. Niveli i ulët i pjesëmarrjes së grave në pushtetin lokal ndoshta vjen për shkak të disa faktorëve, ndër ta: konkurrenca e shtuar për zgjedhje, mbështetja e pamjaftueshme për gratë kandidatë, mbështetja e paktë për gratë, niveli i ulët i pranisë së grave në strukturat e partive politike, si dhe ligji elektoral që kërkon prej kandidatit të këtë arsimin universitar. Këto çështje dhe kritere ndonjëherë e bëjnë të pamundur për gratë të fitojnë poste në pushtetin vendor. Për përfaqësimin më të barabartë gjinor pushtetin vendor kërkohet angazhim më i madh dhe më shumë vëmendje nga të gjithë aktorët institucionalë në Qark. Klima e sotme politike lidhur me çështjen e gruas në politikë mund të mos kontribuojë për konkurrencë të barabartë, të mbështetur në vlerat respektive të secilit kandidat.

Të dhënat e pjesëmarrjes së grave në strukturat dhe organizatat e shoqërisë civile në këtë Qark, japin një pamje tjetër. Pjesërisht ngaqë pjesëmarrja e grave brenda vetë partive politike është e kufizuar, gratë e qarkut janë organizuar më tepër në organizatat e pavarura të shoqërisë civile. Organizata të tilla si “Gratë Rurale”, “Me ju dhe për ju Vajza”, “Forumi i Pavarur i Grave”, “Të drejtat e Grave”, etj., janë vetëm disa nga shembujt e organizatave, të cilat punojnë për problemet e grave. Këto organizata merren me çështjet që prekin gratë dhe përfshijnë fusha të tilla, si trafikimi, arsimi, fuqizimi dhe përfaqësimin më të drejtë në strukturat drejtuese të rajonit.

Të dhënat e pjesëmarrjes së grave në strukturat dhe organizatat e shoqërisë civile në këtë Qark, japin një pamje tjetër. Pjesërisht ngaqë pjesëmarrja e grave brenda vetë partive politike është e kufizuar, gratë e qarkut janë organizuar më tepër në organizatat e pavarura të shoqërisë civile. Organizata të tilla si “Gratë Rurale”, “Me ju dhe për ju Vajza”, “Forumi i Pavarur i Grave”, “Të drejtat e Grave”, etj., janë vetëm disa nga shembujt e organizatave, të cilat punojnë për problemet e grave. Këto organizata merren me çështjet që prekin gratë dhe përfshijnë fusha të tilla, si trafikimi, arsimi, fuqizimi dhe përfaqësimin më të drejtë në strukturat drejtuese të rajonit.

**Tabela 7: Pjesëmarrja e grave në Pushtetin Lokal**

Fier 1997 -2000	Fier 1997- 2000			Fier 2000 -2003			Kuatridh Kombëtar		
	Total	Femra	%	Total	Femra	%	Total	Femra	%
Kryetarë Bashkie	6	0	-	6	1	16.6	65	8	12.3
Kryetarë të Këshillit Bashkiak	6	0	-	6	1	16.6	65	2	1.5
Kryetarë Komunash	36	0	-	36	0	0	309	5	1.6
Kryetar të këshillit të Komunës	36	0	-	36	1	2.7	309	7	2.3

Burimi për kuadrin kombëtar: Përgjigjja Shqiptare për OM-it (2002), Për Fierin: Baza e të dhënave të Këshillit të Qarkut



## Shëndetësia

Të dhënat e njoftuara për vdekshmërinë foshnjore (nën një vjeç) në qarkun e Fierit japin shifrën 17,4 për 1.000 foshnja të lindura të gjalla sipas INSTAT-it.

Sipas të dhënave të marra nga INSTAT-i, norma e vdekjes foshnjore është ulur në rrethin e Fierit e të Lushnjës, ndërsa është rritur në rrethin e Mallakastrës. Në zonat rurale kjo normë priret të jetë më e lartë për shkak të vështirësive për të pasur institucionet e kujderit tshëndetësor parësor dhe për shkak të nivelit të ulët të informacionit që i jepet popullsisë rreth kujdesit shëndetësor. Ushqimi i foshnjave me gj, që ka qenë një traditë në kulturën shqiptare, është në rënie. Një nga masat për ta përmirësuar gjendjen në zonat fshatare është ngritja e qendrave të kujdesit për nënat e fëmijët dhe e shtëpive të lindjes, sidomos në zonat fshatare ku norma e vdekjes foshnjore është më e lartë.

Vdekshmëria e nënave është shumë e kufizuar në qarkun e Fierit, afër 0. Kjo vjen pjesërisht si rezultat i rritjes së asistencës nga mamitë në zonat rurale dhe prej legalizimit të abortit që e ka ulur shkallën e lartë të vdekshmërisë nga abortet e paligjshme.

Prirjet e abortit në Shqipëri kanë pësuar ndryshime pas liberalizimit të tij. Datat që disponohen ka të ngjarë që i nëvlerësojnë shifrat reale, sepse shumë raste nuk njoftohen. Sipas të dhënave nga "Harta shëndetësore e Shqipërisë" (WHO-ECHO-MoH), numri i aborteve në rrethin e Fierit është i lartë në krahasim me rrethet e tjera të vendit. Më 2000 rrethi i Fierit paraqiste numrin më të lartë, menjëherë pas Tiranës.

Sipas disa burimeve, mbulimi me imunizim në qarkun e Fierit është i përshtatshëm. Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar për normë më të lartë në rrethin e Fierit sesa në Lushnje e Mallakastrë.

Sëmundjet kryesore që prekin popullsinë e qarkut të Fierit lidhen me ndotjen e ujit dhe të ajrit. Sëmundjet diarreike përbëjnë gati 50% të sëmundjeve infektive, të cilat ndodhin më shpesh në verë. Sëmundje akute të frymëmarrjes si astma dhe bronkitet ndodhin shpesh gjatë gjithë vitit, megjithatë norma e këtyre sëmundjeve rritet në dimër për shkak të përdorimit të sistemeve ngrohëse. Me gjithë mungesën e të dhënave sakta, cilësia e keqe e ajrit për shkak të ndotjes konsiderohet si shkaku kryesor i këtyre sëmundjeve. Së-

**Tabela 8: Numri i lindjeve të gjalla, vdekjet nën 1 vjeç dhe vdekshmëria foshnjore**

	Numri i lindjeve të gjalla			Numri i vdekjeve nën 1 vjeç			Vdekshmëria foshnjore (për 1.000 lindje të gjalla)		
	1999	2000	2001	1999	2000	2001	1999	2000	2001
Rrethi i Fierit	3,208	3,298	3,749	36	24	24	11.22	7.28	8.27
Rrethi i Lushnjës	2,451	2,292	2,344	34	27	27	13.87	11.78	10.24
Rrethi i Mallakastrës	675	797	860	3	6	6	4.44	7.53	16.28

Burimi: INSTAT, Zyra e Tiranës

➤ **Tabela 9: Numri i vdekjeve të nënave**

	Vdekjet e nënave		
	1999	2000	2001
Rrethi i Fierit	1	0	0
Rrethi i Lushnjes	0	0	0
Rrethi i Mallakastrës	0	0	1

Burimi: INSTAT, Zyra e Tiranës

➤ **Tabela 10: Numri i aborteve për 100.000 (2000)**

Numri i aborteve për 100.000. 2000	
Rrethi i Fierit	2303
Rrethi i Lushnjes	426
Rrethi i Mallakastrës	nuk ka të dhëna

Burimi: "Harta shëndetësore e Shqipërisë" (EHO-ECHO-MOH), tetor 2002

mundjet kardio-vaskulare janë sëmundjet më të dendura ndër sëmundjet kronike dhe një nga arsyet kryesore të vdekjeve në qarkun e Fierit sipas Ministrisë së Shëndetësisë.

Lidhur me sëmundjet HIV/AIDS, sipas të dhënave të marra nga Instituti i Shëndetit Publik, janë regjistruar 7 raste në qark (2 në Fier, 3 në Lushnje dhe 2 në Mallkastër). Rastet e para janë zbuluar që më 2000 dhe mënyra kryesore e transmetimit ka qenë heteroseksuale. Megjithatë, këto shifra ka të ngjarë që e nënvlerësojnë normën zotëruese reale për shkak të vështirësive të zakonshme në grumbullimin e të dhënave sasiore e cilësore, të cilat në rastin e HIV-it rëndohen prej frikës, tabuve, turpfit dhe mungesës së shtysave për të bërë testet.

Siç ndodh edhe në qarqet e tjera, ende janë të ulët treguesit e incidencës dhe të të mbizotërimit. Megjithatë, studimet e bëra në shkallë kombëtare (MICS<sup>6</sup>, KAPB<sup>6</sup>, RAR<sup>8</sup>) tregojnë për nivele të larta ose për sjellje të rrezikuar, ndërsa po të mbahen parasysh rrethanat e tjera shoqërore dhe ekonomike, si niveli i lartë i lëvizshmërisë, ndryshimet e shpejta në vlerat dhe normat shoqërore, nivelet e ulëta të informimit e të ndërgjegjësimit etj., ka të ngjarë që të shtohen normat e sëmundjes HIV në vitet e ardhshme.

<sup>5</sup> UNICEF-Shqipëri "Vlerësimi i Kushteve Ekonomike Sociale në Shqipëri" 2000

<sup>6</sup> UNEP, 2000: Vlerësimi paskonfliktual i mjedisit për Shqipërinë.

<sup>7</sup> F.Gishti, L.Bregasi, V.Rizaj, P. Isufi, Albpetrol Sh.A., Shkurt 2003: "Gjendja dhe Përshtatja e Mjedisit të fushave naftëmbajtëse në Kompaninë e Albpetrolit"

<sup>8</sup> Burimi kryesor i NOx janë dekompozimi nga bakteriet i organizmave organike dhe djegja e pyjeve. Burimi i kryesor i çlorimit të NOx, si rezultat i aktiviteteve njerëzore janë sektori i transportit, prodhimi i energjisë elektrike dhe të tjera.

Dy Bankat e Gjhatkut ekzistuese të qarkut (të vendosura në Fier e në Lushnjë) japin mundësinë për të bërë testin HIV (testi i shpejtë). Megjithatë, mundësitë për të marrë këshilla të përshtatshme para dhe më pas dhe kërkesat për të bërë testet janë fare të pakta.

Duhet përmendur se, sipas RAR, Fieri dhe Lushnja janë ndër qytetet ku po përjeton rritje prirja për përdorimin e narkotikëve (UNICEF, 2002). Po të mbahet parasysh se jashtë Tiranës nuk ka asnjë lloj shërbimesh trajtimi e rehabilitimi, përdorimi i drogave ka mundësi të bëhet problem shoqërore shëndetësor, i cili më mirë duhet të trajtohet nëpërmjet nismave të hereshme parandaluese.

Në nivel qarku duhen bërë fushata informimi, sensibilizimi dhe ndërgjegjësimi, duke mbajtur qëndrim përfshirës e shuëmsektorial, me qëllim që të prarandalohet përhapja e HIV/AIDS dhe e infetimeve të tjera të transmetueshme seksualisht.

### Mundësia e marrjes së shërbimit shëndetësor

Sistemi i kujdesit shëndetësor në Shqipëri ka formën e një rrjeti shërbimesh, i cili përfshin spitalet, qendrat shëndetësore dhe ambulancat. Sipas INSTAT-it, sistemi shëndetësor është kryesisht publik. Sektori privat mbulon klinikat dentare dhe farmacitë. Ministria e Shëndetësisë vendos standardet për ndërtimin e qendrave shëndetësore dhe ambulancave sipas numrit të popullsisë. Çdo komunë duhet të ketë të paktën një qendër shëndetësore, ku të ketë doktorë dhe infermiere ose

The level of some important indicators as lifetime, death and chronicle diseases are comparable to those of the developed countries, while infantile death, maternal death and acute infective disease are comparable to those of the countries in development. Source INSTAT

mami. Në të njëjtën mënyrë, çdo fshat i cili nuk mbulohej nga Qendra Shëndetësore e Komunës, duhet të ketë një ambulance me infermiere ose mami.

Kushtet e përgjithshme të spitaleve dhe qendrave shëndetësore nuk i plotësojnë nevojat e popullsisë. Problemet përfshijnë fonde të pamjaftueshme për mirëmbajtjen e infrastruktures dhe mjediseve, numri në rënie i doktorëve, cilësi e ulët e shërbimit dhe mungesa e ilaçeve. Për më tepër, pagat për doktorët janë të ulta dhe kostoja e ilaçeve për pacientin është e lartë. Ata që qëndrojnë në spitale për një kohë të gjatë mund të mos kenë mundësi të përdorin as pajisje bazë të tilla si çarçafe. Spitalet zakonisht kanë kushte johigjienike dhe numri i pacientëve në një dhomë është i lartë. Në nivel kombëtar, vlerësohet të jenë 1,3 doktorë që ofrojnë shërbimin e tyre për 1.000 banorë. Për të bërë krahasimin, në shtetet anëtare të Bashkimit Europian ka 3 doktorë për 1000 banorë dhe 2,5 doktorë për vendet e Evropës Lindore. Në qarkun e Fierit departamentet me bazë rrethi të Ministrisë së Shëndetësisë administrojnë shërbimin parësor shëndetësor, spitalet dhe farmacitë, ndërsa investimet dhe veprimet janë përgjegjësi e Pushtetit Lokal.

Qarku ka rrjetin prej tre spitalesh, një në secilin rreth, 48 qendra shëndetësore dhe 188 ambulanca nëpër fshatra. Në tërësi, 71% e fshatrave kanë një ambulancë me një infermiere në qarkun e Fierit. Rrethi Mallakastrës ka mbulimin më të paktë me shërbime shëndetësore. Siç e tregon Tabela 11, poikjërish në zonat fshatare është më e vështirë marrja e shërbimeve shëndetësore për popullsinë. Shumica e popullsisë së qarkut shkon në spitalet e vendosura në qendrat e komunave e të bashkive në rastet e urgjencave, por nganjëherë kjo kërkon disa orë për të arritur deri atje.

Në rajonin e Fierit, infrastruktura e shërbimit shëndetësor

Tabela 11: Numri i shërbimeve shëndetësore në qark

	Qendrat Shëndetësore			Ambulanca		Fshatra Total	Fshatra të mbuluara %	Numri i ambulancave të nevojshme
	Total	Rural	Urban	Total	Rural			
Rrethi i Fierit	18	14	7	100	18	82	117	21
Rrethi i Mallakastrës	21	14	4	77	12	65	117	38
Rrethi i Lushnjës	9	8	1	11	0	11	39	19
Qarku i Fierit	48	36	12	188	30	158	273	78

Burimi: Zyra e INSTAT-it, 2002

tësor dhe institucionet financohen kryesisht nga buxheti kombëtar, i cili ka bërë përpjekje për të rritur numrin e ambulancave në zonat rurale. Ka patur gjithashtu shembuj pozitivë të investimeve të pushtetit lokal dhe bashkësive për ndërtimin dhe rindërtimin e ambulancave në fshatra të largëta në Komunitet dhe Hekalit dhe Cakranit.

Përmes përpjekjeve të Organizatave me bazë bashkësie për të mobilizuar burime dhe për të zbatuar projekte, 5 nga këto ambulanca u ngritën gjatë muajve të parë të 2003, duke treguar potencialin e fortë që ka veprimi i përbashkët i bashkësive dhe pushtetit lokal kanë në përmirësimin e jetesës së tyre në qark. Ilaçet dhe doktorët financohen pjesërisht nga kujdesi shëndetësor primar kombëtar dhe nga skemat e sigurimeve shëndetësore, ose duhet të mbulohen nga vetë pacientët.

## Arsimi

Gjatë dekadave të fundit janë bërë disa reforma në nivelin arsimor kombëtar. Rishikimi i përmbajtjes së teksteve shkollore, përditësimi në trajnimet e mësuesve, risstrukturimi i organizmave administrative dhe ngritja e shkollave private në sistemin arsimor përbëjnë disa nga zhvillimet kyçe të ndodhura në këtë sektor. Në Qarkun Fier këto reforma kanë kontribuar për të ulur nivelin e analfabetizimit nga 7.3% në 1989 në afërsisht 1% në 2001, i cili është poshtë mesatares në nivel kombëtar. Sidoqoftë, me gjithë disa përmirësime në sistemin arsimor ka një varg çështjesh të cilat duhen zgjidhur, duke përfshirë numrin e madh të braktisjeve, cilësinë e dobët të mësimdhënies, mungesa e infrastrukturës së përshatshme shkollore dhe mjediseve për marrjen me sporte apo aktivitete kulturore. Situata është më kritike në zo-

nat rurale. Shkollat kanë mungesa baze materiale, rrogat e mësuesve janë të ulëta dhe vështirësia për të arritur në shkollat në fshatrat e thella nuk inkurajojnë mësues të kualifikuar për të punuar.

Për më tepër, nevojitet caktimi i standardeve kombëtare për infrastrukturën shkollore, metodave të mësimdhënies dhe kualifikimi i mësuesve. Së fundi fenomeni i punës së fëmijëve është një çështje shqetësuese në vend, e cila ka nevojë për studim të hollësishëm për rajonin. Në qarkun Fier arsimit është konsideruar nga bashkësia si një prioritet për zhvillimin në rajon pasi 42% e popullsisë është nën moshën 18 vjeç.

Lëvizja e popullsisë pati ndikim në shpërndarjen e shkollave në territorin e rajonit, dhe pak shkolla u mbyllën për shkak të numrit të paktë të nxënësve, ndërsa shkolla të reja u hapën në zonat me dendësi të madhe të popullsisë. Në Mallakastër p.sh. numri i shkollave fillore u ul nga 28 në 20 në këto 10 vitet e fundit.

Me qëllim që t'u përshtateshin më mirë kërkesave dhe nevojave për arsimim, nevojiten ndryshime të reja në shpërndarjen e shkollave në rajon. Rënia e numrit të klasave si në zonat rurale edhe në ato urbane lidhet me pakësimin e numrit të nxënësve që ndjekin shkollat, veçanërisht për shkak të emigrimit.

## Arsimi parashkollor

Rajoni i Fierit ka afërsisht 219 kopshte, nga të cilat 36 janë në qytete dhe 183 në fshatra. Në total, janë regjistruar 9.017 fëmijë. Qarku i Fierit renditet i katërti në nivel kombëtar për sa i përket numrit të fëmijëve që

► Tabela 12: Treguesit e arsimit për qarkun e Fierit, 2001

Rrethet	Analfabetizmi	
	Total	% e popullsisë
Fier	1550	0.8
Lushnja	1671	1.2
Mallakastra	384	1.0
<b>Qarku Fier</b>	<b>3,605</b>	<b>0.94</b>
<b>Shqipëria</b>	<b>3,491</b>	<b>1.4</b>

Burimi: Regjistrimi i vitit 2001

shkojnë në kopsht, me 15 nga 1000 fëmijë të regjistruar në institucionet parashkollore. Sidoqoftë, me gjithë regjistrimin relativisht të madh të fëmijëve në qarkun e Fierit, më tepër se gjysma e fëmijëve të moshës midis 3 dhe 5 vjeç nuk shkojnë në kopsht. Numri i paktë i kopshteve shkollore, mungesa e mjediseve shëndetësore të përshtatshme brenda shkollave, si dhe numri i madh i grave të papuna, janë disa nga shkaqet e kësaj shkalle të ulët regjistrimi të fëmijëve në parashkollore. Përparësitë që duhet të vendosen për përmirësime të mëtejshme, duhet të fokusohen në mjedise të reja, në qendrime të reja të cilat vënë në qendër të vëmendjes fëmijët në arsimin parashkollor, si dhe trajnime të mëtejshme për metodat e reja të mësimdhënies.

### Arsimi 8-vjeçar

Në qarkun e Fierit ka 156 shkolla tetëvjeçare, shumica ndodhen në rrethin e Fierit, dhe 87 shkolla fillore. Mundësia e vajtjes së nxënësve në shkolla quhet e kënaqshme në zonat urbane, ndërsa në zonat rurale mungesa e mjeteve të përshtatshme të transportit e bën shumë të vështirë për shumë fëmijë të frekuentojnë shkollat. Një sondazh i bërë më 2001 nga Këshilli i Qarkut<sup>9</sup> jep shi-

frat për rrethin e Fierit se vetëm 77% e fshatrave kanë shkollë 8-vjeçare dhe një nga arsyet për mosdërgimin e fëmijëve në shkollë ishte largësia nga shtëpitë, mungesa e mundësive ekonomike që të pajisen me libra dhe nevoja për t'i futur fëmijët në tregun e punës.

Gjatë vitit akademik 2000-2001, kishte 61 394 nxënës të regjistruar në shkollën 8-vjeçare, nga të cilët 68,48 % ishin nga zonat rurale. Rreth 97% e gjithë fëmijëve të regjistruar përfunduan arsimin e detyruar në shkollat në 2001. Kjo përqindje është më e lartë krahasuar me shifrën në nivel kombëtar 82%. Numri i atyre që morën dëftesë nga viti 2000 ka qënë në rënie, në fakt gjatë vitit shkollor 2002-2003, numri nxënësve që morën dëftesë ra me 4,76% krahasuar me 2001-2002.

Raporti nxënës për klasë në qarkun Fier është 35,9, tepër i lartë krahasuar me mesataren kombëtare 22,5 (2002). Analiza e veçantë për të tre rrethet tregon disnivel të madh në shpërndarjen e mësuesve në rajon. Ndërsa rrethi Fier ka raportin prej 31,4, në rrethin e Mallakastrës ka 50 nxënës për klasë. Kjo tregon për strategji të papërshtatshme në shpërndarjen e shkollave në rajon sipas numrit të nxënësve. Raporti nxënës-mësues është nën mesataren kombëtare prej 22.

**Tabela 13: Të dhëna për sistemin arsimor gjatë vitit shkollor 2002-2003**

	Numri i Shkollave		Numri i Nxënësve			
	Fillore	8-vjeçare	Fillore	8-vjeçare	Gjithsej	Rurale (%)
Fier	30	74	15,268	16262	31,530	62.3
Lushnja	37	56	11,316	12081	23,397	75.9
Mallakastra	20	26	3,096	3371	6,467	71.7
<b>Qarku</b>	<b>87</b>	<b>156</b>	<b>29,680</b>	<b>31714</b>	<b>61,394</b>	<b>68.48</b>

Burimi: Drejtoria Arsimore Buletini Statistikor

**Tabela 14: Raporti nxënës -klasë dhe nxënës -mësues - 2002-2003**

	Raporti nxënës/klasë	Numri i mësuesve	nxënës/mësues raporti në total	nxënës/mësues raporti në zonat rurale
Fier	31.4	1645	20	20
Lushnja	38.4	1207	20	20
Mallakastra	50.6	364	19	17
<b>Qarku</b>	<b>35.9</b>	<b>3216</b>	<b>20</b>	<b>16</b>

Burimi: Departamenti i Arsimit, Buletini statistikor

<sup>9</sup> Shkaku kryesor i çlirimit të SO<sub>2</sub> në atmosferë është djegia e karburanteve që përmbajnë squfur.

► Tabela 15: Braktisja e shkollave 2001- 2002

Rrethet	Gjithsej	% e Studenteve
Fier	472	1.42
Lushnja	313	1.3
Mallakastra	370	5.5
<b>Qarku</b>	<b>1155</b>	<b>1.8</b>

Burimi: Drejtoria Asimore, Buletini Statistikor

Gjatë vitit akademik 2001-2002, afër 1,8 % e nxënësve braktisën shkollat në të gjithë rajonin. Rrethi i Mallakastrës ka numrin më të madh të braktisjeve me 5,8%, ndërsa rrethi i Lushnjes shifrën më të vogël prej 1,3 %. Sipas Drejtorisë së Arsimit në rajon, gjatë tre viteve të fundit djemtë kanë pasur numrin më të madh të braktisjeve, për shkak të kushteve ekonomike në familje. Në 2000-2001 braktisja e shkollave nga meshkujt ishte 81,8 % , dhe në 2002-2003 u rrit 82,2 %. Pjesa më e madhe e rasteve për braktisjen e shkollave ndodh në zonat rurale ku raporti është 98,8 % gjatë 2000-2001 dhe 97,2 % gjatë 2002 - 2003. Në të vërtetë , vetëm 29% e fëmijëve regjistrohen në shkollat e mesme.

### Arsimi i mesëm

Aktualisht në qarkun e Fierit ka 36 shkolla të mesme, 4 nga të cilat janë shkolla profesionale. Harta 3<sup>10</sup> paraqet shpërndarjen e shkollave në territor dhe tregon se ka zona në qark me denësi të madhe popullore por pa shkolla të mesme, si komuna e Dukasit, ku fëmijët e kanë të vështirë të gjenë shkolla. Gjatë vitit shkollor 2000-2001 është llogaritur që 61% e nxënësve kanë përfunduar arsimin e mesëm dhe kjo shifer është e barabartë me atë në nivel kombëtar. Krahasimisht në qarkun e Tiranës shifra është pakëz më e lartë te 65%. Sidoqoftë, vetëm 57% e nxënësve që mbarojnë arsimin tetëvjeçar regjistrohen në arsimin e mesëm.

► Tabela 16: Regjistrimet në Arsimin e Mesëm - 2001-2002

	Numri i Shkollave të mesme	% e nxënësve që kanë përfunduar arsimin fillor dhe regjistruar në atë të mesëm	% e nxënësve që ndjekin shkolla profesionale
Fier	14	60%	6%
Lushnja	17	69.5%	6.5%
Mallakastra	2	40%	NA
<b>Qarku</b>	<b>36</b>	<b>57%</b>	<b>6.3%</b>

Burimi: Drejtoria Asimore,

► Tabela 17:Raporti nxënës- mësues - 2002-2003

	Raporti nxënës/Mësues Gjithsej	Raporti nxënës/Mësues në zonat rurale	Raporti nxënës / Klasë
Fier	19.69	10.4	25.4
Lushnja	21.33	18.5	24.7
Mallakastra	33.04	16.1	18.1
<b>Qarku</b>	<b>21.4</b>	<b>14.2</b>	<b>24.1</b>

Burimi: Drejtoria Arsimore, Buletini statistikor

<sup>10</sup> Ministria e Mjedisit: Gjendja e Mjedisit 1999-2000



harta 4



Secondary schools

- 0
- 0 - 1
- 1 - 2
- 2 - 3

Population

- 1406 - 3484
- 3484 - 8229
- 8229 - 15688
- 15688 - 40306
- 40306 - 61011



**Tabela 18: Shkollat Profesionale Publike dhe private 2003  
(Kurset për Trajnimet profesionale në qarkun Fier), 2003**

Kurse/Shkolla	Lloji i qendrave	Fier	Lushnja
Bujqësore	Shkolla Profesionale	1	1
Muzikë	Shkolla Profesionale	1	-
Elektronikë, shkenca kompjuterike, sekretari	Qendra Murialdo (financuar kryesisht nga urdhri Italian Murialdo) Shkollë 2-vjeçare	1	-

Burimi: Këshilli i Qarkut Fier

Raporti nxënës-mësues si dhe nxënës-klasë në Qark është më i ulët krahasuar me shifrën në nivel kombëtar. Një analizë e detajuar tregon se rrethi i Mallakastres ka raportin më të lartë të nxënësve për klasë.

Të rinjtë midis moshës 14 dhe 17 vjeç përfshijnë 39% të atyre që ndjekin arsimin e mesëm. Kjo përqindje e ulët mund të shpjegohet nga disa faktorë të rëndësishëm. Shumë komunitete nuk kanë shkolla të përshtatshme. Një problem tjetër është se fëmija apo prindërit dhe gjithashtu nuk e shohin arsimin e marrë si një alternative për punësim. Po ashtu si dhe disa prindër dhe fëmijë e konsiderojnë arsimin si pa lidhje me nevojat e lokalitetit ku jetojnë apo të tregut të punës. Migrimi është gjithashtu një arsye që ndikon në numrin e braktisjeve të shkollave.

Në qarkun e Fierit ka pasur një rritje të frekuentimit nga nxënësi, përfshirë edhe të rritur në shkollat profesionale. Vetëm 6,3% të nxënësve të regjistruar në shkollat e mesme kanë ndjekur shkollat profesionale. Ka nevojë për të ristrukturuar sistemin e shkollave profesionale. Në Fier për të rritur numrin e kurseve të ofruara, me qëllim që t'u përshtaten kërkesave të tregut.

Sipas SKZHSE, numri i shkollave të mesme është ulur me 55% në të gjithë vendin, për shkak të mbylljes së një numri të konsiderueshëm të shkollave profesionale.

#### Arsimi Universitar

Në qarkun e Fierit nuk ka universitet. Ashtu si në pjesën tjetër të vendit Qarku i Fierit ka pasur rritje të numrit të të rinjve që vazhdojnë universitetin.

Pavarësisht nga rritja me 5% të numrit të studentëve me moshë 18 deri 22 vjeç të regjistruar në Universitete që nga 1992 deri më 2000, numri i të diplomuarve është më i ulët sesa mesatarja në nivel kombëtar. Disa nga arsyet për këtë vlerë të ulët të të diplomuarve mund të shpjegohen me emigracionin dhe përfshirjen më të madhe në punët e bujqësisë.

Një sondazh kombëtar më 2003 i kryer nga MJAFTI, një fushatë në nivele kombëtare për veprim qytetar dhe nga qeveria e Studentëve në Universitetin e Tiranës, tregoi se studentëve u mungojnë mjediset themelore kudo në Shqipëri. Mbi 1000 studentë që u

**Tabela 19: Treguesit e Arsimit për Qarkun Fier, 2001**

Rrethet	Personat me Arsim të Mesëm		Personat me Arsim të lartë	
	Gjithsej	% Popullsia	Gjithsej	% Popullsia
Fier	40799	20.5	5929	2.9
Lushnja	25696	17.8	3650	2.5
Mallakastra	6543	16.5	634	1.6
<b>Qarku Fier</b>	<b>73038</b>	<b>20.0</b>	<b>9213</b>	<b>2.4</b>
<b>Shqipëria</b>	<b>594913</b>	<b>19.3</b>	<b>134110</b>	<b>4.3</b>

Burimi: Regjistrimi i vitit 2001



pyetën në sondazh shfaqën problemë të njëjta si mungesa e teksteve, kompjuterëve dhe bibliotekave për të kryer aktivitetet normale të studimit. Aspekte të tjera të sondazhit treguan se studentët kërkonin një dialog më të mirë me profesorët, disponueshmëri tekstesh dhe teknologjie, si dhe transparencë dhe përgjegjësi për tarifat që u janë vënë të gjithë studentëve në vend. Sondazhi vuri në dukje gjithashtu kushtet e këqija të jetesës në konvikte.

### Mësuesit

Të ardhurat e ulëta dhe mungesa e përfitimeve kanë qenë disa nga faktorët për mosmotivimin e mësuesve dhe uljen e numrit të mësuesve veçanërisht në zonat rurale. Numri i mësuesve në shkollat e mesme në qarkun e Fierit për vitin akademik 2001-2002 ishte 607, 8.5% më pak krahasuar me shifrat e vitit shkollor 1996-1997. Numri i mësuesve të kualifikuar është rritur në mënyrë të konsiderueshme në shkollat e mesme dhe është i lartë krahasuar me shifrat në nivel kombëtar.

### Investimet

Siç vihet re edhe në tabelën 22, shpenzimet dhe investimet në sektorin e arsimit në qarkun e Fierit janë të ulëta krahasuar me qarqet e tjera. Investimet e qeverisë në arsim kanë qenë konstante në 10 vitet e fundit, 9-10% e buxhetit vjetor, ose 3-4 % të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB). Vetëm për vitin 2000, në vend u ndërtuan 50 shkolla të reja dhe u rehabilituan 350 dhe nga këto 280 u financuan nga donatorë ndërkombëtarë.<sup>11</sup>

Afërsisht 75 % e investimeve përbëhet nga pagat, ndërsa 8-10% e buxhetit është dhënë për lloje të tjera investimesh siç janë pajisje shkollash. Autoritet lokale (nga bashkitë dhe komunat) gjithashtu kanë dhënë një kontribut të vogël për arsimin. Për më tepër ndihma private, kryesisht kontribute të bashkësive janë në rritje por megjithatë ato ngelen një sasi e vogël krahasuar me shumën totale

Lëvizjet e popullsisë nga zonat rurale në ato urbane ose jashtë kanë ndikuar në planifikimin e investimeve për infrastrukturën shkollore në qarkun Fier.

<sup>11</sup> UN, Komisioni Ekonomik për Europën 2002: rishikimet e kujdesit mjedisor: Shqipëria

Tabela 20: Numri i mësuesve të kualifikuar Viti 2002

Rrethet	Kopshtet		Shkolla 8-vjeçare		Shkolla e Mesme	
	Gjithsej Mësues	Mësues të Kualifikuar	Gjithsej Mësues	Mësues të Kualifikuar	Gjithsej Mësues	Mësues të Kualifikuar
Fier	207	85%	1628	81%	314	96%
Lushnja	168	71%	1189	90%	244	96%
Mallakastra	40	45%	371	79%	49	82%
Qarku	<b>415</b>	<b>75%</b>	<b>3188</b>	<b>84%</b>	<b>607</b>	<b>95%</b>

Burimi: Drejtoria e Arsimit Qarku Fier

► **Tabela 21: Shpenzimet dhe investimet e buxhetit në arsim sipas Qarqeve 2001**

Qarqet	Shpenzime (mijëra Lek)		Investime (mijëra Lek)	
	Gjithsej	Për 1000 banorë	Gjithsej	Për 1000 banorë
<b>Fier</b>	<b>1609</b>	<b>4.2</b>	<b>172</b>	<b>0.45</b>
Berat	931	4.82	68	0.3
Dibër	942	5	82	0.4
Durrës	936	4	42	0.1
Elbasan	1854	5	129	0.3
Gjirokastrë	865	8	90	0.79
Kukës	683	6	52	0.47
Lezhë	816	5	93	0.58
Shkodër	1546	6	150	0.58
Tiranë	5497	9	868	1.45

“Reforma në arsim është një domosdoshmëri. Kjo kërkon mësues dhe studentë që t’i marrin interesat e tyre me seriozitet dhe të kërkojnë zgjidhje drejt një jete akademike më të denjë.” *Edlira Haxhiymeri, Kryetare e Departamentit të punëve Sociale në Universitetin e Tiranës.*

Fieri nuk bën përjashtim nga problemet që po has sistemi i arsimit në Shqipëri. Midis masave të tjera, ka nevojë për bashkëpunim midis Organizatave jofitimprurese (OJF-të). OJF-të kanë luajtur rol të rëndësishëm për të përmirësuar kushtet e shkollave. Një bashkëpunim më i madh midis aktorëve dhe qeverisjes lokale inkurajohet për të ndërtuar plane efektive që bëhen në përputhje me Strategjinë e Arsimit. Për më tepër, duhet rritja e bashkëpunimit me bashkësinë dhe investimet e shtetit. Përfshirja e bashkësisë në çështje të tilla si arsimit është një fenomen i ri. Nevojitet të zbulohen mënyra të tjera mbështetjeje nga bashkësia (jo vetëm financiare) që mund të ndihmojnë në zhvillimin e shkollave dhe të gjithë sistemit arsimor.

## Tendencat ekonomike në qarkun e Fierit

Gjatë dhjetë viteve të fundit të tranzicionit ekonomik, nga një ekonomi e planifikuar shtetërore në një ekonomi tregu, në qarkun e Fierit ka pasur dy faktorë kryesorë të cilët kanë çuar në rënien e ekonomisë dhe rritjen e varfërisë për shumë familje. Në zonat urbane, mbyllja, rinovimi dhe privatizimi i ndërmarrjeve ekonomike, u shoqërua me papunësi masive.

Investimet e vendit dhe ato të huaja nuk krijuan vende punë të mjaftueshme që të punësoheshin shumë nga këta njerëz, të cilët më parë ishin në punë në ndërmarrjet e mëdha shtetërore. Ndërsa në zonat rurale, shpërndarja e tokës, e cila u përkiste fermave shtetërore dhe kooperativave, për familjet fshatare krijoi ekonomi të vogla, në shumicën e rasteve dolë të pamjaftueshme.

Kështu në qarkun e Fierit banorët e zonave urbane janë të papunë, ndërsa në fshatra njerëzit nuk janë në gjendje të sigurojnë burimet e jetesës në tokën që kanë në pronësi. Të dy grupet i zgjidhin këto vështirësi në mënyra të ngjashme nëpërmjet punëve të rastit (kryesisht në sektorin joformal që mund të përfshijë emigrimin sezonal në Greqi apo Itali), mbështeten të të ardhurat nga familjarët që punojnë jashtë shtetit ose marrin një ndihmë nga shteti. Në zonat fshatare njerëzit shpesh zhvendosen në qendrat urbane.

## Bujqësia

Prodhimi bujqësor siguron 50 % të gjithë të ardhurave vetjake në qarkun e Fierit. Ky Qark përbën një pjesë të konsiderueshme të prodhimit kombëtar bujqësor. Qarku i Fierit ka 17,5 % ose 122.241 hektarë të tokës bujqësore të vendit dhe eksporton mjaft prodhime bujqësore e blegtorale për tregjet e tjera brenda Shqipërisë. Kultivimi, duke përfshirë grurin, misrin, perimet, bimët industriale dhe foragjeret, mbulon gati 86% të sipërfaqes bujqësore të qarkut, ndërsa pyjet mbulojnë 14%. Siç e tregon tabela, rrethi i Fierit ka bujqësi më të zhvilluar dhe më shumë pyje sesa rrethet e tjera.

Porse Mallakastra, duke patur kushte të ndryshme natyrore, përbëhet nga rreth 48% pyje dhe 52 % kullota e livadhe. Karakteristika të tilla dalluese brenda

Qarkut duhen mbajtur parasysh gjatë hartimit të programeve ekonomike, të mjedisit ose habitatit për të siguruar shfrytëzimin e frytshëm e të qëndrueshëm të burimeve të tij natyrore.

## Bimët e arave

Qarku i Fierit dallohet për diversitetin në kultivimin e bimëve të arave, ku hyjnë gruri, misri, perimet, bimët industriale dhe foragjeret. Bimët më të zakonshme që mbillen në këtë Qark janë foragjeret, gruri e drithërat e tjera. Siç e tregon tabela, sipërfaqja e mbjelle me këto bimë përbën një pjesë të ndjeshme për prodhimin kombëtar; mbi 20% të prodhimit të drithërave dhe të perimeve në shkallë vendi (përveç patateve) del nga Fieri. Mbjellja e disa bimëve industriale të tilla si lulja e diellit dhe soja është e përqendruar në Fier, ku mbulojnë respektivisht 83,5 dhe 72,5 për qind të sipër-

► Tabela 22: Struktura e tokës bujqësore më 2002 (në hektarë)

Rrethet	Ara	Pyje	Kullota	Të tjera
Rrethi i Fierit	48,804	7,642	897	15,156
Rrethi i Lushnjes	46,367	4,708	440	15,161
Rrethi i Mallakastrës	9,895	4,825	2,036	12,000
<b>Qarku Fier</b>	<b>105,066</b>	<b>17,175</b>	<b>3,373</b>	<b>42,317</b>
Shqipëria	578,073	121,010	4,22,239	7,12,853

Marrë nga: Raporti vjetor i Statistikave për Bujqësinë dhe Ushqimin Tiranë, Prill 2003

► Tabela 23: Struktura e bimëve të mbjella për vitin 2002 (në ha)

Bima bujqësore	Shqipëria	Qarku i Fierit	% kombëtare	Fier	Lushnja	Mallakstra
1. Drithëra	157707	34464	21.8	15775	14509	4180
• Grurë	93382	25190	27.0	11010	11180	3000
• Misër	50013	6307	12.6	3555	2172	580
2. Perime	33626	7073	21.0	2622	4154	297
3. Patate	10630	1466	13.8	454	820	192
4. Fasule	17423	4919	28.2	2994	1700	225
5. Duhan	2275	129	5.7	105	12	12
6. Lule dielli	1728	1443	83.5	80	1360	3
7. Soja	189	137	72.5	114	10	13
8. Foragjere	170611	39472	23.1	17744	19328	2400

Marrë nga: Raporti vjetor i Statistikave i Bujqësisë dhe Ushqimit. Tiranë, prill 2003

► **Tabela 24: Sipërfaqja, rendimenti dhe prodhimi i drithrave**

Emri	1997	1998	1999	2000	2001	2002
Sipërfaqja ne ha	45580	46103	39445	40309	36416	34464
Prodhimi ne ton	147515	134671	108340	134408	108526	115431
Rendimenti ne kv/ha	32.4	29.2	27.5	33.3	29.8	33.3
Drithra, kg/banor	316.8	284.8	227.3	279.4	283.7	296

Marrë nga: Statistikat e rrethit, Raporti vjetor i Statistikave i Bujqësisë dhe Ushqimit. Tiranë, prill 2003

faqes në shkallë kombëtare. Ndonëse mbjelljet nuk përouthen detyrimisht me sasinë e të korrave, përsëri mund të thuhet në mënyrë të arsyeshme se qarku i Fierit përbën prodhuesin më të rëndësishëm të produkteve bujqësore në Shqipëri, sidomos për sa u përket drithërave dhe foragjereve.

Një mënyrë për të gjykuar rreth prodhimit të madhe të qarkut është të shqyrtohet sasia e grurit për banor; në Fier prodhohen 197 kg grurë çdo vit për frymë, ndërsa mesatarja kombëtare është 92 kg për frymë.

Me gjithë suksesin në sektorin bujqësor, konkurrenca që vjen nga importimi i miellit me çmim të ulët (për shkak të kostos së ulët dhe financimeve ndërkombëtare) ka çuar në uljen e prodhimit të drithrave. Siç e tregon tabela, nga 1997 deri në 2002 sipërfaqja e mbjellë me drithra ka rënë me gati 25% dhe ka çuar në uljen e prodhimit me 11,8%.

Rënia më e prekshme e sipërfaqes së mbjellë me drithra është në rrethin e Lushnjës, nga 19.280 ha në 1996 në 14.509 ha në 2002. Në të njëjtën periudhë kohore, rënia në Fier ishte nga 17.156 ha në

15.775 ha, dhe në Mallakastër ishte nga 4.905 në 4.180 ha. Megjithatë, përmes prodhimit të vet qarku i Fierit ka qenë në gjendje të plotësojë nevojat e popullsisë ëe vet. Pjesa e mbetur është kaluar në tregun kombëtar.

Rënia e sipërfaqes së drithrave është kompensuar nga rritja e sipërfaqes së mbjellë me perime dhe foragjere. Ndërsa sipërfaqja e mbjellë me bimë industriale ka mbetur e njëjtë. Sipërfaqja e foragjereve është rritur me 32,5% që nga 1996. lidhur me rritjen e kërkesës për ushqim për bagetinë.

### **Pemëtaria dhe ullinjë**

Siç e tregon tabela, Qarku i Fierit ka 362 mijë pemë frutore të cilat janë në prodhim; kjo përbën 8% të numrit në shkallë kombëtare. Qarku i Fierit renditet i dyti, pas Beratit për numrin e rrënjëve dhe prodhimin e ullirit. Gjatë 6 viteve të shkuara, numri i pemëve frutore në gjendje prodhimi dhe niveli i prodhimit të tyre nuk kanë ndryshuar. Nga viti 1997 e më pas ka pasur një rënie graduale në numrin e drurëve të ullinjëve dhe luhatje në sasinë e prodhimit. Shifrat janë të ngjashme me prirjen në gjithë Shqipërinë.

► **Tabela 25: Numri i pemëve në prodhim, rendimenti i prodhimit frutor**

Emri	1997	1998	1999	2000	2001	2002
Pemë frutore në gjendje prodhimi, në mijë	325	362	367	362	382	362
Prodhimi frutor, në ton	5490	7183	4869	5849	5573	5213
Rendimenti, kg/pemë	16.9	19.8	13.3	16.2	14.6	14.4

Marrë nga: Statistikat e rrethit, Raporti vjetor i Statistikave i Bujqësisë dhe Ushqimit, Tiranë, prill 2003

► Tabela 26: Numri i ullinjve në prodhimi, rendimenti dhe prodhimi i ullinjve

Emri	1997	1998	1999	2000	2001	2002
Rrënjë ullinj në prodhimi, në mijë	872	732	771	682	684	696
Prodhimi i ullinjve, në ton	8973	16156	11387	11044	9573	6537
Rendimenti, kg/pemë	10.3	22.1	14.8	16.2	14	9.4
Ullinj, kg/person	19.3	34.2	23.9	23	25	16.8

Marrë nga: Statistikat e rrethit, Raporti vjetor i Statistikave i Bujqësisë dhe Ushqimit, Tiranë, Prill 2003

### Blegtoria dhe produktet e saj

Qarku i Fierit luan të rëndësishëm në shkallë vendi për prodhimin blegtoral, duke arritur 14.5% të totalit në vend. Lopët janë bagëtia kryesore që rritet, apsi ka kullota të pasura, ndërsa dhite dhe dhentë janë më të rralla pasi mungojnë kushtet e përshtatshme dhe kërkesat e tregut. Siç e tregon tabela, shumica e bagëtive

rriten brenda rrethit të Fierit, sepse ka sipërfaqen më të madhe të kullotave e livadheve.

Lidhur me prodhimet blegtorale, Qarku i Fierit mbetet prodhuesi kryesor i Shqipërisë, sepse jep afërsisht 16.9% të sasisë së qumështit, 13.3% të mishit dhe 8,8% të sasisë së vezeve në nivel kombëtar .Tabela tregon për rritjen e befasishme të sasisë së prodhimit.

► Tabela 27: Numri i bagëtivenë krerë më 2002 (në mijë)

Emri	Bagëtitë e trasha	Lopët	Leshi	Delet	Nga dhitë	Dhitë
Në % vendi	14.5	15.6	8.3	8.4	2.9	2.4
Fieri	52.4	32.5	68.2	51.2	5.0	3.9
Lushnja	41.9	30.1	55.1	44.5	6.5	3.1
Mallakstra	5.6	5.4	29.1	23.2	15.9	9.5
<b>Qarku</b>	<b>99.9</b>	<b>68</b>	<b>152.4</b>	<b>118.9</b>	<b>27.4</b>	<b>16.5</b>
<b>Shqipëria</b>	<b>690.4</b>	<b>434.8</b>	<b>1844.3</b>	<b>1413.9</b>	<b>929.0</b>	<b>697.7</b>

Marrë nga: Statistikat e rrethit, Raporti vjetor i Statistikave i Bujqësisë dhe Ushqimit, Tiranë, Prill 2003

► Tabela 28: Prodhimi i mishit, qumështit dhe vezëve në total dhe për frymë

Emërtimi	1997	1998	1999	2000	2001	2002
Mish, në ton	12557	13288	14773	14373	14588	15817
Qumësht, në ton	147733	152936	161072	164311	169981	170710
Veze, në mijë	48241	55689	50208	58052	57000	58000
Mish, kg/person	2.7	28.1	31	29,9	38.1	40.5
Qumësht, kg/ person	317	323	338	342	444.3	437.7
Veze, cope/ person	104	118	105	121	149	149

Marrë nga: Raporti vjetor i Statistikave i Bujqësisë dhe Ushqimit, Tiranë, Prill 2003

## Industria ushqimore

Industria e përpunimit të ushqimeve përfaqësohet kryesisht nga përpunimi i drithërave, frutave (rrushit), ullirit, lules së diellit etj. Në vitin 2003 u ngrit në Fier një fabrike moderne për prodhimin e vajit nga lulet e diellit, me ndihmën e qeverisë japoneze. Kjo fabrike pritet të ndikojë në rritjen e sipërfaqes së mbjellë me lule dielli.

## Investimet në sektorin bujqësor

Volumi i përgjithshëm i investimeve në sektorin bujqësor ka qenë në rritje që prej 1998. Më 1998, u investuan 24.690.000 Lek në qarkun e Fierit dhe gjatë vitit 2003 investimi u rrit në 55.100.000 Lek. Investime të tilla kanë luajtur rol të rëndësishëm në zhvillimin e bujqësisë në qark dhe kanë patur efekte pozitive në të ardhurat e familjeve fshatare.

Investimet e mbështetura nga projekti i Bankës Botërore kanë përmirësuar infrastrukturën e ujitjes dhe kullimit. Mbi 20.000 ha tokë janë rehabilituar dhe po vazhdohet me 6.500 ha të tjerë në Roskovec. Po zbatohen gjithashtu projekte të tilla si pastrimi i kanaleve kulluese dhe kolektorëve në gjithë fushën e Myzeqesë. Vijon të ketë mungesa për ujin në disa zona; kështu, kapacitetet ujore në rajonin e Lushnjes nuk mbulojnë më tepër se 48% të sipërfaqes së tokës në përdorim, në Fier kjo shifër shkon

deri në 30% dhe në Mallakastër vetëm 11%.

Investimet e siguruara nga buxheti i shtetit (përmes Ministrisë së Bujqësisë) nuk kanë qenë të qëndrueshme gjatë 6 viteve të fundit. Ato kanë shënuar një rritje të dukshme nga vitet 2000-2002, por kanë rënë me 28% në 2003.

## Industria

### Industritë e naftës dhe gazit

Qarku i Fierit është baza kryesore për industrinë e naftës dhe gazit në gjithë vendin. Ai ka 80% të rezervave të naftës, 75% të prodhimit të naftës dhe 90% të gazit. Rafineritë përpunojnë 100% të naftës bruto të nxjerrë në vend. Më tepër se 9.000 punonjës në sektorin e naftës përbëjnë një hapësirë të madhe punësimi dhe burim të ardhurash për qarkun.

Gjatë dhjetë vjetëve të kaluara të periudhës së tranzicionit ka patur një rënie në prodhimin e naftës dhe gazit. Viti 2000 shënoi nivelin më të ulët të prodhimit, ndërsa prodhimi më i ulët i gazit u regjistrua në vitet 2001 dhe 2002. Siç e tregon tabela, rënia e prodhimit të naftës bruto ka qenë mbi 50% në krahasim me dhjetë vjet më parë dhe shumë më e fortë sesa prodhimi i gazit natyror. Kjo rënie u shkaktua nga faktore të tillë si mungesa e mirëmbajtjes së pajisjeve, e teknologjive të

**Tabela 29: Fondet e investimeve për vitet 1998-2003 (në mijë Lek)**

Përshkrimi	Vitet					
	1998	1999	2000	2001	2002	2003
<b>Rrethi i Fierit</b>	8830	13 200	23 200	22 950	22 400	15 100
• Drejtoritë e Bujqësisë dhe Ushqimit	1330	3 600	7 500	7 950	7 900	1 500
• Drejtoria e Ujërave	7 500	9 600	15 700	15 000	14 500	13 600
<b>Rrethi i Lushnjes</b>	13 090	17 750	37 000	27 150	31 700	22 600
• Drejtoritë e Bujqësisë dhe Ushqimit	2 940	2 750	10 000	4 650	6 900	4 200
• Drejtoria e Ujërave	9 500	14 000	24 000	21 000	22 300	18 400
• Instit. i kërkimeve bujqësore	650	1 000	3 000	1 500	2 500	0
<b>Rrethi i Mallakastrës</b>	2 770	5 450	25 000	21 000	22 450	17 400
• Drejtoritë e Bujqësisë dhe Ushqimit	270	250	7 000	2 000	1 550	600
• Drejtoria e Ujërave	2 500	5 200	18 000	19 000	20 900	16 800
<b>Qarku Fier</b>	24 690	36 400	85 200	71 100	76 550	55 100

Marrë nga: Statistikat e rretheve të qarkut

► **Tabela 30: Prodhimi i naftës bruto dhe gazit gjatë viteve (1991-2002)**

Vitet	91	92	93	94	95	96	97	98	99	00	01	02
Naftë bruto (mijë ton)	845	585	586	535	521	488	360	365	323	314	329	350
Gaz Natyral (mln m <sup>3</sup> )	141	102	82	52	28	23	18	17	14	11	10	10

Burimi: Ministria e ekonomisë

reja në kërkimin e burimeve të reja dhe në nxjerrjen e naftës, si dhe mungesa e madhe e investimeve nga kompanitë private (sidomos pas ristrukturimit të sektorit me shpërbërjen e monopolit shtetëror “Albpetrol” dhe krijimit më pas të tri shoqërive “Albpetrol”, “ARMO” dhe “Servcom” të kontrolluara nga “APC”).

Kapaciteti i projektuar i industrisë së përpunimit të naftës është 2.5 milion ton në vit. Brenda këtij kapaciteti janë katër rafineri nga të cilat funksionojnë vetëm dy, në Ballsh dhe në Fier. Këto rafineri kanë kapacitet prodhimi prej 1.5 milion ton në vit. Megjithatë, në ditët e sotme ato përdorin vetëm 1/5 e kapacitetit total, për shkak të furnizimit të pamjaftueshëm me naftë bruto. Rigjallërimi i sektorit të naftës mund të kishte ndikim pozitiv për zhvillimin e rajonit të Fierit duke punësuar njerëzit, duke shtuar eksportin e të ardhurat nga prodhimi, si dhe për zhvillimin e industrise kimike që lidhet me përpunimin e naftës. Porse duke ndjekur këtë rrugë, përfitimet e përmendura më sipër duhet të përputhen me kërkesat për mbrojtjen e mjedisit e të shëndetit.

Politika për zhvillimin e industrisë së naftës në të ardhmen synon të tërheqë investimë të huaja për të përmirësuar nivelin teknik dhe teknologjik të nxjerrjes, si dhe e prodhimit të puseve në veprim. Janë aritur dy marreveshje për hidrokarburet, të cilat mbulojnë zonat e Patos-Marinëzës dhe Cakran-Ballshit. Është aprovuar një plan afatgjatë (17-vjeçar) nga Ministria e Mjedisit për rehabilitimin dhe zhvillimin e zonës Patos-Marinëz. Plani pritet të marrë edhe një investim pesëvjeçar prej 270 milion USD, me përfshirjen e kompanive të huaja të mirënjohura nga Anglia, Austria dhe Kroacia. Faza e parë u krye në vitet 2001-2002, me shpimin e 80 puseve të rinj.

Në mënyrë që të rritet efektiviteti i industrise se naftës, duhet te shihet procesi i rehabilitimit, i cili merr parasysh problemet sociale të cilat vijnë nga reduktimi i forcave te punës dhe papunësia ne zone.

### *Energjia elektrike dhe industritë kimike*


Termocentrali më i madh në vend u ndërtua në qarkun e Fierit gjatë viteve '70. Ai furnizonte me energji elektrike industritë kimike të ngritura në qytetin e Fierit gjatë viteve '60. Por qysh nga mesi i viteve 1990 prodhimi i energjisë elektrike nga ky termocentral ka qenë në ulje çdo vit për shkak të privatizimit; për shembull, më 2001 u prodhuan 13,6 KëH dhe më 2002 pati rënie në 10,7 milion KëH. Përpjekjet për të tërhequr investitorë të huaj për rinovime kanë qenë të pasukseshme. Në strategjinë për zhvillimin e burimeve të energjisë miratuar kohët e fundit nga qeveria, ky termocentral pritet të rimëkëmbet në 2007.

Deri në fillim të viteve '90, rrethi i Fierit ishte qendër e madhe e prodhimit të plehrave kimike për bujqësinë, veçanërisht nitrat amonit. Mungesa e mirëmbajtjes dhe e investimeve për teknologjinë e viteve '60 bëri që çmimi i prodhimit të dilte më lartë sesa ai që ka tregu ndërkombëtar, prandaj uzina u mbyll. Kimikatet dhe mbeturinat e saj përbëjnë rrezik për mjedisin dhe qytetarët e rrethit.

### *Industria mekanike dhe e materialeve të ndërtimit*

Uzinat mekanike në Fier dhe Lushnje kanë mbështetur kryesisht industritë e naftës dhe të gazit në rajon. Deri në fillim të viteve '90 industria mekanike punoi gjithashtu për të furnizuar me mjete mekanike bujqësore. Pjesa më e madhe e kësaj industrie në ditët e sotme është privatizuar ose ka ndryshuar fushën e specializimit. Për shkak të shtimit të madh të ndërtimeve të reja në Shqipëri, industria e materialeve të ndërtimit është zgjeruar shumë në qark (veçanërisht në prodhimin e gëlqeres dhe tullave). Për shembull, në Lushnje është ngritur një fabrikë relativisht e re e specializuara në prodhimin e tullave, e pajisur me teknologji moderne. Prodhimi shpërndahet në gjithë Shqipërinë.

### ► Ndermarrjet aktive sipas aktivitetit ekonomik



► Tabela 31: Ndërmarrjet aktive dhe numri i punonjësve 2001

Numri i punonjësve	Numri i ndërmarrjeve	Në %	Numri i punonjësve	Në %
Me 1 punonjës	2671	81	2671	12
Me 2-10 punonjës	507	15	1663	7
Mbi 10 punonjës	108	3	18671	81

Burimi: Ministria e ekonomisë

#### Biznesi i vogël dhe i mesëm (BVM)

Fillimi i reformave në Shqipëri ka çuar në zhvillimin e një sektori privat në rritje. Me gjithë vështirësitë në rritjen ekonomike, zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme ka qenë në rritje të qëndrueshme. Për shkak të vendndodhjes gjeografike të përshtatshme të Fierit, kryqëzohen disa nga rrugët jugore e jugperëndimore. E po ashtu burimet e pasura natyrore dhe përgatitja e popullsisë e bënë rajonin qendër të rëndësishme për BVM-të.

Në Fier veprojnë 3,286 ndërmarrje, prej të cilave 48% janë tregtare me pakicë.

Me gjithë faktin që Qarku i Fierit është një zonë me prodhim kryesisht bujqësor, ku 60% e popullsisë banon në fshat, vetëm 1,1% e ndërmarrjeve operojnë në sektorin bujqësor. Ndërmarrjet që veprojnë në sektorin industrial përbëjnë 10% të totalit dhe janë specializuar për naftë, pije alkoolike, miell, letër, plastikë dhe mobilje.

► Tabela 32: Ndërmarrjet aktive dhe punësimi në lidhje me sektorin ekonomik

Degët	Numri i ndërmarrjeve	Në %	Numri i punonjësve	Në %
Bujqësi	37	1	575	2
Industri	341	10	12978	56
Ndërtim	116	4	2085	9
Transport	562	17	2771	12
Tregti	1585	48	2286	10
Shërbime	645	20	2310	10
Total	3286	100	23005	100

Burimi: Ministria e ekonomisë, 2002



Shërbimet përbëjnë 20% të ndërmarrjeve, dhe kryesisht janë me drejtim ligjor. Analiza e strukturës së sektorit të BVM-ve ngjall shqetësime, sepse zbulon brishtësinë e tij. Nga 1993 në 2000 numri i ndërmarrjeve me 10 ose më tepër punonjës është ulur (Departamenti i punës në Fier). Siç e tregon tabela, ndërmarrjet me më tepër se 10 punonjës, përbëjnë vetëm 3% të numrit të përgjithshëm. Me gjithë numrin e vogël të tyre, ato punësojnë 81% të numrit total të punonjësve. Ndërmarrjet me më pak se 10 punonjës përbëjnë 97% të ndërmarrjeve dhe punësojnë vetëm 19% të punonjësve.

Ndërmarrjet që operojnë në sektorin industrial kanë 56% të numrit total të punonjësve. Kjo vjen si pasojë e punësimit të lartë në sektorin e naftës dhe gazit. Degë të tjera të ndërmarrjeve siç tregohet në Tabelën 33, të tilla si transporti, tregtia dhe shërbimet përbëjnë respektivisht 12%, 10% dhe 10%. Ndërmarrjet bujqësore kanë numrin më të ulët të punonjësve me 2%.

Sipas statistikave në shkallë rajonale, del që shkalla e raportit të investimeve në sektorin privat dhe publik është 70:30. Kjo tregon rolin e pazëvendësueshëm të sipërmarrësve privatë në ekonominë lokale. Për këtë arsye, krijimi i kushteve më të përshtatshme për zhvillimin e sektorit privat duhet të konsiderohet si një nga shtyllat kryesore të rritjes ekonomike afatshkurtër në këtë Qark.

## Turizmi

Në qarkun e Fierit ka kushte premtuese natyrore për zhvillimin e turizmit, i cili nga ana e tij ndihmon për krijimin e mjaft vendeve të punësimit. Disa nga pasuritë që mund të propagandohen brenda vendit dhe jashtë janë: plazhe me rërë të pastër përgjatë bregdetit të qarkut (si në Divjakë, Bedat, Seman, Hidrovor, Pish-Poro, etj). Zonat kënetore janë të pasura me flore dhe faune, kanë peizazhe interesante natyrore, që do

të tërhiqnin turistë. Grykëderdhjet e lumenjve Vjosa, Shkumbin dhe Seman ofrojnë potenciale për zhvillimin e aktiviteteve sportive dhe gjahut. Pylli mesdhetar halor i Divjakës, duke patur sipërfaqe prej rreth 1.200 ha, është unikal për qëllime turistike me diversitet bimësh, pemësh dhe kafshësh e zogjsh të egër. Vendet me trashëgimi historike përfshijnë gjurmë të qyteterimit të lashtë në Apolloni dhe Bylis, një varg manastiresh të mesjetës, veçanërisht ai i Ardenicës, shtëpia muze ku u mbajt Kongresi i Lushnjes që hodhi themelet e shtetit modern shqiptar, muzetë historikë në qytetet kryesore si dhe ai arkeologjik në Apolloni, etj. Traditat, zakonet, mënyra e jetesës në fshatrat e qaarkut e sidomos festat, ceremonitë, kostumet, këngët, vallet, krijojnë një ofertë të pasur për turizmin kulturor.

Infrastruktura e turizmit në qarkun e Fierit është aktualisht e kufizuar kur krahasohet me atë që ofron rajoni dhe me kërkesat e sotme. Qarku i Fierit ka 7 njësi hotelesh, të cilat kanë 198 dhoma dhe 367 shtretër. Tabela më poshtë tregon llojet e akomodimit dhe vendndodhjen e tyre.

Shumica e turistëve janë banorë të rajonit të Fierit dhe Beratit. Pjhesa më e madhe përbëhet nga emigrante të cilët duan të kalojnë pushimet me familjet. Turistet nga rajonet e tjera janë kryesisht tranzit, shqiptarë nga Kosova, Maqedonia, Mali i Zi ose diaspora. Sot ka fare pak turistë, shumica e tyre kërkues (të cilët vizitojnë Apolloninë, Bylisin dhe lagunën e Karavastasë) dhe biznesmenë. Shumica e turistëve vizitojnë plazhet për një ditë. Numri i turistëve të cilët qëndrojnë një natë ose më tepër në njësite të akomodimit të qarkut Fier gjatë 2000 ishte 52.939 persona; prej tyre në zonën turistike të Semanit (Fieri) 5,008 dhe në zonën turistike të Divjakës (Lushnja) 47.931. Sipas të dhënave të mbledhura nga Komiteti për Zhvillimin e turizmit, Tiranë 2001, shpenzimet mesatare nga një turist i huaj jo me kombësi shqiptare ishte 849 USD (duke mos përfshirë shpenzimet e udhëtimit). Turistët nga Kosova ose Maqedonia

**Tabela33: Hotelet në qarkun e Fierit**

Rrethi	Lloji i njësive të akomodimit			Numri i dhomave	Numri i shtretërve
	Hotele	Motele	Pensione		
Fier	2	1	-	103	194
Lushnje	2	1	1	95	173
Mallakstra	-	-	-	-	-
Qarku	4	2	1	198	367

Burimi: Ministria e Turizmit dhe Rregullimit të territorit

kanë shpenzuar deri në 274 USD, ndërsa ata nga brenda vendit kanë shpenzuar 177 USD. Interesimi i biznesit lokal privat në sektorin e turizmit po rritet, por shumica e investimeve orientohen në ndërtimin e restoranteve të cilat sjellin të ardhura gjatë gjithë vitit.

## Tregu i Punës

Në qarkun e Fierit, 66% e të punësuarve punojnë në bujqësi. Kjo është afër 15% mbi mesataren e vendit dhe nxjerr në pah përqendrimin e qarkut në bujqësi. Brenda Qarkut, rajoni i Lushnjes ka përqindjen më të lartë të atyre të punësuar në bujqësi me 75,3%. Siç tregohet në Tabelë, një përqindje e konsiderueshme e popullsisë është e punësuar gjithashtu në tregti dhe

në sektorin e transportit, që gjithashtu pasqyron prirjet e përfuara nga përparësitë gjeografike të qarkut. Është për të ardhur keq që sektori i shëndetësisë dhe arsimit ka përqindjen më ulët të punësimit.

Gjatë periudhës së tranzicionit, tregu i punës në qarkun e Fierit pësoi një varg ndryshimesh. Si rezultat i mbylljes, rinovimit dhe privatizimit të shumë ndërmarrjeve, nga fundi i vitit 1993 niveli i punësimit ra 18% krahasuar me shifrat e vitit 1989. Gati 93% e femrave dhe 23% e burrave humbën vendet e tyre të punës gjatë 1990-1993. Më 1994 pati një rritje në numrin e të punësuarve, megjithatë kriza politike, ekonomike dhe sociale e 1997, i uli përsëri këto shifra. Siç tregohet në tabelat e mëposhtme, tendenca është negative me shtim të papunësisë.

► **Table 34: Dispersion of the employed in relation to the sectors for the year 2001**

Sectors	Albania		Fier Region	
	Total	In %	Total	In %
Total	1016027	100	141064	100
Agriculture	506434	49.8	91365	65
Industry	73079	7	10293	7
Construction	67901	7	6304	4.5
Trade	119462	12	11881	8.5
Tourism	39265	4	3464	2.5
Transport	63201	6	5404	4
Education	50508	5	5094	3.5
Health	26121	3	2026	1.5
Others	70056	7	5233	3.5

Ministry of Economy, 2001

► **Tabela 35: Numri i kraheve të punës për vitin 2001**

Emri	Krahë pune ne total	Të punësuar			% Papunësia			
		Meshkuj	Femra	Total	Meshkuj	Femra	Total	
Qarku Fier	172.000	141064	15571	15348	30919	18	15	22
Shqipëria	1320766	1016024	149940	154313	304253	22.7	18.8	28.4

Burimi: Departamenti i punës i Fierit

► **Tabela 36: Punësimi dhe papunësia (në mijë)**

	1997	1998	1999	2000	2001
Të punësuar	193	193	193	193	193
Të papunësuar	142	142	142	142	142
Papunësia në %	28	28	28	28	28
Totali	363	363	363	363	363

Burimi: Departamenti i punës i Fierit

Ndër të punësuarit, 48% kanë arsimin 8-vjeçar, nga të cilët 49% kanë diplomën e shkollës së mesme. Një pjesë e konsiderueshme e të papunëve veçanërisht ata që kanë mbaruar vetëm shkollën 8-vjeçare, nuk janë në gjendje të punojnë në punë të cilat kërkojnë një farë kualifikimi. Ata kanë nevojë për trajnime dhe programe kualifikimi në mënyrë që të përmbushin kërkesat e reja të tregut të punës. Por sistemi i ngritjes dhe krijimit të kualifikimeve profesionale në qarkun e Fierit nuk i përmbush kërkesa të tilla në sasi dhe cilësi. Krijimi i disa qendrave private, më të shumtat për mësimin e gjuhëve të huaja, kompjuterit etj., nuk është i mjaftueshëm për kërkesat e reja të tregut të punës në qark.

Nga ana tjetër, ekzistenca e dimensioneve të mëdha të ekonomisë informale, e ul numrin e vërtetë të atyre që janë të punësuar. Por ky sektor krijon një kontingjent punonjësish të cilët s'e kanë të siguruar punën.

### **Të ardhurat nga emigracioni dhe asistenca ekonomike e qeverisë**

Ashtu si në të gjithë vendin, popullsia e Fierit mund të ndahet në tre grupe. Grupi i parë përfshin ato familje, të cilat kanë përfituar nga tranzicioni ose kanë përfituar nga emigracioni, duke siguruar kështu të ardhura të mesme ose të larta. Grupi i dytë përfshin ato familje të cilat i sigurojnë të ardhurat nga puna në sektorin zyrtar ose sektorin privat. Ky grup mund të konsiderohet si grup me familje me të ardhura të pakta ose të mesme. Grupi i tretë përfshin ato familje të cilat jetojnë me pensione, ndihmë ekonomike, ose forma të tjera asistencë sociale. Ky është një grup imë disavantazh nga tranzicioni dhe përbën grupin më të varfer të shoqërisë shqiptare. Ky grup përfshin qytetarë të vetëpunësuar të cilët kanë të ardhura të pakta, popullsi rurale e cila nuk prodhon mallra për t'i shitur në treg, dhe njerëz që kanë dalë në pension dhe të papunësuar të cilët varen nga asistenca ekonomike. Programi i qeverisë për ndihmën sociale dhe dërgimi i parave nga emigrantët janë dy politikat kryesore formale dhe joformale që synojnë të lehtësojnë nevojat e atyre që jetojnë nën kufirin e varfërisë.

### **Të ardhurat nga dërgesat e emigrantëve**

Emigrimi është një "mekanizëm për të përballur varfërinë" i cili jep mundësi për shumë familje për ta kaluar kufirin e varfërisë. Shumë të rinj kanë emigruar drejt Greqisë ose Italisë për shkak të papunësisë dhe varfërisë së shkakuar nga periudha e tranzicionit. Në qarkun e Fierit, anketimet e bëra nga Qendra për Studimet Sociale<sup>10</sup> më 2003 tregojnë që shumë familje kanë të paktën një anë-

tar të familjes jashtë shtetit. Disa nga këta anëtarë familjesh që punojnë jashtë janë martuar në vendet ku punojnë. Të tjerë emigrojnë ilegalisht ose me rrugë ligjore çdo vit kur kërkojnë punë sezonale në bujqësi ose në sektorin e shërbimeve. Në përgjithësi ata arrijnë të gjejnë punë të thjeshta, jo të kualifikuara si punë në bujqësi, ndërtim, bare/restorante, riparime, mirëmbajtje etj.

Një aspekt pozitiv i emigracionit janë të ardhurat që sjell. Në shumë fshatra të qarkut të Fierit, një familje e varfër dallohet nga një familje jo e varfër thjesht nëse kanë apo një anëtar të familjes jashtë shtetit. Sipas një anketimi të bërë në fillim të 2003 për 155 emigrantë të ligjshëm të qarkut të Fierit që banojnë jashtë shtetit prej një kohe të gjatë, 93.5% e tyre dërgojnë para çdo vit në vendin e tyre. Pjesa më e madhe dërgojnë para nëpërmjet rrugëve jozyrtare, dhe vetëm 8% e tyre dërgojnë para nëpërmjet bankave apo agjencive të transfertave. Afërsisht 57% e tyre u dërgojnë para prindërve dhe afërsisht 45% dërgojnë para të gratë dhe fëmijët e tyre.

Çdo emigrant dërgon afërsisht 2.300 EURO në vit. Pjesa më e madhe e dërgesave përdoret për konsum afatshkurtër dhe shumë pak prej tyre përdoren për investime prodhuese që do të hapnin vende punë të reja. Sipas këtij anketimi, 70% e emigrantëve u dërgojnë para familjeve për të mbuluar shpenzimet ditore, dhe afërsisht 37% deklaroi se dërgon para për të ndërtuar ose ndrequr shtëpitë, ndërsa të tjerët dërgesat i depozitojnë në bankë.

Anketimi nxori gjithashtu në pah sasia e dërgesave po bie çdo vit, kryesisht për shkak të bashkimeve familjare dhe nga dëshira për të përmirësuar kushtet e jetesës në vendin ku kanë emigruar. Sipas anketimit, në qarkun e Fierit vetëm 18.8% e të intervistuarve deklaruan se do të dërgonin më tepër para në vendin e tyre në të ardhmen. Një tjetër prirje interesante lidhur me dërgesat është se shumica e atyre që janë jkashtë shtetit duan të kthehen e t'i investojnë kursimet në atdhe; 80% deklaruan se do të donin të ktheheshin pas 5 ose 6 vjetësh. Ndërsa kur iu bë një pyetje tjetër, 50% deklaruan se do të donin t'i investonin kursimet e tyre në atdhe, kryesisht në sektorin e shërbimeve, bujqësi, ndërtim, etj.

### **Programi qeveritar për përkrahjen sociale dhe asistencën ekonomike**

Në qarkun e Fierit, nga skema e asistencës ekonomike përfitojnë 6% e familjeve, krahasuar me 7% në nivel

<sup>10</sup> Ministria e Mjedisit 2001: Plani Kombëtar i Veprimit në Mjedis

kombëtar. Ndërkohë, vetëm 2% e familjeve në qark përfitojnë nga asistenca e pjeshme ekonomike. Kjo shifer respektive në nivel kombëtar është 12%. Kjo tregon pjesërisht se është numri i njerëzve të cilët jetojnë nën kufirin e varfërisë është më i ulët në Fier krahasuar me mesataren e vendit, por varfëria njëkohësisht përbën një çështje serioze për shumë veta brenda qarkut.

Numri i familjeve në zonat urbane në qarkun e Fierit, të cilat përfitojnë nga skema e asistencës ekonomike është 4,591. Të ardhurat mesatare mujore të këtyre familjeve janë 2,750 lek, ose 91,7 lek në ditë.

Siç tregohet në Tabelën 39, përqindja më e lartë e familjeve që përfitojnë nga skema e asistencës ekonomike gjendet në qytetet e Patosit dhe Rosko-

vecit. Për këtë arsye, duhet të bëhen përpjekje te veçanta në këto dy qytete për të lehtësuar gjendjen e tanishme përmes politikave sociale dhe ekonomike, të cilat do rezultojnë në një numër më të vogël familjesh të cilat banojnë nën kufirin e varfërisë.

Ndërsa 1,749 Familje që jetojnë në qarkun e Fierit marrin asistencë ekonomike, mesatarja e të ardhurave nga kjo skemë është vetëm 1.860 Lek. Në zonat rurale me 124.000 banorë janë 10.000 banorë ose 8 % që varen nga asistenca ekonomike.

Duke e krahasuar me qarqet e tjera të Shqipërisë, përqindja e familjeve rurale të cilat marrin asistencë ekonomike është më e ulët për qarkun e Fierit. Megjithatë, objektivi për Qarkun e Fierit është të përgjysmojë numrin e familjeve të cilat jetojnë nën kufirin e varfërisë nga fundi i 2015.

**Tabela 37: Numri i familjeve me trajtim sipas skemës së asistencës ekonomike për 2001**

Emri	Numri total i familjeve	Asistencë e Pjeshme		Asistencë e plotë	
		Numri i familjeve	Në % mbi totalin	Numri i familjeve	Në % mbi totalin
Qarku Fier	88,232	1,627	2	5,286	6
Shqipëri	726,895	87,172	12	56,261	7.7

Burimi: Departamenti i Përkrahjes sociale në Fier

**Tabela 38: Asistenca ekonomike në bashkitë e Qarkut (zonat urbane) për 2001**

Bashkia	Numri Total i familjeve	Marrës të Asistences ekonomike	Në %	Asistenca ekonomike, 1000 lek ne muaj	Mesatarja mujore për familje (lek)	Lek në ditë për një familje
	50 562	1454	2.8	3902	2 680	89.4
Fier	10 700	157	1.5	356	2 270	75.7
Ballsh	38 902	1563	4	4647	2 970	99
Lushnje	9 617	1265	13	3385	2 680	89.4
Patos	2 237	142	6.3	303	2 130	71
Roskovec	3 330	10	0.3	35	3 500	116.6
Divjakë	<b>115 348</b>	<b>4591</b>	<b>4</b>	<b>12 628</b>	<b>2 750</b>	<b>91.7</b>

Burimi: Departamenti i përkrahjes sociale në Fier

**Tabela 39: Asistenca ekonomike në Komuna në qarkun e Fierit (zonat rurale) për 2001**

Komunat	Marrës të Asistences ekonomike	Asistenca ekonomike, 1000 lek në muaj	Mesatarja mujore për familje (lek)	Lek ne ditë për një familje
Fier	550	1037	1890	63
Lushnje	313	573	1830	61
Mallakastër	886	1642	1850	62
<b>Total</b>	<b>1749</b>	<b>3252</b>	<b>1860</b>	<b>62</b>

Burimi: Departamenti i përkrahjes sociale në Fier

## Informacion mbi kushtet natyrore dhe mjedisin

Kushtetuta e Shqipërisë thekson ruajtjen e një “mjedisi të shëndetshëm dhe ekologjik për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm” (Neni 59). Burimet natyrore duhet të “shfrytëzohen në mënyrë racionale” bazuar në “parimin e zhvillimit të qëndrueshëm”. Kjo direktivë e Kushtetutës krijon bazën për trajtimin e çështjeve mjedisore në të gjitha strategjitë lokale dhe kombëtare të zhvillimit. Përparësitë kombëtare lidhur me mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin janë identifikuar në disa dokumente të politikës kombëtare, si Strategjia Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik dhe Social (SKZHES) e 2003 dhe Plani Kombëtar i Veprimeve për Mjedisin 2001, veç të tjerëve.

Qarku i Fierit ka një larmi ekosistemesh e habitatesh, që mund ta ndihmojnë zhvillimin rajonal (si vijën bregdetare dhe plazhet bregdetare, zonat e mbrojtura, nivel të lartë biodiversiteti, toka të punueshme me pjellori të lartë, etj.) Sidoqoftë, ka disa çështje mjedisore të cilat kanë efekt negativ mbi procesin e zhvillimit, të cilat përfshijnë ndotjen industriale, menaxhimin jo të mirë të ujërave të zeza dhe higjienës, mbetjet e ngurta urbane, dhe shpyllëzimi. Në këtë zonë ndodhet edhe një shqetësim mbarëkombëtar, i njohur si një nga pikat e nxehta mjedisore: fusha naftë-mbajtëse e Patos – Marinzës<sup>1</sup>

### Gjendja e Mjedisit

Ashtu si në pjesën tjetër të vendit, në qarkun e Fierit zhvillimi i paplanifikuar urban dhe menaxhimi joefektiv i mjedisit janë disa nga faktorët kyç të cilët kanë keqësuar gjendjen e mjedisit. Degradimi mjedisor ka qenë rezultat i efekteve të grumbulluara, shkaktuar kryesisht nga mungesa e një planifikimi të integruar në menaxhimin e mjedisit.

### Ajri


Pranohet shpesh që burimet kryesore të ndotjes së ajrit në qarkun e Fierit janë nxjerrja dhe përpunimi i naftës, prodhimi i energjisë, ngrohja që përdorin familjet, djegia e pakontrolluar e plehrave dhe transporti. Me gjithë mungesën e të dhënave të sakta, mund të thuhet që cilësia e ajrit në Fier po përkeqësohet për shkak të ndotjes nga SO<sub>2</sub>, NO<sub>x</sub>, ozonit, CO, dhe metaleve të rënda.

<sup>13</sup> UNEP, 2000: Vlerësimi paskonfliktual i mjedisit për Shqipërinë

Një nga sfidat më të mëdha për përmirësimin e ajrit në qarkun e Fierit është ndërtimi i kapaciteteve të nevojshme teknike dhe institucionale për monitorimin e ajrit. Në qarkun e Fierit nuk ka sisteme sistematike të monitorimit të cilësisë së ajrit. Nuk ka informacion të disponueshëm të plotë për lëshimet në ajër, përqendrimet e ajrit, burimet e ndotjes, ekspozimin dhe efektet në shendet dhe ndërlidhjet e tyre. Përmirësimi i disponueshmërisë së informacionit dhe analizat e tij do të siguronin bazën për gjithë planifikimin e mëtejshëm mjedisor lidhur me këtë sektor.

Programi i monitorimit të ajrit planifikuar nga Qeveria nuk është plotësisht operativ për shkak të mungesës së burimeve dhe nuk përfshin gjithë treguesit e nevojshëm për të matur cilësinë e ajrit. Megjithatë, me një dekret të Këshillit të Ministrave Nr.541 datë 25 shtator 1995 “Mbi përgjegjësitë e Ministrive, institucioneve kërkimore si dhe të personave juridikë dhe fizikë për monitorimin e mjedisit” disa institucione qendrore të specializuara janë të detyruara të monitorojnë cilësinë e ujit, ajrit, tokës, dhe të sigurojnë të dhëna përkatëse për Ministrinë e Mjedisit.

Në qarkun e Fierit, janë bërë disa përpjekje lidhur me këtë. Laboratori fiziko-kimik i Drejtorisë së Kujdesit Parësor në qytetin e Fierit monitoron ndotësit kryesorë (SO<sub>2</sub>, pluhurin total, ozonin, dhe NO<sub>x</sub>). Kompania Albpetrol Sh.a dhe Departamenti i Mjedisit dhe Shëndetësisë monitorojnë veprimet në industrinë e naftës në fushë<sup>2</sup>.



Ndotja e ajrit përbën shqetësim veçanërisht në qytetet e Fierit, Patosit dhe Ballshit, kryesisht për shkak të termocentralit dhe industrive të naftës që ndodhen në këto bashki.

Fieri është qyteti i dytë pas Tiranës me përqendrim të lartë të PM 10. Në fakt, që prej 1976 niveli i PM10 ka qenë në rritje për shkak të shtimit të automjeteve.

<sup>14</sup> F.Gishti, L.Bregasi, V.Rizaj, P. Isufi, Albpetrol Sh.A., Shkurt 2003: “Gjendja dhe Përshtatja e Mjedisit të fushave naftëmbajtëse në Kompaninë e Albpetrolit”

Instituti i Shëndetit Publik monitoron treguesit mjedisorë lidhur me sasinë totale të materialeve në ajër në qytetet kryesore të vendit. Përmbajtja totale e substancave në ajër, në të gjitha qytetet e monitoruara i kalon në mënyrë të konsiderueshme shifrat e rekomanduara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, si për mesataren ditore ( $120\mu\text{g}/\text{m}^3$ ) ashtu dhe për mesataren vjetore ( $100\mu\text{g}/\text{m}^3$ ). Veçanërisht, shifrat janë jashtëzakonisht të larta në qytetet e Fierit dhe Tiranës. Mesatarja vjetore është tre herë më lartë se normat e lejuara Shkaktari kryesor mbetet transporti. Gjatë një viti numri i ditëve në të cilat kalohen normat varion nga 80 në 90.

Komponente të tjera kryesore të ndotjes përfshijnë oksidet e azotit (NO), dyoksidin e squfurit ( $\text{SO}_2$ ) dhe hidrokarburet aromatike.

Lidhur me oksidin  $\text{NO}_4$ <sup>15</sup> masat e kufizuara (në kohë dhe në shpërndarjen geografike) e kanë bërë gati të pamundur vlerësimin e ndotjes  $\text{NO}_4$  gjatë viteve të shkuara. Megjithatë, matjet e bëra kohët e fundit nga Instituti i Shëndetit Publik për ndotjen  $\text{NO}_4$  në disa nga qytetet kryesore të vendit duke përfshirë Fierin, tregojnë se është brenda standardeve ( $150\text{mg}/\text{m}^3$  – mesatare në 24 orë).

Kampionet e gazit Sulfurik ( $\text{SO}_2$ )<sup>16</sup> të marra nga Instituti i Shëndetit Publik tregojnë po atë prirje si dhe për  $\text{NO}_4$  për Fierin: nuk ka raste kur kalohet standardi i  $\text{SO}_2$  vendosur nga qeveria ( $150\text{mg}/\text{m}^3$  mesatarja 24 orëshe). Sektori i transportit, një nga burimet kryesore të  $\text{SO}_2$  ka patur efekt në rritje për keq mbi cilësinë e ajrit në qarkun e Fierit kryesisht për shkak të rritjes së shpejtë të numrit të automjeteve të vjetra me naftë.

Përqendrimi i hidrokarbureve alifatike dhe aromatike përbë një nga shqetësimet më për qarkun. Volumi më i madh i hidrokarbureve të lëshuara në ajër vjen prej fushave naftëmbajtëse të Marinzes dhe Ballshit.

Ruajtja e naftës në kontenierë të hapur në fushën naftëmbajtëse të Marinzes në bashkinë e Patosit ndot atmosferën me hidrokarbure të lehta nga avullimi. Çdo ditë pompat lëshojnë gati  $8.000\text{ m}^3$  gazi që përmban

<sup>15</sup> Burimi kryesor i  $\text{NO}_x$  janë dekompozimi nga bakteriet i organizmave organike dhe djegja e pyjeve. Burimi i kryesor i çlirimit të  $\text{NO}_x$ , si rezultat i aktiviteteve njerëzore janë sektori i transportit, prodhimi i energjisë elektrike dhe të tjera.

<sup>16</sup> Shkaku kryesor i çlirimit të  $\text{SO}_2$  në atmosferë është djegja e karburanteve që përmbajnë squfur.

squfur. Nga kjo sasi vetëm 1/5 përdoret për të gjeneruar energji për puset, tjetra shkon në atmosferë mbi 115 ton squfur në vit. Ajri rreth tyre përmban përqindje të lartë  $\text{H}_2\text{S}$ , i cili shkakton dëme në rrugët e frymëmarrjes.

## • Uji

Qarku i Fierit ka burimë të mjaftueshme ujore që përfshijnë lumenj, ujëra nëntokësore dhe rezervuare artificiale. Semani është një nga lumenjtë më të mëdhenj të Shqipërisë i cili kalon nëpër këtë Qark. Për më tepër, lumi Vjosa ose rrjedhat që e ushqejnë lidhin Qarkun e Fierit me rajone të tjera të Shqipërisë Jugore. Ashtu si te lumenjtë e tjere të Shqipërisë, niveli i ujërave të tyre ndryshon shumë sipas stinës. Rrjedhat e lumenjve janë më të mëdha gjatë dimrit ose në fillim të pranverës gjatë stinës së lagësht. Për shkak të erozionit në brigjet e thikta në pjesën e sipërme, lumenjtë bartin sasi të mëdha materialesh të ngurta: një vlerësim jep  $1,650\text{ kg}/\text{sek}$  mesatarisht.<sup>17</sup>

Brenda qarkut të Fierit ka disa laguna dhe toka nën ujë, kryesisht gjatë vijës bregdetare. Zona me laguna si Karavasta, Pishë Poro kanë rëndësi kyçe për mbrojtjen e florës dhe faunës. Ujërat nëntokësore janë gjithashtu të bollshme në rajon dhe shfrytëzohen kryesisht nëpërmjet puseve në zonat fushore. Uji është i një cilësie të mirë, sidoqoftë disa vise të veçanta kanë patur probleme për shkak të ndotjes së ujit nga nafta (fusha naftëmbajtëse e Patos-Marinzes), dhe nga hyrja e ujit të kripur në shtresat ujëmbajtëse (Lushnje, Fier)<sup>18</sup>.

Gjatë dekadës së kaluar qarku i Fierit ka pasur gati 13 % të popullsisë që u shpërngul nga zonat rurale në zonat urbane dhe kjo lëvizje e popullsisë ka krijuar probleme të mëdha për infrastrukturën e ujit. Ujërat industriale dhe ujërat e zeza derdhen direkt në sistemet ku mblidhet uji. Sasia e derdhur nuk matet dhe cilësia e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore nuk monitorohet rregullisht. Ndotësit industrialë janë zakonisht prodhuesit e çimentos, lëkurës, qeramikës, tekstileve, nxjerrja e mineraleve, fonderitë, nafta, gazi dhe përpunuesit e drurit. Aktivitetet kryesore të cilat sjellin më shumë ndotje të ujit janë nzjerrja e naftës (me 10%) dhe ujërat e zeza (me 90%).

Ligji për burimet ujore (Nr.8093/1996) është legjislativ i kryesor i menaxhimit të burimeve ujore. Sipas

<sup>17</sup> Ministria e Mjedisit: Gjendja e Mjedisit 1999-2000

<sup>18</sup> UN, Komisioni Ekonomik për Europën 2002: rishikimet e kujdesit mjedisor: Shqipëria

tij ngrihen Këshilli Kombëtar i Ujit dhe sekretariatit e tij teknik (ashtu si dhe institucionë të tjera për ujin). Ligji siguron mbrojtjen, zhvillimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve ujore. Ligji gjithashtu ka sjellë konceptin e lejeve, koncesioneve dhe autorizimeve për përdorimin e ujit e derdhjen e ujërave të përdorura. Megjithëse ligji merret me kontrollimin dhe ruajtjen e cilësisë së burimeve të ujit, ai nuk përcakton kushte shumë strikte për shkarkimin e ndotjeve.

Më 1997 Shqipëria iu afrua krijimit të një strategjie kombëtare, projekti i së cilës u përgatit nën patronazhin e programit PHARE të BE. Megjithëse u përgatit nën mbikqyrjen e gjithë Këshillit Kombëtar të Ujit, strategjia gjeti kundërshtim nga disa ministri qeveritare dhe autoritetet lokale. Kështu kjo strategji nuk u miratua asnjëherë. Strategjia Kombëtare e Furinimit me Ujë dhe e Higjenes është tashme një projekt final dhe përfshin veprimtari të ndryshme për të përmirësuar gjendjen për sa i përket cilësisë dhe sasisë së ujit, si dhe mbulimit të higjenes.

#### • Toka

Përdorimi i papërshtatshëm i tokës gjatë dekadave të kaluara ka shaktuar degradim të mjedisit, duke përfshirë erozionin, depërtimin e ujërave të kripura, dhe ndotjen nga shkarkimet industriale e urbane. Erozioni është shqetësim serioz për Qarkun e Fierit. Të dhënat e marra nga institutet kërkimore tregojnë që humbjet e tokës të shkaktuara nga erozioni në Shqipëri janë rreth 20-30 ton/ha/vit, por në zona të veçanta arrijnë 150 ton/ha/vit.<sup>19</sup> Përveç karakteristikave gjeologjike dhe relievit të rajonit që janë shkak për 20% të erozionit total, ka edhe faktorë të tjerë shkaktarë për shtimin e erozionit. Dy faktorë që ndihmojnë erozionin janë shpyllëzimet masive, veçanërisht në zonat malore e kodrinore, dhe kullotja e pakontrolluar e dhive. Një fenomen i ri i tokës në dekadën e fundit ka qenë braktisja e disa kategorive të tokës së punueshme të tilla si

parcelat larg vendit ku banohet, të pjerreta, me pjellori të ulët. Kjo praktike ka kontribuar më tej në përdorimin jo të përshtatshëm të tokës dhe degradimin.

Ndotja e tokës është një problem tjetër i rëndë në qarkun e Fierit, mbi 200 km<sup>2</sup> është e ndotur nga industria e naftës. Fusha naftëmbajtëse e Patos Marinzes, dhe brigjet e lumit Gjanica janë dy shembuj të mirënjohur. Fundi i teknologjisë së tubacioneve përdorur në nxjerrjen e naftës, përpunimi dhe ruajtja e saj, janë shkak-taret për dëmin e shkaktuar vitet e kaluara. Duke shtuar ndotja e tokës për shkak të hedhjes së pakontrolluar të plehrave si dukuri në rritje në rajon.

Përmbytjet dhe rrëshqitjet e tokës ndodhin shpesh si pasojë e dëmeve e shkatërrimeve nga faktorët të përmendur më lart.

#### Përdorimi i tokës dhe urbanizimi

Qarku i Fierit është një nga qarqet kryesore bujqësore të Shqipërisë. Disa nga politikat kryesore komuniste të tilla si hapja e tokave të reja kanë rëndë qarkun e Fierit. Sipas Raportit të Gjendjes së Mjedisit, gati 30% e tokës pyjore dhe gati gjysma e kullotave u kthye në tokë të kultivueshme midis viteve 1960 dhe 1980, në nivel kombëtar. Si rezultat i sistemit komunist të planifikimit të centralizuar që e bazonte zhvillimin ekonomik në një bujqësi intensive, sipërfaqja e tokës bujqësore pothuaj u dyfishua në këtë periudhë, duke zvogëluar kështu sipërfaqen e ekosistemeve natyrore.

Qarku i Fierit ka vijuar humbjen e tokave me pyje gjatë 10 viteve të fundit. Sot 10.5 % e sipërfaqes së tokës mbulohet nga pyjet. Zonat kryesore pyjore janë të përqendruara në komunat e Divjakës, Golemit, Karbunars së Sipërme. Aktivitetet e kryera nga njerëzit të tilla si shfrytëzimi i shtrateve të lumenjve për materiale ndërtimi, shpyllëzimi dhe mbikullotja po dëmtojnë seriozisht mjedisin në qarkun e Fierit.

**Tabela 40: Përdorimi i tokës në rajonin e Fierit**

Rrethet	Sipërfaqja totale në akra	Tokë bujqësore	Kullota akra	Sipërfaqja totale e pyjeve akra	Zona të Mbrojtura akra	Toka shterpe akra	Sipërfaqja e mbuluar nga pyje %
Rrethi i Fierit	78530	56446	897	6031	1750	13531	7.7
Rrethi i Lushnjes	71239	51101	440	5007	7065	-----	7
Rrethi i Mallakastrës	39300	14720	2036	9000	50	12000	23
<b>Qarku i Fierit</b>	<b>189069</b>	<b>122267</b>	<b>3373</b>	<b>20030</b>	<b>8865</b>	<b>25531</b>	<b>10.5</b>

Burimi: Baza e të dhënave e Këshillit të qarkut Fier Zyra e Kadashtës e KQ

<sup>19</sup> Ministria e Mjedisit 2001: Plani Kombëtar i Veprimit në Mjedis

Në zonat rurale, toka e punueshme është dhënë si prone ose me qira fermerëve, të cilët në shumë raste kanë shkaktuar degradimin e saj përmes praktikave jo të qëndrueshme bujqësore dhe mënyrës së mbajtjes së bagëtive.

Në zonat urbane, mungesa e planeve të rregullta fizike, shkalla e lartë e rritjes së popullsisë dhe migrimi i saj për zonat urbane ka sjellë një rritje të pakontrolluar të popullsisë në qytetet më të mëdha (Fier dhe Lushnje) dhe rrethinave të tyre. Përveç efekteve negative që lidhen me dëmtimin e mjedisit dhe ndotjen, ky fenomen ka shkaktuar dëmtim të peizazhit dhe të vlerave turistike, veçanërisht në zonën bregdetare për shkak të ndërtimeve të paligjshme. Sipërfaqet e gjelbra kanë vuajtur më shumë me ndryshimin e qëllimit të tyre për t'u përdorur për ndërtimin e ndërtesave tregtare ose banesa. Tashme hapësira e gjelbër e qytetit të Fierit ka mbetur 117.590 m<sup>2</sup> që është dy herë më e vogël se në vitin 1992, ndërsa hapësira e gjelbër në Lushnje është zvogëluar pesë herë ndaj vitit 1990. Në bashkinë e Ballshit, zonat e gjelbra dhe parqet janë gjithashtu të pakta. Në ditët e sotme, afërsisht 0.6 ha e hapësirës publike është e mbjellë me bimë dhe/ose pemë; kjo hapësirë është pak a shumë 1-2 % e qendrës urbane të Ballshit. Duhet shtuar, se një pjesë e konsiderueshme e tokës pyjore u pre gjatë dekadës së fundit veçanërisht gjatë rrugëve hyrëse për në qytet dhe në kodrat përreth. Zonat e gjelbra përreth rafinerisë pothuaj janë zhdukur.<sup>20</sup>

Qarku i Fierit ka 8.867 ha tokë të mbrojtur, siç parqitet më poshtë:

Diversiteti i ekosistemit të lagunes në qarkun e Fierit, përbën një habitat të rëndësishëm dimëror për speciet e zogjve shtegtarë. Me vendim të Këshillit të Minis-

trave Nr.413, Gusht 22, 1994, laguna e Karavastasë dhe Parku i Divjakës janë deklaruar ekosisteme me mbrojtje të veçantë. Kjo zonë ka vlera të veçanta të faunës (pelikani kaçurrel, dallëndyshja e detit dhe rosa e egër), florës (kallama, eukalpt etj.). Duhet shtuar vlerat kulturore dhe historike (kisha e vjetër e ShënThanasit me afreskat e mrekullueshme të Onufrit) që janë potenciale të mira për zhvillimin e turizmit.

Monitorimi i duhur dhe menaxhimi i zonave në mbrojtje është nevojë thelbësore për ruajtjen në të ardhmen të këtyre vlerave. Strategjia dhe Plani i Mbrojtjes së Biodiversitetit (1999), Ligji për "Zonat në Mbrojtje" Nr.8906 datë 6 qershor 2002 dhe ligji për Mbrojtjen e Biodiversitetit (projektiligj) pritet të influencojnë mbi masat për menaxhimin e duhur dhe mbrojtjen e ekosistemeve si dhe speciet e faunës dhe florës në qarkun e Fierit. Përgjegjësia për menaxhimin dhe përdorimin e tokës u përket disa institucioneve të pushtetit lokal dhe qendror. Ka një mbivendoje në përgjegjësitë e institucioneve të ndryshme dhe ndarja dhe përcaktimi i detyrave nuk ka qenë i qartë.

Në nivel kombëtar, organi më i lartë vendimmarrës lidhur me përdorimin e tokës dhe planifikimin territorial është Këshilli i Rregullimit të Territorit i Republikës. Në nivel lokal, autoriteti është Këshilli i Rregullimit të Territorit i Bashkisë dhe prefekturës. Janë hartuar disa master plane për planifikimin e territorit në zonat bregdetare. Sidoqoftë, pjesa më e madhe e tyre, nuk e merr mbrojtjen e mjedisit plotësisht në konsideratë. Në praktike nuk ka një politikë të integruar për përdorimin e tokës.

Transformimet sociale dhe ekonomike si dhe lëvizjet demografike kërkojnë zbatimin e vizionit afatgjatë për zhvillim urban e jedisor të qëndrueshëm.

Table 41: Zonat e Mbrojtura



Rrethet	Komunë/Bashki	Emri	Hapësira (ha)	Lloji
Fier	Komuna Levan	---	1700	Rezervë e menaxhuar nga Shteti
	Komuna Libofshe	Pylli i Kurorës	50	Monument Natyror
Lushnja	Bashkia e Divjakës	Parku Kombëtar i Divjakës	1250	Park Kombëtar
	Bashkia e Lushnjes	Kulari	850	Rezerve e menaxhuar nga Shteti
Mallakastra	Bashkia e Divjakes	Laguna e Karavastasë	5000	Park Kombëtar
	Komuna Hekal	Poçem	50	Park Kombëtar


<sup>20</sup> Bashkia e Ballshit, 2003. Axhenda 21 raport





harta 4





## Infrastruktura dhe shërbimet Publike

### Furnizimi me ujë

Ka rreth 84 tubacione ujësjellësi në qarkun e Fierit. Nga këta shtate furnizojnë qytetet e mëdha të qarkut: Fier, Patos, Roskovec, Ballsh, Lushnje dhe Divjakë. Rreth 70% e familjeve në qark nuk mbulohen nga sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm. Këto familje u drejtohen mënyrave tradicionale të nxjerrjes së ujit (puse dhe burime sipërfaqësore të ujit si burimet). Shih hartën 4. Sasia e kufizuar e ujit jepet nga 2 deri në 20 orë në ditë. Uji kalohet në sistem nga mekanizma ngritës në pusët hidrogeologjike të ujërave nëntokësore. Tubacionet e qarkut përbëjnë gati 40% të rrjetit, ndërsa një burim i ujit jep ujë për më tepër se dy fshatra.

Tabela e mësipërme jep situatën e furnizimit me ujë në qarkun e Fierit në 2001. Afërsisht 70% e familjeve nuk kanë lidhje me sistemet e ujësjellësve.

Kushtet teknike të sistemeve të furnizimit me ujë të pi-

jshëm janë të këqija. Të ndertuara në vitet '70, gati 70% e gjithë tubacioneve janë prekur nga erozioni fizik, sepse janë prej çeliku të thjeshtë. Për rrjedhojë rreth 65% e ujit humbet në rrjet, duke ulur në mënyrë të konsiderueshme sasinë e cila shkon në banesa.

Rrethi i Lushnjes ka dy stacione pompimi për 56.000 banorët e qytetit, dhe 20.000 banorët e komunave Dushk dhe Golem. Disa pompa nuk funksionojnë për shkak të problemeve teknike dhe mungesës së mjeteve financiare për të blerë pjesë këmbimi për to.

Kostoja e vlerësuar e furnizimit me ujë është midis 60 dhe 100 lek/m<sup>3</sup>. Në Lushnje, për shkak të sistemit ngrites mekanik të ujit, kostoja është edhe më e lartë. Për shkak të mungesës së matësve të konsumit të ujit dhe shtrëngimit të vogël për të paguar<sup>1</sup> vetëm 45% e popullsisë paguan faturat e ujit. Kjo situatë ndikon në gjendjen financiare të kompanive të ujit dhe ul mundësinë për të bërë rikonstruktime dhe përmirësim të rrjetit.

Sasia e sëmundjeve prej ujit të njoftuara në qarkun e Fierit gjatë periudhës 1990- 2000



(marrë nga: Drejtoria e Shëndetësisë, Fier)

**Tabela 42: Sistemet e furnizimit me ujë në qarkun e Fierit 2001.**

Rrethet	Nr i sistemeve të furnizimit me ujë	% e nevojave të mbuluara	Nr. shtëpive	Familjet pa ujë	% e shtëpive të furnizuara nga tubacionet	Furnizim me puse Nr i puseve të ujit	Nr. familjeve	Furnizim me burime sipërfaqësore të ujit (burime) Burime	Nr. familjeve	
Rrethi i Fierit	47	15-100%	50,627	4,527	37.2	689	3,149	1,066	6,413	
		mesatarisht: 61%								
Rrethi i Lushnjes	30	35-95%	33,149	3,702	22.1	244	27300	10	-	
		mesatarisht: 60.8%								
Rrethi i Mallakastrës	7	8-80%	9,367	3,576	20.7	250	624	216	4,195	
		mesatarisht: 44.3%								
<b>Qarku FIER</b>	<b>84</b>		<b>93.143</b>	<b>11.805</b>	<b>30.1</b>	<b>1.183</b>	<b>31.073</b>	<b>1.292</b>	<b>10.608</b>	

Marrë nga: Baza e të dhënave të Këshillit të qarkut

Tendenca e tanishme e decentralizimit në menaxhimin e furnizimit me ujë pritet të përmirësojë cilësinë dhe sasinë e shërbimit, por dhe të rrisë koston e ujit për popullsinë lokale.

Sistemet e vjetra teknike dhe ndërhyrjet e paligjshme në rrjet kanë patur ndikim të konsiderueshem në cilësinë e ujit të pijshëm. Kryqëzimet me tubacionet e ujërave të zeza, filtrimi i ujërave sipërfaqësore në rrjet gjatë orëve kur banorët nuk furnizohen me ujë, rrit ndotjen e ujit, dhe për pasojë dhe numrin e sëmundjeve me prejardhje nga uji i ndotur, veçanërisht ato të aparatit tretës që janë 50% të sëmundjeve infektive të raportuara në qarkun e Fierit. Pas 1995, janë zbatuar shumë projekte në këtë fushë kryesisht me studime zbatueshmërie, propozim projektesh dhe ndërtim të tubacioneve të reja; studimet janë mbështetur nga burime të ndryshme financimi (BE, PHARE, BB, buxheti i shtetit, etj).

Disa pika të dobëta e kanë reduktuar efektivitetin e keqyre fondeve, si mbivendoja e projekteve dhe koordinimi minimal me autoritetet lokale.

### **Sistemet e ujërave të zeza**

E ngjashme me gjendjen në Qarqet e tjera të vendit, edhe në qarkun e Fierit ndeshet mungesa totale e pajisjeve të trajtimit të ujërave të zeza. Megjithatë, ka sistem ujërash të zeza në zonat urbane të qarkut të Fierit i cili është i lidhur me kolektorët kryesorë që i shkarkojnë ujërat e zeza direkt në ujërat sipërfaqësore, kryesisht në lumenj. Në zonat urbane Shqiptare vetëm gati 40% e popullsisë mbulohet nga lidhjet me sistemin e ujërave të zeza.<sup>21</sup> Për shkak të rritjes së pakontrolluar demografike dhe lidhjeve të paligjshme me ujin disa zona të reja të banimit, veçanërisht në periferi, nuk lidhen me sistemin e ujërave të zeza. Kushtet teknike të sistemit ekzistues të ujërave të zeza janë të këqija për shkak të mungesës së investimeve dhe mirëmbajtjes periodike. Duhet shtuar punimet ndërtimore intensive që kanë patur ndikim negativ. Për shembull, në Lushnje, 80 km e kanaleve të ujërave të zeza janë dëmtuar për shkak të ndërtimeve të paligjshme dhe sedimentimit.

Kjo situatë e keqe ndikon në mjedis dhe kushtet shëndetësore të popullsisë. Ujërat sipërfaqësore pranë zonave urbane janë të ndotura nga ujëra të papërpunuara.

<sup>21</sup> VKM nr. 145: dt 26.02.1998: "Për miratimin e rregullores higjieno-sanitare për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm, projektimin, ndërtimin dhe mbikqyrjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm"

Ujërat sipërfaqësore dhe ato nëntokësore të fshatrave janë të ekspozuara ndaj ndotjeve urbane dhe industriale, nga ujërat e zeza (nga rrjeti i ujërave të zeza, meqenëse ujërat e zeza të patrajtuara derdhen në ujërat sipërfaqësore), dhe nga filtrimi i kimikateve të përdorura në bujqësi, etj. Nuk ka një uzinë tratimi dhe ujërat e zeza shkaktojnë ndotje bakteriale gjatë periudhës së verës në disa plazhe pranë zonave urbane.<sup>22</sup>

Me gjithë këtë gjendje të keqe, nuk ka tregues për ndonjë investim prioritar për sistemin e ujërave të zeza në qarkun e Fierit në Planin Kombëtar të Veprimeve në Mjedis (2001). Asnjë nga përparësitë e zgjedhura për zonat urbane për investime në këtë fushë nuk është për Qarkun e Fierit. Sidoqoftë, Qarku i Fierit do të përfitojë nga procesi mbarëkombëtar për hartimin e "Strategjisë dhe Planit të Veprimeve për menaxhimin dhe pastrimin e ujërave të zeza urbane" dhe i "Strategjisë për menxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave urbane e ujërave të zeza në zonat rurale" Hartimi i strategjisë dhe i Planit të veprimit për menaxhimin e ujërave të zeza do të sigurojë zgjidhje optimale për kontrollimin dhe lehtësimin e ndotjes mjedisore të ardhur nga këto burime ndotjeje.

### **Mbetjet e ngurta**

Menaxhimi i mbetjeve të bashkisë dhe atyre industriale është thelbësor për zhvillimin e qëndrueshëm, por nuk mund të shihet i izoluar nga kushtet e përgjithshme ekonomike dhe politike të periudhës së tranzicionit. Menaxhimi i mbetjeve kërkon burime për infrastrukturën, veprimet, mirëmbajtjen, kërkime e zhvillime, dhe të gjitha këto kanë munguar në qarkun e Fierit (e përgjithësisht në Shqipëri).

Tranzicioni për në ekonominë e tregut, solli rritjen e sasisë së mbetjeve të ngurta në zonën e Fierit. Faktorët kryesorë që kontribuojnë në këtë rritje të konsiderueshme janë modelet e reja të konsumit që hynë në shoqërinë shqiptare dhe shkalla e rritjes së shpejtë të zonave urbane. Në nivel kombëtar, rritja mesatare vjetore e vlerësuar e nxjerrjes së mbetjeve në bashki gjatë viteve 1998-2002 ishte midis 8-10% në qytetet e mëdha<sup>23</sup>. Sipas të dhënave të Ministrisë së Mjedisit për vitet 1999-2000, prodhimi i mbetjeve mbeti në 0,7 kg/banor/ditë ose 244 kg/banor/vit në katër qytetet kryesore<sup>24</sup>.

<sup>22</sup> UN, Komisioni Ekonomik për Europën 2002: Rishikimi i Përformances Mjedisore: Shqipëria

<sup>23</sup> Ministria e Mjedisit: Raport rreth Gjendjes së Mjedisit 1999-2000

<sup>24</sup> OKB, Komisioni Ekonomik për Europën 2002: Rishikimi i arritjeve Mjedisore: Shqipëria

► Tabela 43: Prodhimi i mbetjeve të ngurta në zonat e Qarkut të Fierit 2002

Zona	Sasia (ton/ditë)
<b>Rrethi i Fierit</b>	<b>112.4</b>
Bashkia Fier	98
Bashkia Patos	8.4
Bashkia Rroskovec	6
<b>Rrethi i Lushnjes</b>	<b>70</b>
Bashkia Lushnje	60
Bashkia Divjake	10
<b>Rrethi i Mallakastrës</b>	<b>13</b>
Bashkia Ballsh	13
<b>Bashkitë në qark</b>	<b>195.4</b>

Marrë nga : Baza e të dhënave të Këshillit të qarkut

Të dhënat e mbledhura nga 6 Bashkitë e Qarkut, nxjerrin që prodhohen afërsisht 195 ton mbetje në ditë, siç tregohet dhe në tabelë- dhe mblidhet 100% e mbetjeve të prodhuara. Megjithatë ka nevojë urgjente për sisteme informacioni mbi prodhimin, mbledhjen, transportin dhe hedhjen e mbetjeve në mënyrë që të ketë një bazë të dhënash të sakta e cila do të mbështesë planifikimin e shërbimit dhe strategjinë për të përmirësuar kushtet e menaxhimit të mbetjeve. Në shumicën e zonave urbane mbetjet mblidhen dhe transportohen nga kompani bashkiake ose private të mbledhjes së mbeturinave. Zonat rurale ende nuk mbulojnë

nga shërbime të menaxhimit të mbeturinave, popullsia gjen zgjidhje individuale të tilla si djegja ose hedhja jashtë vendeve të caktuara.

Nuk ka vende të administruara nga pushteti lokal për hedhjen e plehrave. Mbeturinat zakonisht digjen në vende të hapura, duke shkaktuar ndotje të madhe në zonat përreth. Si pasojë banorët lokalë dhe kafshet janë të ekspozuar ndaj substancave toksike (dioksinë etj.) të cilat përbëjnë rrezik ndaj shëndetit të tyre. Duhet shtuar, se ka ndotje të ajrit dhe të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore veçanërisht në Fier, Ballsh dhe Lushnje.

► Tabela 45: Mbledhja e mbetjeve të ngurta të bashkisë dhe sistemet e hedhjes në 6 bashki të qarkut të Fierit.

Bashkitë	Numri i kazanëve mbledhës	Nr. i fushave të plehrave me mbushje	Hedhja e mbjeturinave të mbledhura	
			Numri i vendeve ku bashkitë hedhin plehrat	Mbetjet e hedhura në vendet ku bashkitë hedhin plehrat (ton/ditë)
Fier	350 kazanë plehrash 50 pika mbledhëse	0	1	98
Patos	60 kazanë plehrash 60 pika mbledhëse	0	1	8.4
Rroskovec	30 pika mbledhëse 30 pika mbledhëse	0	1	6
Ballsh	235 kazanë plehrash 168 pika mbledhëse	0	1	13
Lushnja	24 kazanë 30 pika mbledhëse	0	1	60
Divjaka	100 kazanë të vegjel plehrash(zona e plazhit)	0	1	10
<b>Total</b>		<b>0</b>	<b>6</b>	<b>195.4</b>

Marrë nga: Baza e të dhënave të bashkive

Ka dy instalime të vjetra për ndarjen dhe riciklimin e letrës dhe plastikës në qytetin e Lushnjës. Bëhen disa aktivitete informale si ndarja e shisheve plastike (vetëm shisheet), leter dhe karton, skrap çeliku, kanaçe alumini, dhe sasi të vogla të copave të bakrit. Sidoqoftë, ka pak informacion rreth kompanive të cilat përzgjedhin dhe ripërdorin mbetje të tilla.

Një problem tjetër tepër i madh është dhe administrimi i mbetjeve të rrezikshme industriale. Në ish fabrikën e plastmasit në Lushnje janë 200 ton materile bruto të rrezikshme, të cilat përmbajnë Pb dhe Cd, PVC, etj.

Vendet ekzistuese ku hidhen plehrat nuk janë të izoluar dhe nuk kanë masa të tjera mbrojtëse për të ndaluar ujërat nëntokësore nga depërtimi dhe rrjedhimisht çlirimi e kalimi metaleve të rënda e ndotësve të tjerë. Duhet shtuar, se nuk ka sistem kullimi dhe nuk ka ndonjë pus afër këtyre vendeve që të përdoret për mbikëqyrje. Në shumicën e rasteve mbeturinat industriale depozitohen në të njëjtat vende me mbetjet urbane duke sjelle efekte negative në mjedis.

Mbetjet spitalore nuk kanë ndonjë trajtim të veçantë. Nuk ka të dhëna për sasinë e mbetjeve spitalore në qarkun e Fierit. Megjithatë në nivel kombëtar shifrat për shtatë qytetet më të mëdha tregojnë që janë 7.3 ton në ditë ose 2.600 ton në vit<sup>25</sup>. Një projekt i ECAT në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Organizatën Botërore të Shëndetësisë, financuar nga EU LIFE, po përgatit një plan strategjik për trajtimin e mbetjeve spitalore të Tiranës. Pritet që spitalet e Fierit, Lushnjës dhe Ballshit të fillojnë të zbatojnë rekomandimet e këtij plani siç kërkohet nga Ministria e Shëndetësisë.

## • Transporti dhe infrastruktura e rrugëve

Ky sektor është një nga ata që ndryshon më shpejt dhe i kushtohet vëmendje e veçantë në zonat urbane. Ka gati 12.980 automjete dhe rreth 7.566 autobusë, mikrobusë, ekskavatorë në qarkun e Fierit, krahasuar me 99.000 automjete në gjithë Shqipërinë më 1999<sup>26</sup>. Automjetet janë përgjithësisht të vjetra dhe përdorin benzinë me plumb dhe naftë. Për shkak të kushteve të rrugëve, makinat kanë motor relativisht të fuqishëm duke konsumuar më shumë karburant. Standardet e karburantit prej naftë e kufizojnë përmbajtjen e squfurit (maksimumi 0.2% e peshës), ndërsa standardet e benzinës kufizojnë përmbajtjen e plumbit (maksimumi 5ppb) dhe të squfurit (maksimumi 0.001%). Standardet e tanishme të karburantit në Shqipëri u miratuan më 1987.

Për sa i përket infrastruktures së rrugëve, Qarku i Fierit ka 585,6 km rrjet rrugor, (19.2% e rrjetit rrugor të vendit), nga të cilat 369,3 km janë rrugë rurale dhe 216.3 km janë rrugë në bashki; afërsisht 60% janë të shtruar<sup>27</sup>. Nje pjesë e këtij rrjeti i përket rrugëve të korridorit strategjik veri – jug. (shih Hartën 7). Veçanërisht në Komuna rrjeti rrugor është i keq, gjë që pengon rëndë përparimin ekonomik, pasi krijon vështirsi për trtransportin e mallrave e të njerëzve në tregjet e qyteteve.

Disa nga rruget e rëndësishme nacionale, janë rindërtuar me ndihmë financiare të donatorëve të ndryshëm. Kapaciteti i Qarkut të Fierit për të përmirësuar gjendjen e rrjetit rrugor është i kufizuar dhe i pamjaftueshëm.

► Tabela 45: Rrugët në qarkun e Fierit

Rrethi	Gjatësia në km.			Lloji i rrugës	
	Rruget	Total	Të shtruara	Rajonale	Bashkiake
Rrethi i Fierit	51	274.1	189.7	179.3	94.8
Rrethi i Lushnjës	38	196.6	111.8	137.3	59.3
Rrethi i Mallakastrës	23	114.9	35.7	52.7	62.2
<b>Qarku</b>	<b>112</b>	<b>585.6</b>	<b>337.2</b>	<b>369.3</b>	<b>216.3</b>

Marrë nga: Baza e të dhënave të bashkive

<sup>25</sup> OKB, Komisioni Ekonomik për Europën 2002: Rishikimi i arritjeve Mjedisore: Shqipëria

<sup>26</sup> UN, Komisioni Ekonomik për Europën 2002: Rishikimi i Përformances Mjedisore: Shqipëria a

<sup>27</sup> Ministria e Pushtetit Lokal: vendim Nr 22 datë 30.05.2001

Fonde të planifikuara nepërmjet buxhetit të shtetit janë të kufizuara (afërsisht 600 mijë Lek për km). Mungesa e makinerive të mjaftueshme e ngadalëson progresin e riparimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve.

### • Prodhimi dhe konsumi i energjisë

Industria energjitike në qarkun e Fierit ka rëndësi të madhe dhe bazohet në burimet e naftës dhe instalimeve për nxjerrjen dhe përpunimin e naftës e gazit natyror. Deri tani janë nxjerre vetëm 10%, nga rezerva e vlerësuar prej 490 milion ton naftë në fushat Patos-Marinez. Shkalla e përpunimit të naftës për 1990-2000 mbetet e njëjta, ndërsa ka një rritje të vogël në prodhimin e nënprodukteve të saj. Me 2.000 puse që mbulojnë 200km<sup>2</sup>, fusha naftëmbajtëse e Marinez në Patos është një nga fushat naftëmbajtëse më të mëdha dhe më të rëndësishme në Shqipëri. Është një nga pesë fushat që furnizojnë rafinerinë e Ballshit.

Fusha e Patosit prodhon për momentin 400 ton/ditë naftë bruto, një rënie kjo nga prodhimi i hershëm prej 2.000 ton. Për fat të keq, fusha naftëmbajtëse është një burim i tmerrshëm ndotjeje për tokën, ujërat nëntokësore dhe ajrin. Familjet të cilat banojnë në një fshat të vogël brenda kësaj fushe janë të ekspozuara ndaj rreziqeve të mëdha për shëndetin.<sup>28</sup>

Si rezultat i gjendjes së vështirë që përjetoi industria e energjitikës gjatë 2000, termocentrali i Fierit u përdor të gjeneronte energji, gjë që solli ndotjen mjedisore për shkak të çlirimit të gazrave që përmbanin SO<sub>2</sub>, CO<sub>2</sub> dhe pluhur. Më 1997-1998 termocentrali çliroi në ajër 1.650 ton hi, 7.100 ton SO<sub>2</sub> dhe 14.200 ton CO<sub>2</sub>.

### Zonat e nxehta mjedisore në qarkun e Fierit

Duke ndjekur kërkimet paraprake intensive dhe konsultimin me Programin Mjedisor të Kombeve të Bashkuara (UNEP) janë përcaktuar nëntë zona të Shqipërisë të konsideruara si “zona të nxehta” mjedisore (shih Hartën 6) për shkak të ndotjes së shkaktuar nga instalimet industriale. Tre nga këto zona të nxehta ndodhen në qarkun e Fierit: fusha naftëmbajtëse e Patos-Marinez, Rafineria e naftës në Ballsh dhe Uzi-na e Plehrave Kimike – Azotiku. Shqetësimet më të mëdha të identifikuara në çdo zonë të nxehtë janë:

<sup>28</sup> UNEP 2000: Vlerësimi paskonfliktual i Mjedisit në Shqipëri

### • Fusha naftëmbajtëse e Patos-Marinez<sup>29</sup>

- Familjet që banojnë në fushën naftëmbajtëse janë të ekspozuara ndaj rreziqeve serioze shëndetësore.
- Ujërat nëntokësore janë shumë të ndotura nga nafta e puseve, pompave, tubacioneve dhe pajisjeve paratrajtuese.
- Gazi sulfurik dhe emetimet e hidrokarbureve ndotin atmosferën përreth.

Me 2.000 puse që mbulojnë rreth 200km<sup>2</sup>, fusha naftëmbajtëse e Marinez në Patos është një nga fushat naftëmbajtëse më të mëdha. Fusha e Patosit prodhon për momentin 400 ton/ditë naftë bruto, një rënie kjo nga prodhimi i hershëm prej 2.000 ton. Për fat të keq, fusha naftëmbajtëse është një burim i tmerrshëm ndotjeje për tokën, ujërat nëntokësore dhe ajrin.

Ndotja e rëndë e tokës dhe ujërave nëntokësore vjen nga burime të ndryshme. Sipas ekspertëve kombëtarë, puset e ujit të pijshëm marrin ujë nga një shtresë ujore e poshtme e cila është e mbrojtur nga një shtresë argjile. Puset e naftës, megjithatë, kanë shpuar shtresën argjilore dhe ka shumë të ngjarë që i lejon hidrokarburet të ndotin ujin e pijshëm.

Ndotja e fushës naftëmbajtëse dhe zonës përreth saj nuk është vlerësuar asnjëherë sistematikisht. Drejtuesit e kompanis Albpetrol nuk kanë llogaritur sasinë e naftës bruto që rrjedh në fushë, por ajo vlerëson një humbje prej 1-2% të sasisë totale të pompuar, domethënë, 4 deri 8 ton në ditë. Drejtuesit kanë një propozim për mbylljen e puseve, krijimin e të rinjve dhe të rifusin në puse ujërat e ndotura dhe disa fraksione të para-trajtimin të naftës bruto. Propozimi sidoqoftë mund të përmbajë vlerësime optimiste dhe sido që të jetë i mungojnë fondet për përfundimin e tij.

Një pjesë e naftës e marrë gjatë para-trajtimin mendohet të riciklohet. Sidoqoftë, meqë pajisjet e para-trajtimin nuk funksionojnë ashtu siç duhet ujëra të patrajtuara me përmbajtje naftë bruto derdhen direkt në mjedis dhe kullojnë në lumin e Gjanicës. Ky lumë furnizon me ujë të pijshëm banorët që banojnë pranë nëpërmjet puseve private. Meqenëse puset janë pranë lumit, ka mundësi që furnizimi me ujë të ndotet nga sasia e ujit të lumit.

Fushat naftëmbajtëse janë gjithashtu burim ndotjeje për ajrin. Nafta ruhet në rezervuarë të hapur nga të cilët avullojnë hidrokarbure. Në fusha të gjera pom-

<sup>29</sup> UNEP 2000: Vlerësimi paskonfliktual i Mjedisit në Shqipëri



harta 6



- Kufinjtë e qarkut
- Bashkitë / Komunat
- Popullsia
- 1406 - 3484
- 3484 - 8229
- 8229 - 15688
- 15688 - 40306
- 40306 - 61011

Zonat e ndotura





pat shkarkojnë 8.000 meter kub gaz çdo ditë i cili përmban përbërës sulfurikë. Megjithëse nje e pesta e kësaj sasive merret për të prodhuar energji për puset, katër te pestat e ngelura emetohen direkt në atmosferë. Kjo është e barabarte me një sasi sqfuri prej 115 ton në vit. Ndihet nje ere e forte hidrokarburesh dhe sulfur hidrogjeni në ajër. Thithja e gjatë e tij mund të shkaktojë bllokimin e frymëmarrjes.

### • Rafineria e naftës ne Ballsh<sup>30</sup>

- Sasi të mëdha naftë nga nafta e rafinerisë emetohen në mjedisin përreth.
- Uji i ndotur që përmban papastërti naftë hidhet në një kanal, duke ndotur Lumin e Gjanices dhe ka shumë mundësi të ndikojë dhe në burimet lokale të ujit.
- Rafineria emeton disa ndotës toksikë në atmosferë.

Rafineria ne Ballsh Prodhon 300,000 ton naftë të rafinuar në vit, më pak se një e treta e kapacitetit të saj. Uzina shkarkon sasi të mëdha naftë ne mjedisin përreth, veçanërisht në Lumin e Gjanices. Puset private lokale të ujit përgjatë lumit ka shumë mundësi të jenë të ndoten.

Një nga shkaqet e derdhjes së naftës në mjedis është pamundësia i repartit të trajtimit të ujërave të ndotura të uzines për të funksionuar si duhet. Ky repart i trajtimit të ujërave ishte planifikuar të shkarkonte një maksimum prej 300 mg/liter të përbërësve të tretur. Sipas drejtuesve, sidoqoftë, nuk kishte parashikuar papastërtinë e naftës bruto me një përmbajtje të lartë sqfuri (6%) as materialet e ngurta ne naftë për shkak të një trajtimi të pamjaftueshëm ne fushë. Sii rezultat, repartit nuk funksionon siç duket. Uji i cili përmban naftë dhe përbërës të naftës derdhet direkt në kanal që shkon ne Lumin e Gjanices.

Lumi i Gjanices siguron ujë të pijshëm për banorët lokalë me anë të puseve private anës lumit. Sipas autoriteteve lokale, depozitime të naftës bruto janë identifikuar disa kilometra poshtë rrjedhës prej rafinerisë. Një inspektim pamor i lumit konfirmon këto gjera, dhe një mostër uji e marrë 2,5 – 3 kilometra ne rrjedhën e poshtme kishte gjurmë të naftës.

<sup>30</sup> UNEP 2000: Post conflict Environmental Assessment - Albania

Rafineria emeton gjithashtu dioksid sqfuri, sulfur hidrogjeni, hidrokarbure dhe dioksid karboni në atmosferë. Nuk janë hartuar programe monitorimi ose investigimi për të vlerësuar shkallën e ndotjes së tokës e ujërave të nëntokës në truallin e rafinerisë dhe në zonat përreth saj poshtë rrjedhës.

### • Uzina e Plehrave Kimike – Azotiku Fier<sup>31</sup>

- 850 m<sup>3</sup> arsenik dhe lëndë arseniku kërkojnë largim detyrimisht.
- Toka, dhe ka shumë mundësi dhe ujërat nëntokësore janë të ndotura me një nivel të lartë arseniku. Ujërat nëntokësore ushqejnë një lumë i cili furnizon me ujë puset e ujit. Ujërat e patrajuara shkarkohen ne të njëjtin lumë.

Uzina e Fierit prodhonte plehra kimike nga 1967 deri në 1992. Gjatë një periudhe katërvjeçare 1967-1971, uzina ka përdorur naftë bruto me një përqindje të lartë sqfuri. Sqfuri hiqej me solucione të arsenikut. Problemi kryesor i uzinës është si të largojë gati 850 meter kub arsenati dhe solucion arseniku. Solucioni ka përqendrim prej 25g/litër dhe ruhet ne katër kontenierë 30-vjeçarë çeliku. Kontenierët të cilët po shfaqin shenja korrozioni janë të vendosur në një bazament betoni prej 200-metër kub për t'u mbrojtur nga rrjedhjet në mjedis nëse del solucion nga kontenieret. Izolimi i bazamentit të betonit nuk është i plotë. Nje mostër uji e marrë nga baseni tregoi 97.7 mg/liter arseniku.

Mostra toke, të marra në një rreze prej 50 metrash nga kontenieret dhanë vlera prej 830-172300 mg/kg arseniku. Zona e ndotur me arsenik duket të jetë e kufizuar si madhësi. Megjithatë nivelet e arsenikut të gjetur janë jashtëzakonisht të larta kundrejt standardeve europiane (kufiri gjerman për arsenikun ne tokë industriale është 140 mg/kg). Bazuar ne këto gjetje, shtresa e sipërme i ujit është e ndotur me arsenik. Pellgu ujëmbajtës kullon në lumin e Gjanices, qe mund jetë burim i ujit gjatë rrjedhës së poshtme.


Ekspertët kombëtarë kanë hartuar një plan për ta hequr arsenikun dhe solucionin e arsenikut, por mungojnë fondet. Sipas planit të propozuar, solucioni do të trajtohet me përbërje për të reduktuar sasinë e tij dhe pastaj të hiqet për t'u lënë në një fushë plehrash. Megjithëse prodhimi i uzinës është minimal, ujërat e

<sup>31</sup> UNEP 2000: Vlerësimi Post Konfliktual Mjedisor Shqiptar



# Përfshirja e popullsisë në rrugën nacionale për Qarkun e Fierit

harta 7



1:400000



ndotura shkarkohen ne Lumin e Gjanices të patrajtura. Nuk ka program vlerësimi për influencën e ujërave të ndotura ne mjedis.

### **Sistemet e informimit për mjedisin (SIM)**

Menaxhimi i keq i mjedist vjen nga mungesa e institucioneve mjedisore në qarkun e Fierit. Procesi mbarëkombëtar i decentralizimit kërkon forcim institucional dhe planifikim strategjik më të mirë për menaxhimin e mjedisit në nivel lokal. Hartimi dhe futja e Regjistrimit të çlirimit të Ndotësve (PRTR) në bizneset private për të monitoruar më mirë përbërësit mjedisorë do të mbledhë të dhëna të mjaftueshme për të kuptuar tendencat e ardhme dhe për të hartuar planifikim strategjik te duhur në nivel lokal.

Burimi i vetëm për informacion mjedisor gjendet në Agjencinë rajonale të mjedisit, së cilës i mungojnë mjetet dhe aftësitë për të përgatitur bazë të dhënash SIM. Duhet shtuar, se çdo bashki është e detyruar të krijojë sektorin mjedisor. Sipas Konventës së Aarhusit mbi “Mundësinë e marrjes së informacionit, Pjesëmarrjen e Publikut në vendimmarrje, aksesin në Drejtësi për çështjet e mjedisit”, ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë në tetor 2000, publiku duhet të ketë mundësi të marrjes së informacionit mjedisor dhe autoritetet lokale duhet të parashikojnë masa dhe hapa për aplikimin e këtyre të drejtave.

Qeveria e Shqipërisë ka vendosur të përgatisë Planet Lokale të Veprimit në Mjedis si pjesë integrale të Planit Kombëtar të Veprimit në Mjedis.<sup>32</sup> Kjo është gjithashtu në përputhje me strategjinë e decentralizimit të pushtetit lokal. Në këtë kuadër Plani Lokal i Veprimit në Mjedis për Qarkun e Fierit do të jetë pjesë e strategjisë së mjedisit dhe do të monitorojë mjedisin në nivel lokal. Ai do të identifikojë përparësitë, do të zhvillojë aftësitë për ndërtimin e kapaciteteve për aktorë të ndryshëm dhe do të ndihmojë demokratizimin e metejshëm dhe qeverisjen e mirë. Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) Shqipëri, ka iniciuar tashmë procese të ndryshme dhe ka përgatitur materiale rreth zhvillimit të Planit Lokal të Veprimit në Mjedis në Lezhe, Korçë, etj. Procese të tilla ndihmojnë në zhvillimin e rrugëve të komunikimit publik për plane transparente dhe të bazuara.

<sup>32</sup> Ministria e mjedisit 2001: Plani Kombëtar i Veprimit për Mjedisin

## **Gjendja institucionale dhe qeverisja lokale**

Në vitet 90 Shqipëria filloi të kalonte në sistemin e qeverisjes më të decentralizuar. Kushtetuta e Shqipërisë, e miratuar më 1998, krijoi dy nivele të Qeverisjes Lokale: Komunitat dhe Bashkitë si nivel bazë i parë, dhe Qarkun si nivelin më të lartë të qeverisjes lokale. Më 2000 u miratua Ligji mbi organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor No 8652, duke përcaktuar funksionet e bashkisë, komunës dhe Qarqeve.

Ligji 8652, përcakton funksionet e mëposhtme për Këshillin e Qarkut:

- Zhvillimi dhe hartimi i politikave rajonale dhe harmonizimi i tyre me politikën kombëtare në nivel rajonal.
- Kryerja e funksioneve që i janë dhenë qarkut nga komunitat dhe bashkitë
- Kryerja e funksioneve të deleguara qarkut nga qeveria qendrore

Sidoqoftë, sipas Ministrisë së Pushtetit Lokal, aktiviteteve të Qarqeve u mungon ende kuadrin ligjor i qartë, i cili jep funksionet, kompetencat dhe përgjegjësitë e qarkut. Ka gjithashtu kufizime të tjera në rolin e KQ për shkak të ndarjes jo të qarte të përgjegjësisë midis Prefekturës, Departamenteve në varësi të Ministrive në Këshillin e Qarkut.

### **Roli i Këshillit të Qarkut të Fierit**

Me qëllim që të qartësonte rolin e tij e përgjegjësit dhe për të përgatitur SRZH bazuar në këto konkluzione, Këshilli i Qarkut Fier ndërmori një proces të gjerë konsultues me përfaqësues nga Këshilli i Qarkut dhe aktorë kyç të cilët formuan “Grupin e Punës”.

Procesi konsultues vazhdoi nga nëntori 2002 deri në maj 2003. Anëtarët e Këshillit të Qarkut kanë rënë fillimisht dakord me parimet bazë të mëposhtme udhëheqëse për punën e Këshillit të Qarkut:

- Roli bashkëndues.
- Menaxhim i çështjeve ndërdepartamentale.
- Orientim drejt zhvillimit

Pas procesit të konsultimit, Grupi i Punës analizoi gjashtë sektorë kryesorë: arsimit, shëndetit, kulturës dhe sportit, infrastruktura dhe urbanizimi, mjedisi dhe zh-

<sup>33</sup> Ministria e Pushtetit Lokal: vendim Nr 22 datë 30.05.2001



## Sektori

### Përgjegjësite e propozuara që duhet të ketë KQ

#### Arsim

- Mbështetje për zbatimin e Strategjisë mbi Arsimin, përfshirë dhe programe të veçanta për të mundësuar shkollimin e grupeve të minoriteteve
- Mbështetje për hartimin e një plani mbi shpërndarjen e shkollave për të identifikuar dhe ulur disnivelet midis rretheve të ndryshme në rajon
- Mbështetje për hartimin e programeve kualifikuese profesionale
- Koordinimi i aktorëve për të përmirësuar investimet në sektorin e arsimit

#### Shëndetesi

- Mbështetje për hartimin e një plani për shpërndarjen e infrastrukturës shëndetësore për të identifikuar dhe ulur disnivelet midis rretheve të ndryshme në rajon
- Koordinimi i aktorëve për të përmirësuar investimet në sektorin e shëndetësisë

- Sigurimi i asistencës teknike komunave dhe bashkive ne çështjet lidhur me menaxhimin urban, studimet urbane, zhvillimi i infrastrukturës eij. dhe trajnime të stafëve të komunës dhe bashkise

#### Infrastruktura dhe Urbanizim

- Bejja e planeve sektoriale të ndërthura në nivel rajonal për zhvillimin e infrastruktures, transportit dhe përdorimit të tokës.
- Koordinimi i aktoreve dhe investimeve që të sigurohet një menaxhim i mire urban dhe zhvillim i qëndrueshëm

- Përgatitja e planeve fizike dhe studimeve mbi menaxhimin evendeve për mbetjet e ngurta: mbetjet urbane dhe të rrezikshme dhe menaxhimi I tyre

- Sigurimi i asistencës teknike për komunat dhe bashkite mbi çështje që kanë të bëjnë me menaxhimin e mjedisit dhe hartimin e projekteve

- Organizimi i trajnimeve me stafin e komunës dhe bashkise mbi menaxhimin urban

- Monitorimi dhe përmirësimi i situatës rajonale të mjedisit brenda kuadrit të SRZH

- Koordinimi i aktoreve dhe investimeve për të përmirësuar kushtet e mjedisit

- Mbështetje për zhvillimin e aftësive : dmth planifikim biznesi, trajnime mbi ligjin e punësimit dhe taksat, kualifikimi për teknologji informuese dhe aftesite

- Shpërndarja e informacionit Qeverisjes Lokale mbi zhvillimin ekonomik për të udhëhequr investimet.

- Nxitja e zhvillimit të turizmit.

- Krijimi dhe mbajtja e strukturave bashkërenduese: mbi zhvillimi ekonomik, te infrastruktures, planifikime fizike dhe mjedis.

- Zbatimi i infrastruktures rrugore rurale (Deleguar nga Komunat)

#### Zhvillimi Ekonomik

villimi ekonomik, përcaktoi aktivitetet kryesore në secilin sektor dhe analizoi kater llojet e autoriteteve sipas kërkesave të ligjit 8652: për shërbimet, investimet, rregullator dhe administrativ.

Rezultati i procesit konsultues theksoi rolin e KQ si institucion që:

- lidh bashkitë, komunat dhe aktorët rajonalë, kombëtarë dhe ndërkombëtarë,
- bashkërendon veprimet dhe investimet brenda kuadrit strategjik rajonal.
- siguron mbështetje dhe ndihmë teknike për Komunitat, Bashkitë, si dhe për aktorët e tjerë, përsa u përket trajnimeve, mbledhjes dhe shpërndarjes së informacionit në fusha të veçanta.
- përgatit planet afatgjate sektoriale në nivel qarku;
- mbështet ndaj Komunitat dhe Bashkitë për të hartuar plane integrale në nivel lokal; mbikëqyr zhvillimin e aktiviteteve në të gjitha fushat përkatëse për të siguruar që po behet përparim drejt arritjes së objektivave të qarkut.

Arritje e këtij procesi është përpjekja e pare për një kuadër të qarte ligjor dhe institucional ku të mbështeten aktivitetet e KQ, dhe për të përmirësuar efektshmërinë e tij në përgjithësi. Në vazhdim të këtij aktiviteti KQ do të analizoje më tej përfundimet paraprake të përmbledhura në tabelën e mesipërme dhe do t'u dergohen për rishikim dhe aprovim Ministrive përkatëse.

## Qeverisja Lokale

Qeverisja për zhvillim njerëzor ka të bëjë pjesërisht me zotërimin e institucioneve eficientë dhe rregullave që nxisin zhvillimin duke e bërë tregun të funksionojnë e të sigurojnë që shërbimet publike ta meritojnë emrin. Por gjithashtu mbron të drejtat njerëzore duke nxitur pjesëmarrje të gjere në institucione dhe rregullat që ndikojnë në jetën e njerezve, si dhe arritjen e rezultateve

më të drejtpeshuara sociale dhe ekonomike. Kështu Qeverisja për zhvillim njerëzor nuk ka të beje vetëm me arritje të barabartë të frytshme, por gjithashtu edhe me proces të drejte. Qeverisja për zhvillim njerëzor duhet të jetë demokratike në thelb dhe formë nga njerezit dhe për njerezit.

UNDP Raport i Zhvillimit Njerëzor 2002

Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së në një fjalim më 1998 ka deklaruar: "Qeverisja e mire është ndoshta i vetmi faktor i rëndësishëm në zhdukjen e varfërisë dhe nxitjen e zhvillimit." Deklarata e Mijëvjeçarit e OKB-së Seksioni V, shpreh nevojën për demokraci si motor për ndryshim dhe fuqizimin e qytetareve dhe rithekson nevojën për qeverisje të mirë dhe pjesëmarrjen e qytetareve në procesin politik.

Ka një konsensus të madh ndërkombëtar se institucionet eficientë, respekti për rregullat e vlerat, dhe gjithashtu proceset politike përfshirëse kanë ndikim në rritjen ekonomike, qëndrueshmërinë e mjedisit dhe zhvillimin njerëzor. Pjesë e këtij konsensusi është lidhja e dukshme midis zhvillimit njerëzor dhe qeverisjes së mire. Qeverisja e mirë behet një nga kolonat bazë për të arritur Objektivat e Zhvillimit.

Në SKZHES, qeveria shqiptare pohon se reformat ligjore dhe institucionale janë kolonat për arritjen e objektivave në nivel kombëtar. Reformat janë thelbësore në arritjen e objektivave afatgjate të një demokracie efektive dhe qeverisjeje të mirë, që nga ana e tyre konsiderohen faktorët për zhvillim në vend dhe integrimin në BE. Më konkretisht, reformat e paraqitura nga SKZHES kanë për qëllim rritjen e efektivitetit të institucioneve në zbatimin e politikave të ligjeve, rritjen e efektivitetit financiar, ngritjen e përgjegjshmërisë, shtimin e transparencës dhe uljen e korrupsionit, e së fundi shtrirjen dhe zgjerimin e të drejtave dhe krijimin e mundësive për përfaqesim të barabartë në të gjitha nivelet e procesit publik të vendimmarrjes.

Procesi i Stabilizim Asociimit në BE, përmban si objek-

<sup>34</sup> SKZHES, 2001

tiv mbështetjen e Qeverisë Shqiptare që të zbatohet me sukses këto reforma dhe të forcoje demokracinë, rendin e shtetin ligjor. Kjo përfshin administratë eficiente publike, transparencë në procedurat publike dhe monitorim kundër korrupsionit.<sup>35</sup>

**Zhvillimi kërkon efektivitet të lartë në institucionet publike, ndërsa ulja e varfërisë kërkon një proces vendimarrës të drejtë, të hapur dhe gjithëpërfshirës për gjithë grupet sociale, veçanërisht për të varferit dhe grupe të tjera të pambrojtura. SKZHSE, 2001.**

Në qarkun e Fierit ka një kërkesë të madhe për qeverisje të mirë. Aktorët dhe qytetarët kanë përcaktuar e marrë përsipër Vizionin 2015 për Qarkun, i cili shpreh nevojën për institucione publike eficiente dhe përfshirje më të gjere të qytetarëve në vendimarrje. Bashkësia në qarkun e Fierit e ka veçuar qeverisjen e mirë si një nga pesë përparësitë për zhvillimin në rajon.

Disa përpjekje janë bërë gjatë muajve të fundit për të përmirësuar qeverisjen në rajon. Adoptimi i procesit planifikues përfshirës për përgatitjen e Strategjisë së Qarkut dhe Planit të zhvillimit bashkiak në Ballsh janë dy shembuj të mirë sesi pushteti mund të përfshijë njerëzit në vendimarrje.

Përveç pjesëmarrjes së qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile, edhe media u konsiderua një aktor i rëndësishëm në procesin planifikues. Kjo e ka sensibilizuar median mbi çështjet me prioritet për rajonin, dhe ka krijuar një atmosferë të përshtatshme për pjesëmarrje me aktive të saj si një "rojë" e demokracisë dhe qeverisjes së mirë.

Komuna e Hekalit dhe e Cakranit, ashtu si dhe Bashkia Ballsh mbështetën procesin e mobilizimit social të propozuar nga PQV të PNUD-it dhe krijojnë një kuadër ligjor për ngritjen e Organizatave me Bazë Komunitare. Këto organizata kanë punuar me objektivin për forcimin e bashkësiat dhe shtimin e lidhjeve midis qever-

<sup>35</sup> BE . Raport që po përgatitet i Komisionit për Këshillin mbi punën e Grupit Drejtues të Nivelit të lartë BE/Shqipëria për bisedimet negociimin për Marrëveshjen e Stabilizimit Asociimit me Shqipërinë. 2001

isjeve lokale dhe shoqërisë. Shumë iniciativa të përbashkëta për zhvillim social ekonomik janë ndërmarrë në fshatra dhe kanë treguar se partneriteti është një rrugë efektive për ta sjelle zhvillimin në nivel lokal.

Qendrat e hyrjes së publikut në internet u krijuan në rajon me mbështetjen e PNUD-it, si një mënyrë inovative për të nxitur ndërveprimin midis qeverisë dhe qytetarëve dhe për të sjelle hartuesit e politikave me afër zgjedhësve. Tre qendrat të instaluar në rajon duan përmirësuar dhe qytetarët duhen të orientohen më mirë sesi ti përdorin ato. Sidoqoftë këto qendra përfaqësojnë një mundësi për të rritur përfshirjen e qytetarëve në jetën politike. Rritja e mundësive të informimit, mbajtja në linjë e konsultimeve ndërmjet qeverisë me qytetarët dhe sigurimi i shërbimeve publike janë vetëm disa shembuj sesi këto qendra mund të ndihmojnë në përmirësimin e qeverisjes.

Pavaresisht nga përpjekjet për të rritur pjesëmarrjen e publikut në proceset politike dhe hapja e institucioneve lokale për futjen e praktikave të reja që sigurojnë qeverisje të barabarte dhe efektive, ka ende shumë veprime të tjera të cilat duhen ndërmarrë

· **Pjesëmarrja e qytetarëve** - Ligji Nr.8652 krijon disa mekanizma për pjesëmarrje, si mbledhjet e hapura publike. Sidoqoftë, për shkak të faktorëve kompleksë duke përfshirë këtu edhe mungesën e informacionit për publikun e gjerë dhe interesin e kufizuar për të marrë pjesë, mekanizmat ekzistuese të pjesëmarrjes nuk janë zbatuar plotësisht në qark. Ka nevojë për të institucionalizuar një sistem gjithëpërfshirës dhe sistematik për të siguruar pjesëmarrjen e njerëzve në proceset politike. Organizatave të Shoqërisë civile në Fier u mungojnë kapacitetet për të marrë pjesë në mënyrë aktive në zhvillimin e rajonit dhe të japin ndihmesën e tyre në praktikën e qeverisjes së mirë.

· **Përhapja e informacionit dhe transparencës** – ka pak instrumente zyrtare dhe sistematike që sigurojnë përçimin e informacionit tek qytetarët rreth aktiviteteve të qeverisë, procedurave publike, investimeve dhe shpenzimeve publike. Ka nevojë për rritjen e mundësisë së marrjes të këtij informacioni prej publikut, dhe që të sigurohet transparencë e procedurave dhe përdorimi i burimeve të qeverisë.

· **Pjesëmarrja e grave në vendimmarrje:** siç u paraqit në kapitullin e mëparshëm, pjesëmarrja e grave në poste drejtuese në qarkun e Fierit ende është e paktë.

· **Të drejtat e njeriut:** në qarkun e Fierit ka grupe pakicash, si ato që u paraqitën në pjesën për popullsinë, të cilat jetojnë në kushte të vështira, pa pasur mundësi të shfrytëzojnë shërbimet dhe arsimin, prandaj janë të prekshme e mund të bien viktimë e qarqeve kriminale. Këtu përfshihen krimet kundër grave e fëmijëve.





# Kapitulli 3

## Strategjia

*Objektivat e Mijëveçarit dhe SKRZH - një kuadër afatgjatë për zhvillimin e Qarkut të Fierit dhe arritjen e Vizionit të vitit 2015*



## Vizioni i vitit 2015 për zhvillimin e Fierit

*Deklarata e Vizionit:* Fieri është një Qark me mundësi të mira punësimi dhe zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik, një vend pa varfëri ku e gjithë popullsia ka shkallë arsimit të lartë dhe mund të zhvillojë në mënyrë të barabartë potencialin e saj të plotë në mjedis të pastër e të shëndetshëm, një Qark në të cilin shërbimet publike kryhen me efektshmëri përmes një administrate të kualifikuar dhe vendimet merren me pjesëmarrjen e të gjithëve.

Vizioni 2015, i formuluar nga grupi i aktorëve në Qarkun Fier dhe i mbështetur nga bashkësia e gjerë në sondazhin publik dhe mbledhjet e hapura, jep një imazh mbi konceptin sesi duhet të jetë rajoni i Fierit më 2015 dhe thekson katër çështjet e lidhura mbi zhvillimin e qëndrueshëm në rajon:

- Barazia sociale dhe kapitali njerëzor (OM 2 dhe 3)
- Zhvillimi ekonomik (OM 1)
- Cilësia e mjedisit (OM 7)
- Institucione efektive dhe qeverisje e mirë

Barazia sociale dhe kapitali njerëzor janë kërkesa për


zhvillimin e Rajonit. Këtu bëjnë pjesë disponimi i një popullsie të arsimuar duke përfshirë dhe gratë e grupet e minoriteve. Ai nënkupton formimin e aftësive të popullsisë për të ndihmuar në zhvillimin ekonomik të rajonit dhe rritjen e të ardhurave të familjeve të varfëra. Duke pasur më shumë njerëz të arsimuar jo vetëm do të ketë ndikim ekonomik në të ardhmen e rajonit por do të thotë të ketë më shumë njerëz që janë qytetarisht të përfshirë në vendimet të cilat ndikojnë në këtë të ardhme.

Një rajon me mundësi ekonomike për të gjithë do të siguronte një forcë pune të trajnuar dhe të aftë për përshatje, ashtu si dhe nxitësit e nevojshëm dhe infrastrukturën për zhvillimin e bujqësisë, industrisë dhe tregtisë. Kjo do të rriste mundësitë e punësimit dhe do të tërhiqte banorët që punojnë jashtë vendit për t'u kthyer në Fier. Duke shpresuar që të arrihen këta objektiva, kërkohen si burime të konsiderueshme dhe zhvillimi ekonomik i qëndrueshëm i rajonit.

Që një rajon të ruajë cilësi të larta të mjedisit kërkohet që gjithë përpjekjet për zhvillim të koordinohen me investimet dhe teknologjinë moderne për prodhimin e naftës dhe të energjisë. Kjo do të sillte që pjesa më e madhe e popullsisë të shfrytëzojë infrastrukturën bazë, si uji i pijshëm dhe kushtet sanitare, kurse burimet e mjedisit të menaxhoheshin në mënyrë efektive për të ekuilibruar rritjen ekonomike me qëndrueshmërinë e shoqërore e të mjedisit.

Një rajon me institucione efçente dhe qeverisje të mirë do të thellonte më tej demokracinë përmes rritjes

➤ **Figure : Relationship between four issues identified in the Vision 2015**



se pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje dhe do të siguronte një shpërndarje efiçente dhe të barabartë të shërbimeve për qytetarët e saj, me transparencë dhe pa korrupsion.

Në këtë deklaratë vizioni dhe gjatë gjithë Strategjisë, zhvillimi i qëndrueshëm njerëzor konsiderohet si objektivi final për ndërmarrjen e zhvillimit. Për më tepër, qeverisja e mire kuptohet si kusht thelbësor për arritjen e objektivave për zhvillim. Është e rëndësishme gjithashtu të vihet në dukje, ashtu siç jepet edhe në figurë që cilësia e mjedisit dhe ajo sociale, - kapitali njerëzor dhe zhvillimi ekonomik mbështeten në mënyrë reciproke dhe janë të ndërlidhura me njëra tjetren. Asnjë prej tyre nuk ka kuptim në kohë afatgjatë pa të dy elementet e tjera. Kërkohen përpjekje në nivel lokal, në kuptimin më të gjerë të fjalës për ta arritur vizionin.

## **Linjat strategjike të veprimit për zhvillimin e Rajonit të Fierit: OM-të, synimet dhe treguesit**

Ashtu siç kemi përmendur edhe më parë, bazuar në deklaratën e vizionit, identifikimi i zonave të përparësive për zhvillimin në rajon u bë përmes një vargu takimesh konsultuese duke përfshirë aktorët dhe bashkësinë. Prioritetet rajonale për çështjet kritike u identifikuan nga grupi i aktorëve duke përdorur një tufë kriteresh, që përfshinin ndikimin e çështjeve mbi bashkësinë, ngulmimin e problemit dhe përshtatjen me politikat kombëtare. Përparësitë për Qarkun u gru-

puan sipas sektorëve dhe u lidhë me OM-të si një kuadër afatgjatë për trajtimin e çështjeve. Objektivat afatgjatë për Fierin janë:

OM 1: Ulja e varfërisë

OM 2: Përmirësimi i kushteve të arsimit

OM 3: Nxitja e barazisë gjinore

OM 7: Nxitja e qëndrueshmërisë së mjedisit

Objektiv për Fierin : Përmirësimi i Qeverisjes Lokale.

Për secilin nga Objektivat afatgjatë, grupet tematike të formuara nga aktorë në rajon identifikuan objektiva, synime dhe dalluan programet me përparësi për arritjen e këtyre objektivave. Treguesit u përpunuan në bazë të të dhënave të disponueshme për të vendosur etapa. Këto etapa u vendosën nga Këshilli i qarkut me mbështetjen e ekspertit të analizës së të dhënave dhe u paraqitën për mbështetje nga aktorët dhe specialistët e rajonit dhe nga ministrinë përkatëse. Ka pasur vështirësi për të mbledhur të dhëna të besueshme e të shpërndara, gjë që e ka kufizuar këtë raport dhe ka pasur ndikim mbi analizën e gjendjes, parashikimet dhe formulimin e treguesve për të matur ecjen përpara. Strategjia rekomandon një varg studimesh në fusha të veçanta dhe sondazhe, që do të plotësonin disa zbrazëti, kur të rishikohet strategjia.

Ky seksion do të analizojë shkurtimisht çështjet kryesore të identifikuar përmes procesit konsultues dhe analizës së të dhënave dhe do të paraqesë objektivat, synimet dhe programet që do të trajtojnë çështjet për arritjen e këtyre objektivave afatgjata - OM-te.

## **OM 1: Zhdukja e varfërisë së skajshme**

Objektiva afatgjatë kombëtare - SKRZH:

- Dyfishimi i rritjes së PBB për frymë deri më 2015 shoqëruar me zgjerimin rajonal dhe përfshirjen në shkallë të madhe
- Përgjysmimi i normës së sotme të varfërisë absolute dhe zhdukja e varfërisë së skajshme

### **Çështjet ekonomike në Qarkun e Fierit**

Qarku i Fierit është duke u përballur me një situatë të vështirë ekonomike. Shqetësimet kryesore janë mungesa e një qëndrimi të integruar dhe investime më të

larta në zhvillimin rural, rinovim i papërshtatshëm i industrisë së naftës, deshtimi për të përdorur në mënyrën e duhur burimet natyrore, mungesa e skemave të kredise për BVM, dhe mangësi në aspektin profesional e kualifikimet. Ashtu si dhe në vend, edhe

në Qark shkalla e lartë e papunësisë ka çuar në rritjen e emigrimit dhe në krijimin e shumë problemeve të tjera serioze sociale. Arritja e OMI në Qarkun Fier do të doje patjetër veprime që të trajtojnë çështjet e mësipërme për zhvillimin rural dhe urban.

Duke marrë në konsideratë faktin që më shumë se 60 për qind e popullsisë së rajonit jeton në zonat rurale, bujqësia është sektori që meriton më shumë trajtim me qëllim që të rriten të ardhurat dhe të zvogëlohet varfëria, duke zvogëluar numrin e njëjërve që marrin mbështetje sociale nga qeveria. SKZHES tregon se në shkallë kombëtare 50% e të varfërve janë të vetëpunësuar në bujqësi, kurse arsyet e treguara dhe të përcaktuara në Fier janë kryesisht pamundësia për kredi të mjaftueshme dhe për të dalë në treg, copëzimi i tokës e mekanizimi i ulët. Për të pasur progres hartuesit e politikave duhet të kryejnë studime si një bazë për zhvillimin rural të integruar në Qarkun e Fierit, duke përfshirë bujqësinë dhe blegtorinë për hartimin e politikave specifike, duke forcuar lidhjet midis politikave të zhvillimit rajonale, sektoriale dhe kombëtare, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me SKZHSE dhe Kuadrin e Buxhetit Afatmesëm.

Megjithëse tepër e prekur gjatë periudhës së tranzicionit, bujqësia akoma ka një potencial të madh. Politikat për të rimekëmbur sektorin duhet të hartohen me synimin rritja e prodhimit bujqësor për tregun nëpërmjet teknologjive të reja dhe metodave moderne të organizimit. Veçanërisht një vemendje e veçantë duhet kushtuar përmirësimit të infrastrukture bujqësore siç janë kanalizimet, vaditja dhe rrjeti i rrugëve përmes kredive dhe investimeve publike. Për më tepër, ka nevojë të hartohet një program mbi mbështetjen e duhur financiare për fermeret e vegjel për të rritur përdorimin e inputeve bujqësore dhe përdorimin e teknologjive të reja. Në këtë proces përgatitja e një inventari të tokës bujqësore dhe tokës së rrezikuar nga erozioni, ndertimet e paligjshme, si dhe vlerësimi i vendeve të tregut bujqësor do të jetë një ndihmë me e madhe.

Për shkak të pozitës së tij gjeografike dhe burimeve njerëzore e natyrore Rajoni i Fierit ka një potencial për t'u zhvilluar si një nga qendrat më të rëndësishme të agro-biznesit në vend. Roli i sektorit privat në krijimin e industrive agropërpunuese do të jetë i tërësor. Pas 1997 një tendencë në rritje për investime vihet re sidomos në bujqësi, industrinë e lehtë dhe në atë

agropërpunuese. Sidoqoftë rajoni duhet të vijojë të mbështesë me shumë aktivitete në fushën e agrobiznesit, si dhe industrializimin e produkteve bujqësore përmes krijimit të strukturave industriale përpunuese.

Krijimi i kushteve të përshtatshme për zhvillimin e biznesit duhet të shikohet si kolona e dytë e rëndësishme në zhvillimin ekonomik afatmesëm në rajon. Kjo mund të bëhet nëpërmjet riformulimit të politikave fiskale në nivel lokal për të nxitur BVM, sigurimin e mbështetjes së trajnimeve profesionale, investime në infrastrukturë dhe turizem, ndertimin e tregjeve industriale si dhe krijimin e një qendre informacioni për produktet industriale që kërkojnë në tregjet e jashtme dhe të brendshme.

Strategjia e zhvillimit të biznesit duhet të ketë si qëllim krijimin e një klime të përshtatshme biznesi, që synon rritjen e faktorëve për zhvillimin ekonomik dhe sjell një shpërndarje me efektive të sektorit privat që të përmbushen kërkesat e tregut. Ky zhvillim ka objektivat e tij: rritjen e prodhimit për frymë, shtimin e vendeve të punës dhe si rrjedhim pakesimin e nivelit të papunësisë.

Ka gjithashtu nevojë për të rritur përgjegjshmerinë e të zgjedhurve lokale dhe për të luftuar kundër korrupsionit që është pengesë për bizneset private. Bashkësia e biznesit gjithashtu pretendon se marrëdhëniet biznes-pushtet lokal janë shumë të dobëta. Ata prisnin me shumë të behej nga qeverisja lokale për respektimin e ligjit kundër kontrabandës për të mbrojtur biznesin ligjor nga mallerat e falsifikuara. Administrata lokale ka vënë në një burokraci të theksuar në procesin e vendimmarrjes. Rol tjetër thelbësor luan edhe konsolidimi i sistemit të kreditimit. Sektori i biznesit ankohet nga sistemi bankar për shkak të interesave tepër të larta e të paqëndrueshme, vështirësive në marrjen e kredive.

Industria e naftës duhet të konsiderohet gjithashtu si një "motor" plotësues në zhvillimin e rajonit. Shumë punëtorë janë shkurtuar nga vendet e punës në këtë industri dhe ndeshen me probleme shoqërore për shkak të papunësisë. Ka gjithashtu një nevojë të fortë për investime në rehabilitimin e puseve ekzistuese dhe në hapjen e puseve të reja, që do të hapnin vende pune jo vetëm në industrinë e naftës por edhe në industrinë e tjera të lidhura më të.

Me qëllim që të rrisim aktivitetin e rafinerisë dhe in-

dustrisë përpunuese të naftës, strategjia duhet të synojë zëvendësimin e teknologjise së vjetër, të investojë në puse të reja gazi dhe të investojë për të rikonstruktuar pjesërisht rafinerinë e naftës në Ballsh. Sidoqoftë për shkak të dimensioneve të konsiderueshme të investimeve të kerkuara dhe nevojës për koordinim kombëtar, përgjegjësia për përcaktimin dhe zbatimin e politikave sektoriale del përtej kompetencave të qarkut.

## **Objektivat**

Bazuar në çështjet e identifikuara me sipër dy objektiva u propozuan nga grupet tematike për zhvillimin ekonomik në rajon. Grupit i aktorëve për pakësimin e varfërisë analizoi kontekstin e jashtëm e të brendshëm që ndikon për të arritur objektivat dhe vuri në dukje:

**Anët e forta:** krahu i punës me përvojë, ekzistenca e industrisë së naftës e burimeve të naftës, dhe ekzistenca e potencialeve për zhvillimin e turizmit;

**Anët e dobëta:** mungesa e të kuptuarit përfshirës të potencialeve të zhvillimit të bujqësisë e të biznesit, pamjaftueshmëria e kredive dhe mekanizimi i ulët i bujqësisë, mungesa e vendeve të tregjeve dhe e infrastrukturës;

**Mundësitë:** përvoja e mëparshme e kooperativave bujqësore;

**Reziqet:** konkurrenca e huaj, gërryerja, vërshimet dhe ndotja e tokës.

Strategjia dhe programet duhet të trajtojnë anët e dobëta, duke u mbështetur në anët e forta dhe në mundësitë e përcaktuara. Anët e dobëta tregojnë qartë se ato janë çështjet kryesore të përcaktuara në analizën e gjendjes, si mungesa e infrastrukturës në zonat rurale dhe njohuritë e pakta për potencialin e zhvillimit rural në këtë qark. Për më tepër, mungesa e kredive, mekanizimi i ulët dhe mungesa e infrastrukturës për tregtinë gjithastu ishin vënë në dukje nga analiza.

### *1. Të nxitet zhvillimi rural i integruar*

Një nga fushat kryesore të shqetësimeve të përcaktuara në këtë Strategji është shtimi i varfërisë në zonat fshatare dhe mungesa e një politike të integruar për zhvillimin rural. Duhet ndërmarrë veprime për të rritur prodhimin bujqësor dhe marketimin për të pakësuar varfërinë në zonat fshatare. Veç kësaj, nevoja për zhvillimin e infrastrukturës, shtimi i përdorimit të inpueteve bujqësore dhe i mekanizimit, si dhe mundësia për të marrë kredi janë baza për të krijuar kush-

tet e domosdoshme që të shtohet prodhimi bujqësor në Strategjinë e Fierit. Këto janë përparësitë në Qarkun e Fierit, që pasqyrojnë përparësitë kombëtare të paraqitura në Strategjinë Kombëtare të zhvillimit rural dhe në SKZHES.

### *2. Të shtohet zhvillimi i tregtisë dhe i industrisë*

Zgjerimi i mundësive ekonomike nëpërmjet zhvillimit të sektorit të tregtisë e të industrisë, sidomos atij të lidhur me përpunimin e ushqimeve, quhet si përparësi në Strategjinë e Fierit. Fushat kryesore të cilat do të trajtohen nga programet janë: mbështetja për të përmirësuar klimën e biznesit, forcimi i institucioneve të tregut dhe shtimi i aftësive të krahut të punës nëpërmjet kualifikimit profesional, që t'u përgjigjet siç duhet kërkesave.

### *Synimet dhe treguesit*

Pjesa e mëposhtme do të paraqesë synimet për secilin nga dy objektivat, treguesit për matjen e ecjes përpara drejt synimeve dhe programet që do të japin ndihmesë për arritjen e këtyre synimeve.



## TREGUESIT THEMELORE

### Synimi 1.1 dhe 1.2

	Viti	Viti bazë		Njësia	2006	2009	2012	2015	Burimi për pikënisjen
		Vlera	Njësia						
Prodhimi bujqësor	1989	232							
- Perime	2002	101	Kv/ha	140	160	200	230		Departamentet e bujqësisë
- Drithëra	1989	41.6							
	2002	35.7	Përqind	10	16	40	60		Departamentet e bujqësisë
Investime publike ne bujqesi	2002	29200	1000 Lek	33580	38617	44409	51070		Departamentet e bujqësisë, Ndermarrja e kanalizimeve
Përpjesa e tokës nën ujë	2002	15	Përqind	20	35	40	60		Këshilli i Qarkut, Zyra e regjistrimit te tokës / Departamentet e bujqësisë
Numri i shoqerive te kreditit dhe kurtimeve	2003	0	Numër	2	3	3	4		Këshilli i Qarkut
Niveli i mekanizimit (numri i traktorëve)	2003	81	Përqind	85	90	95	100		Departamentet e bujqësisë
Numri i tregjeve te shites me shumicë	2001	1	Numër	2	3	3	4		Këshilli i Qarkut
Numri i pikave te grumbullimit	2002	0	Numër	2	3	4	5		Këshilli i Qarkut

## Objektivi 1: Të nxitet zhvillimi rural i integruar

Synimi 1.1: Rritja e prodhimit bujqësor me 60 % dhe e investimeve me 80% deri më 2015

Synimi 1.2: Rritja e eksporteve bujqësore deri më 2015

Synimi 1.3: Krijimi i industrive për përpunimin e produkteve bujqësore dhe dyfishimi i infrastruktures se tregjeve deri më 2015



## TREGUESIT THEMELORE

### Synimi 2.1

Burimi i pikënisjes

2015

2012

2009

2006

Viti bazë

Njesia

Vlera

Viti

	2002	7	%	10	12	15	20	Zyra e punës ne Qarkun Fier
Punësimi ne sektorin privat								

## Objektivi 2: Rritja e zhvillimit industrial dhe të biznesit

Synimi 2.1: Rritja e punësimit ne sektorin privat me 20% deri më 2015



## TREGUESIT THEMELORE - Synimi 1 dhe 2

Norma totale e papunësisë (%)	2001	17.65	%	15	13	11	9	INSTAT
Numri i njerëzve që marrin ndihmë sociale	2001	88,232	numri i njerëzve	70 000	60 000	50 000	40 000	Drejtoria e përkrahjes sociale Fier
Norma e vdekshmërisë foshnjore	2001	17.4	1000 lindje	16	14	12	10	INSTAT
Rastet me sëmundje diarrejike	2001	1665.5	100 000 banorë	1092	982.8	884.5	796.0	Drejtorite e shendetesise ne Qarkun Fier
Rastet me sëmundje në aparatit e frymëmarrjes	2001	163.4	10000 raste	142.9	114.3	91.4	73.1	Drejtorite e shendetesise ne Qarkun Fier

OM 1: Zhdukja e Varfërisë Ekstreme		Emri i Programit dhe Aktiviteti		Efekti	
Synimet	Problemi	Afati kohor	Aktorët Potencialë		
1.1	Prodhim i ulët bujqësor dhe të ardhurat e pakta në zonat rurale	Afat shkurtër 2006	Këshilli i Qarkut, Departamente të Bujqësisë, Studiues, OJF-te	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mbledhja e të dhënave të mjaftueshme që do të krijojnë një terren më të mirë në hartimin e politikave dhe do të ndihmojnë në hartimin e strategjive me efektive në rritjen e rendimentit bujqësor.</li> </ul>	
	<b>2 Inventari mbi token</b> Përgatitja e një inventari mbi token bujqësore të rrezikuara nga erozioni, ndërtimet pa leje, etj. Për të propozuar e siguruar menaxhimin e qëndrueshëm të tokës	Afat shkurtër 2006	Këshilli i Qarkut, Departamenti i Bujqësisë, Studiues, OJF-te, Grupet e Organizuar në Komunitet	<ul style="list-style-type: none"> <li>Strategji më të mira për manaxhimin dhe monitorimin e tokës së demtuar. Rekomandime për të parandaluar demtimin e meteishëm.</li> <li>Formulimi i programeve rurale të zhvillimit për përmirësimin e infrastruktures bujqësore</li> <li>Rritja e numrit të shoqerive të kreditimit dhe kursimeve.</li> <li>Rritja e prodhimit të përmirësimit të teknologjive moderne dhe numrit të pajisjeve moderne të përdorura në prodhimin bujqësor</li> </ul>	
	<b>3 Studime mbi Infrastrukturen Bujqësore dhe përgatitja e projekteve të veçanta për të ndërtuar ose rindërtuar infrastrukturen rurale</b> Përgatitja e një studimi fizibiliteti për përmirësimin e infrastruktures bujqësore i. Kanalizime ii. Vadiqe iii. Rruge Të përgatiten projekte të veçanta për infrastrukturën bazuar në nrvogat dhe burimet e disponueshme	Afat mesem 2009	Këshilli i Qarkut, Studiues, Departamenti i Bujqësisë, Fermere, OJF-te	<ul style="list-style-type: none"> <li>Rritja e numrit të shoqerive të kreditimit dhe kursimeve.</li> <li>Rritja e prodhimit të përmirësimit të teknologjive moderne dhe numrit të pajisjeve moderne të përdorura në prodhimin bujqësor</li> </ul>	
	<b>4 Programet e Investimeve Publike dhe Kredive</b> Te mbështeten fermeret përmes programeve të kredive dhe investimeve publike që do të ndihmojnë në rritjen e prodhimit bujqësor.	Afat mesem 2009	Këshilli i Qarkut, Departamenti i Bujqësisë, Banka Lokale, Organizata Nderkombëtare, Fermere.	<ul style="list-style-type: none"> <li>Rritja e numrit të shoqerive të kreditimit dhe kursimeve.</li> <li>Rritja e prodhimit të përmirësimit të teknologjive moderne dhe numrit të pajisjeve moderne të përdorura në prodhimin bujqësor</li> </ul>	
	<b>5 Mbështetja e mekanizimit dhe përdorimi i inpueteve bujqësore</b> Zhvillimi i programeve të mbështetjes së fermerëve me pak tokë për të rritur përdorimin e inpueteve bujqësore dhe teknologjise se re si dhe krijimi i politikave shtese të cilat do të rrisin prodhimin bujqësor	Afat mesem 2009	Këshilli i Qarkut, Departamenti i Bujqësisë, Bankat Lokale, Organizatat Nderkombëtare, Fermeret	<ul style="list-style-type: none"> <li>Rritja e numrit të shoqerive të kreditimit dhe kursimeve.</li> <li>Rritja e prodhimit të përmirësimit të teknologjive moderne dhe numrit të pajisjeve moderne të përdorura në prodhimin bujqësor</li> </ul>	
	<b>6 Nxitja e Shoqerive Kursim -Kredi</b> Mbështetje për shoqerite ekzistuese dhe krijimi i shoqerive të reja si Bashkimet e Kursim-Kredive dhe Shoqerite Kredituese (UKK) në rajon.	Afat mesem 2009	Këshilli i Qarkut, Drejtoria e Bujqësisë, Bankat Lokale, Organizatat Nderkombëtare, Fermeret	<ul style="list-style-type: none"> <li>Rritja e numrit të shoqerive të kreditimit dhe kursimeve.</li> <li>Rritja e prodhimit të përmirësimit të teknologjive moderne dhe numrit të pajisjeve moderne të përdorura në prodhimin bujqësor</li> </ul>	





## OM 1: Zhdukja e Varfërisë Ekstreme

Synimet	Problemi	Emri i Programit dhe Aktivitetit	Afati kohor	Aktorët Potencialë	Efekti
1.2	Niveli i ulet i prodhimeve bujqësore të shitura në tregjet e brendeshme lokale dhe jashtë tij.	<p><b>1 ISO</b> Krijimi i nje sistemi për leshimin e certifikatave qe garantojne cilësinë (ISO) qe mundësojne eksportimin e produkteve në vendet e BE-se (marketing + certifikata)</p> <p><b>2 Ngritja e Tregjeve Rajonale Bujqësore</b> Vleresimi për krijimin e tregjeve të mëdha për tregtimin e prodhimeve bujqësore e pikave të grumbullimit në tre rrethet e Qarkut Fier, përgatitja e projekteve</p>	Afat mesem 2009	Këshilli i Qarkut, Departamentet e Bujqësisë, Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, Fermeret, sektori privat	<ul style="list-style-type: none"> <li>Rritja e sasise se prodhimeve bujqësore te eksportuar nga Fieri ne tregun European.</li> <li>Shtimi i infrastrukturës për marketimin e prodhimeve bujqësore</li> </ul>
1.3	Niveli i ulet i përpunimit të produkteve bujqësore	<p><b>1 Studimi i zbatueshmërisë për zhvillimin e industrisë ushqimore</b> Studim fizibiliteti për krijimin e ndermarrjeve agropërpunuese</p> <p><b>2 Industrializimi i prodhimit bujqësor</b> Mbështetje në krijimin e industrive përpunuese: baxho, produkte të serrave dhe produkte me cikël të mbyllur</p>	Afat shkurtër 2006	Këshilli i Qarkut, Departamentet e Bujqësisë,	<ul style="list-style-type: none"> <li>Krijimi i nje industrie agropërpunuese me nje numer ndermarrjesh agropërpunuese.</li> </ul>
		<p><b>3.3 Ngritja e aftësisë të fermerëve</b> Kryerja e nje fushate informimi në të mire e inputeve bujqësore dhe mekanizimit, fermave të bshkuara, apo shoqerive fermere etj.</p>	Afat gjatë 2015	Këshilli i Qarkut, Departamentet e Bujqësisë, Fermeret sektori privat	<ul style="list-style-type: none"> <li>Rritje ne prodhim dhe ne numrin e fermereve.</li> <li>Krijimi i fermave me kapital te madh prodhues</li> </ul>
		<p><b>3.4 Mbështetje e shërbimit të tregut</b> Krijimi e forcimi i zyrave të informacionit mbi tregjet dhe produktete bujqësore</p>	Afat shkurtër 2006	OJQ, organizata ndërkombëtare, Këshilli i Qarkut, Drejtoria e Bujqësisë, Fermeret	<ul style="list-style-type: none"> <li>Krijimi i grupeve të mirëinformuara midis furnitoreve ne Shqipëri qe do të kenë nje ze konkures ne tregjet nderkombëtare.</li> </ul>
		<p>3.5 Anкета me pjesëmarrje e varferise Pergatitja e anketes duke perdorur metodologjine per mbledhjen dhe analizen e te dhenave per nivelin e varferise ne Komunat dhe Bashkite e Qarkut</p>	Afat mesem 2009	Këshilli i Qarkut, Departamentet e Bujqësisë, Fermeret, te tjere që lidhen me sektorin e bujqësisë	<ul style="list-style-type: none"> <li>Kuptim me i mire i varferise ne Qark, adresim me i mire i politikave dhe planeve.</li> </ul>
			Afat shkuter 2006	Bashkite, Komunat, Keshilli i Qarkut, Ministria e Pushtetit Vendor, OJF.	

## OM 1: Zhdukja e Varfërisë Ekstreme

Synimet	Problemi	Emri i Programit dhe Aktiviteti	Afati kohor	Aktorët Potencialë	Efekti
1.4	Zhvillim i ngadalte i industrive dhe bizneseve	<p><b>1 Nxitja e Biznesit të Vogël dhe të Mesëm</b> Riformulimi i politikave fiskale për të nxitur zhvillimin e ndermarrjeve e vogla dhe të mesme (BVM) nëpërmjet nxitësve fiskalë</p> <p><b>2 Programe Profesionale</b> Mbështetje e programeve trajnuese për të rritur aftësitë profesionale në fushat përkatëse</p> <p><b>3. Zhvillimi i Turizmit</b> Përgatitja e nje strategjie për zhvillimin e turizmit</p> <p><b>4. Promovimi i Artizanatit tradicional</b> Dhena e Ndihmes dhe lehtësimit të aksesit në kredite për pune artizanale (mobijje, zbuqurime, qilima, etj)</p> <p><b>5. Tregu</b> Ndertimi i nje tregu për shitjen me shumice dhe organizimi i panairëve vjetore për prodhimet e Fierit</p> <p><b>6. Krijimi i nje Qendre Informacioni</b> Krijimi i nje qendre informacioni që përfshin të dhena mbimarketimin e produkteve industriale për tregjet e jashtme dhe të brendshme.</p> <p><b>7. Ndihme Dhomes se Tregtisë dhe Industrisë (DTI)</b> Forcimi i pozitës së Dhomes se Tregtisë dhe Industrisë (DTI) në rrethet Fier dhe Mallakaster dhe krijimi i nje të tilla në rrethin e Lushnjës</p>	<p>Afat shkurtër 2006</p> <p>Afat mesëm 2009</p> <p>Afat shkurtër 2006</p> <p>Afat mesëm 2009</p> <p>Afat mesëm 2009</p> <p>Afat shkurtër 2006</p> <p>Afat mesëm 2009</p>	<p>Këshilli i Qarkut, Komunitat, Bashkitë, ministririte përkatëse.</p> <p>Ministria e arsimit, Drejtoria arsimore, Zyra Rajonale e Punës në Fier, Këshilli i Qarkut</p> <p>Këshilli i Qarkut, Zyra e Turizmit</p> <p>Organizatrat Nderkombëtare</p> <p>Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, Këshilli i Qarkut</p> <p>Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, Këshilli i Qarkut</p>	<p>• Rritja e punësimit në sektorin privat.</p> <p>• Nxitja e Qarkut Fier si nje vend agroturistik brenda e jashtë Shqipërisë</p> <p>• Krijimi i nje mjdisi të lejueshem për tregëtimin dhe prodhimet industriale</p>

## OM 2: Kryerja universale e arsimit tetëvjeçar

### Objektiv afatgjatë kombëtar - SKZHSE:

- Regjistrimi total (100%) në arsimin bazë,
- 90% ne arsimin e mesëm dhe jo me pak se 13.5 vite shkollare të pritshme

### Problemet e arsimit në Qarkun e Fierit

Në Qarkun e Fierit ka shumë pengesa, me të cilat ballafaqohen nxënësit, të cilët duan të marrin arsim, për shkak të infrastrukturës, cilësisë së mësuesve dhe materialeve mësimore, si the të trysnive ekonomike e shoqërore, që i detyrojnë nxënësit ta lënë shkollën. Meqë arsimit është një e drejtë e gjithë njerëzve dhe jo privilegj për pak veta, Qarku i Fierit është zotuar të përmirësojë standardet dhe praktikatat e arsimit, duke u përpjekur të përmirësojë jetën e qytetarëve të vet. Arsimit nuk mund dhe nuk duhet parë si sektor i pavarur, ndërsa kjo analizë do të tregojë se përmirësimi i arsimit është i lidhur me përmirësimin sinonim në sektorët e tjerë, si transporti, mjedisi dhe ekonomia.

### Infrastruktura

Shkollat, ngrehinat sportive e kulturore që përdoren në Fier nuk janë aspak të përshtatshme dhe praktikisht të gjitha kanë nevojë ose të rehabilitohen, ose të rindërtohen tërësisht. Mungojnë pajisjet kundër zjarrit, nuk ka izolim të përshtatshëm për motin e keq, nuk ka mundësi për njerëzit me gjymtime, ndërsa mungojnë në të gjithë sistemin shkollor mjediset e veçanta për punët e dorës, mësimin me mjetet e multimedive etj. Megjithatë duhet vënë në dukje se rindërtimi i shkollave në lokalet që kanë sot nuk do të sillte shtimin e frekuentimit dhe përmirësimin e mësimdhënies. Shkollat e mesme shpesh ndodhen larg nga zonat fshatare dhe kështu transporti bëhet shumë i vështirë, duke dalë si pengesë për nxënësit nga fshati. Është e nevojshme gjithashtu të përmirësohen rrugët për ta lehtësuar udhëtimin e nxënësve për në shkollë e për t'u larguar që andej. Normat dhe rregullat kombëtare për rindërtimin e shkollave gjithashtu duhen

përcaktuar, që të sigurojnë garantimin e një standardi për mbarë vendin lidhur me mjediset shkollare. Së fundi, duhet ndërmarrë një vëzhgim tërësor për vendbanimet e nxënësve, në mënyrë që të sigurohet se ndërtimet e reja (ose të vjetrat që rehabilitohen) do të ndodhen në zona, ku ka kërkesa të mëdha.

### Cilësia e arsimit

“Cilësia e arsimit” përfshin aftësitë dhe përbërjen gjinore të nxënësve, numrin e nxënësve për një mësues, numrin e nxënësve për një klasë dhe programin e lëndëve. Në Qarkun e Fierit mund të thuhet me arsye se mësuesit nuk zotërojnë aftësitë e sotme me peshë dhe nuk njohin metodat e reja pedagogjike. Pagat e përfitimet e ulëta e bëjnë tejet të vështirë të merren mësues të rinj dhe të mbahen ata me përvojë. Mësuesit vuajnë nga të njëjtat vështirësi si nxënësit lidhur me vendndodhjen e shkollave. Siç e tregojnë të dhënat në këtë pjesë, ka një rënie të ndjeshme të numrit të mësuesve në shkollat e mesme (pjesa më e madhe e të cilave janë në zonat urbane). Kostoja e jetesës në qytet është më e lartë dhe bëhet pengesë që mësuesit të banojnë atje. Po ashtu vështirësitë e transportit nga zonat fshatare në qytetet i pengojnë shumë mësues që jetojnë në fshat që të japin mësim në shkollat e mesme. Është shumë e thjeshtë të thuhet se ka më pak mësues të shkollave të mesme, sepse ka më pak nxënës të shkollave të mesme dhe anasjelltas; që të dy grupet preken nga po ata faktorë dhe uljet numri i të dy palëve si pasojë e faktorëve të njëjtë (si faktorët ekonomikë, transporti etj.).

Qarku i Fierit ka një numër të mjaftë mësuesish për nxënës. Siç vihet në dukje në pjesën e kontekstit për arsimin, mesatarja është 21,4 nxënës për një mësues në Qark, ndërsa ka 24,1 nxënës për një klasë në arsimin e mesëm. Këto shifra janë të pranueshme si mesatare e Qarkut për të siguruar ndërveprimin e mjaftueshëm nxënës-mësues, megjithatë ka zona (si Mallakastra me mesataren 33,04 nxënës për një mësues), ku duhen bërë përmirësime. Nuk ka të dhëna të besueshme lidhur me baraspeshimin e gjinive ndër mësuesit. Përbërja gjinore e personelit mësimor prek shumë cilësinë e arsimit për nxënësit dhe prandaj duhen bërë të gjitha përpjekjet që së pari të grumbullohen gjithë të dhënat e sakta për gjendjen e sotme e pastaj të hartohen politikat e programet për ta përnirësuar balancën e gjinive, ndërsa po të jetë aritur, të mbahet si është.

Programet e lëndëve janë rishikuar dhe përditësuar gjatë dhjetëvjeçarit të kaluar të tranzicionit. Problemi sot është të botohen tekstat dhe të bëhet shpërndarja e gjerë, që të bien në duart e nxënësve.

## Trysni të shoqërore e ekonomike

Siç është treguar nga të dhënat e mësipërme të kësaj pjese, ka një rënie të fortë midis numrit të nxënësve që ndjekin arsimin bazë kundrejt numrit në shkollat e mesme. Vetëm 37% e të rinjve të moshës 14-17 vjeç ndjekin shkollën e mesme. Siç është përmendur më parë, arsimi nuk është një sektor që “qëndron më vete”, përmirësimet në arsim do të ndodhin vetëm me përmirësimet e njëkohshme në sektorët e tjerë. Të rinjtë i braktisin shkollat e mesme për një varg arsyesh, disa të lidhura me trysni të shoqërore dhe të tjerat me faktorët ekonomikë. Për shembull, vajzave mund t’u ndalohet ose mund të shkurohen për të ndjekur shkollën e mesme për shkak të shqetësimit të prindërve ose të perceptimit të rolit të tyre në familje dhe në bashkësi. Përveç kësaj vjen edhe largësia, që shumica e vajzave duhet të përshkujnë për të ndjekur shkollën nga zonat fshatare dhe kjo është një shkak tjetër për t’i shkurojuar që të vijojnë arsimin. Djemtë e lënë shkollën e mesme sepse kërkojnë mundësi ekonomike gjatë, zakonisht duke punuar në fushë. Prandaj përmirësimi i arsimit do të ndodhë vetëm me përmirësimin e programeve që mbështesin barazinë e gjinive dhe rigjallërimin ekonomik të zonave rurale e urbane, duke u dhënë mundësi familjeve të kenë të ardhura të mjaftueshme për veten e për të qenë në gjendje të përballojnë ndjekjen e shkollës nga fëmijët e tyre.

## Objektivat

### Objektivi 3: Përmirësimi i cilësisë së infrastrukturës shkollore

Siç u paraqit në pjesën e mësipërme, infrastruktura e papërshtatshme në qarkun e Fierit është një problem kryesor dhe ka ndikim në motivimin e mësuesve e të nxënësve. Shkollat kanë godina të degraduara për shkak të mungesës së mirëmbajtjes, mungesës së xhamave në dritare, orendive, sistemit të ngrohjes, që përbëjnë vetëm disa shembuj. Veç kësaj, në qark ka pak shkolla të pajisura me të gjitha mjediset për çlodhje, veprimtari sportive e laboratore, duke e kufizuar mundësinë e mësuesve për t’i përfshirë nxënësit në veprimtari jashtëshkollore. Është e nevojshme të rivlerësohet

hapësira e këtyre shkollave për t’u dhënë mundësi mësuesve dhe punonjësve socialë që t’i përdorin këto veprimtari si plotësim për arsimin zyrtar. Pushteti vendor duhet ta mbështesë hartimin dhe zbatimin e planeve për investime të tilla.

### Objektivi 4: përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies

Cilësia e mësimdhënies shihet si në gjendje kritike në qarkun e Fierit. Për ta trajtuar këtë problem programet kanë përcaktuar si pikë qendrore përmirësimin e teksteve shkollore, që t’u përgjigjen më mirë nevojave të nxënësve e të mësuesve. Një fushë tjetër me rëndësi është shtimi i numrit të mësuesve të kualifikuar, të cilët duhet të bëjnë rregullisht kurse për metodat e reja të mësimdhënies. Nevojitet një qëndrim i bashkërenduar për të përballuar këto çështje, të cilat kërkojnë përpjekje nga ana e pushtetit qendror, rajonal e vendor, për të punuar së bashku me institucionet e tjera përkatëse dhe me bashkësinë.

### Objektivi 5: të rritet frekuentimi i shkollës

Ngritja e nivelit të ndjekjes së shkollës në qarkun e Fierit, sidomos në shkollat e mesme të zonave fshatare, dhe përgjysmimi i normës së analafabetizmit janë synime të rëndësishme për qarkun e Fierit me qëllim që të sigurohet zhvillimi i ardhshëm në qark. Strategjia për ta arritur këtë objektiv përqendrohet te fuqizimi i lidhjes ndërmjet bashkësisë e shkollave, shtimi i pjesëmarrjes së punonjësve socialë, mbështetja e familjeve të varfra dhe ngritja e ndërgjegjësimit të bashkësive rurale për ndjekjen e shkollës. Gjitashtu ka nevojë të shtohet mbështetja për arsimin “jozyrtar” nëpërmjet veprimtarive kulturore e çlodhëse, me qëllim që të mbushen zbrazëtitë e sistemit arsimor zyrtar.

### Synimet dhe treguesit





### TREGUESIT Synimi 3.1

Viti	Vlera	Viti Bazë Njësia	2006	2009	2012	2015	Burimi i pikënisjes
------	-------	---------------------	------	------	------	------	---------------------

Numri i shkollave të rikonstruara dhe të rinovuara	7	Përqindje	20	50	75	100	Drejtoria e Arsimit Qarku Fier, Instat
--	---	-----------	----	----	----	-----	--

### Objektivi 3: Përmirësimi i cilësisë së infrastrukturës shkollore

Synimi 3.1: Rikonstruktimi 100 % i ndërtesave të shkollave në të tre rrethet



### TREGUESIT Synimi 4.1 & 4.2

Viti	Vlera	Viti Bazë Njësia	2006	2009	2012	2015	Burimi i pikënisjes
------	-------	---------------------	------	------	------	------	---------------------

Mesuesit e arsimit të mesëm që zotërojnë një kualifikim special	81	Përqindje	85	90	95	100	Drejtoria e Arsimit Qarku Fier
Raporti nxenes/mesues në arsimin e mesëm	21,4	Raporti nxënës/ mësues	-	-	-	30	MASH, Drejtoria e Arsimit Qarku Fier
Madhesia e klasave në arsimin tërëvjeçar	35,9	Raporti nxënës/ mësues	34	30	30	30	

### Objektivi 4: Përmirësimi i cilësisë në arsim

Synimi 4.1: Rritja me 20% e numrit të mesuesve të kualifikuar, në arsimin e mesëm

Synimi 4.2: Ulja e raportit nxenes për klasë në shkollat tërëvjeçare me një maksimum deri 30 nxenes për klasë, deri në 2009



## TREGUESIT

### Synimi 5.1 & 5.2

	Viti	Viti Bazë Vlera	Njesia	2006	2009	2012	2015	Burimi
Norma e analfabetizmit	2001	0.94	Raporti analfabet/ totali	0.9	0.6	0.5	0.5	Instat
Frekuentimi i shkollave ne arsimin e mesem ne zonat rurale (15-19 vjec)	2001	36.67	%	50	70	80	95	Drejtoria e Arsimit Qarku Fier

## Objektivi 5: Rritja e frekuentimit të shkollës

Synimi 5.1: përgjysmimi i përqindjes se analfabetizmit deri ne 2015

Synimi 5.2: 95% frekuentim i shkollave ne arsimin e mesem deri ne 2015 (Synim i SKZHES e OM-)



## OM 2: Kryerja e Arsimit Universal Fillor dhe Përmirësimi i Kushteve të Arsimit

Synimet	Problemi	Emri i Programit dhe Aktiviteti	Afati kohor	Aktorët	Efekti
3.1	Infrastruktura e dobët në shkollat mungesa e mjediseve për sport e çlodhje	<b>1 Vlerësimi i shkollave</b> Studim vlerësues në hollësi mbi cilësinë e infrastruktures e pajisjet në shkollat dhe përgatitja e planeve të veprimit	Afat shkurtër 2006	Drejtoria e Arsimit Fier, Këshilli i Qarkut, Organizatat Nderkombëtare, OJF-te, Bashkësia (Grupet e Organizuara në Komunitet)	" Pletesimi 100% deri në 2015 e numrit të shkollave të rikonstruara dhe të ndertuara
		<b>2 Përgatitja e planit të Rikonstruksionit</b> Përgatitja e një plani të detajuar për Rikonstruksionin e shkollave	Afat gjatë 2015	Drejtoria e Arsimit Fier, Këshilli i Qarkut, Organizatat Nderkombëtare, OJF-te, Bashkësia (Grupet e Organizuara në Komunitet)	" Pajisja e nxenësve me të gjithë mundësitë për t'u shquar në shkollat dhe motivimi i tyre për të vazhduar studimet
		<b>3 Pajisja me mjete logjistike</b> Pajisja e shkollave me mjete të përshtatshme (bibloteka, kompjuterë, sistem ngrohje etj..)	Afat gjatë 2015	Drejtoria e Arsimit Fier, Këshilli i Qarkut, Organizatat Nderkombëtare, OJF-te, Bashkësia (Grupet e Organizuara në Komunitet)	
		<b>4 Sistemi Informues</b> Mbështetje në krijimin e një sistemi informues mbi mobilizimin e burimeve dhe menaxhimin e fondeve në Drejtorinë rajonale të Arsimit	Afat mesëm 2009	Drejtoria e Arsimit Fier, Këshilli i Qarkut, OJF-te, Bashkësia (Grupet e Organizuara në Komunitet)	

## OM 2: Kryerja e Arsimit Universal Fillor dhe Përmirësimi i Kushteve të Arsimit

Synimet	Problemi	Emri i Programit dhe Aktiviteti	Afati kohor	Aktorët	Efektii
4.1 dhe 4.2	Cilësi e dobët në mesimdhënie - Mungese e standarteve mesimore në të gjitha shkollat përm kualifikimin dhe trajnimin e mesueseve	<p><b>1 Trajnim i mesueseve</b> Organizimi i programeve të rregullta trajnuese për të rritur kapacitetin e mesueseve dhe drejtuesve të shkollave dhe ndihma për të hartuar standarde</p> <p><b>2 Pagat</b> Rishikimi i politikave të pagave me qëllim tërheqjen e me shumë mesueseve të kualifikuar</p>	Afat shkurtër 2009	Drejtoria e Arsimit Fier, Këshilli i Qarkut, OJF-te, Bashkësia (Grupet e Organizuara në Komunitet), Mesuesit	" Rritja e numrit të mesueseve të kualifikuar në të gjitha nivelet e mesimdhënieve.  " Uljen e nivelit të korrupsionit brenda sistemit arsimor.
		<p><b>3. Textet Shkollore</b> Përmirësimi i teksteve shkollore në përmbajtje dhe cilësi në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës</p>	Afat gjatë 2015	Drejtoria e Arsimit Fier, Këshilli i Qarkut, OJF-te, Bashkësia (Grupet e Organizuara në Komunitet), Mesuesit	
		<p><b>4 Kontributi i Prinderve</b> Nxitja e programeve për rritjen e kontributit të prindërve në shkolla (mbështetje financiare dhe shoqerore)</p>	Afat mesëm 2009	Drejtoria e Arsimit Fier, Këshilli i Qarkut, OJF-te, Bashkësia (Grupet e Organizuara në Komunitet), Mesuesit, Prinderit	" Rritja e përfshirjes së prindërve në edukimin e fëmijëve të tyre, me qëllim rritjen e inkurajimit nga ana e tyre për të mesuar dhe vazhduar shkollën.
		<p><b>5. Përfshirje aktive e nxenesve</b> Nxitja e pjesëmarrjes aktive së nxënësveve në bordet e shkolles dhe qeverinë e nxenesve</p>	Afat mesëm 2009	Drejtoria e Arsimit Fier, Këshilli i Qarkut, OJF-te, Bashkësia (Grupet e Nxenesit	" Kapërcimin e pengesave nga mesuesit e kualifikuar dhe nxitjen e tyre për të vazhduar punën edhe në zonat e thella të qarkut Fier
		<p><b>6. Transporti i Mesueseve</b> Krijimi i nje sistemi transporti për mesuesit e kualifikuar për ne shkollat në fshatrat e thella të rajonit</p>	Afat shkurtër 2006	Drejtoria e Arsimit Fier, Këshilli i Qarkut, OJF-te, Bashkësia (Grupet e Organizuara në Komunitet), Mesuesit	
		<p><b>7. Mesimdhënia në komunitet</b> Mbështetja e shkollave ekzistuese për organizimin e kurseve trajnuese ose me një temë të përcaktuar interesi nga anetare të tjerë të bashkësisë (shkëmbim njohurish)</p>	Afat mesëm 2009	Drejtoria e Arsimit Fier, Këshilli i Qarkut, OJF-te, Bashkësia (Grupet e Organizuara në Komunitet), Mesuesit	





## OM 2: Kryerja e Arsimit Universal Fillor dhe Përmirësimi i Kushteve të Arsimit

Synimet	Problemi	Emri i Programit dhe Aktiviteti	Afati kohor	Aktorët	Efektet
5.1 dhe 5.2	Frekuentimi i ulët në arsimin bazë dhe të mesëm	<b>1 Shkolle- Familje</b> Mbështetja e një programi për rritjaen e bashkepunimit shkollë-familje me qëllim përmirësimin e frekuentimit në shkollë me veprimtari arsimore jozyrtare	Afat gjatë 2015	Drejtoria e Arsimit Fier, Këshilli i Qarkut, Organizatat Nderkombëtare, OJF-te, Bashkësia (Grupet e Organizuara ne Komunitet) , Mesuesit Familjet	" Ulja e shkallës se analfabetizmit  " Rritja e frekuentimit te arsimiit bazë ne 100% deri ne 2015
		<b>2 Sporte, Muzike, etj..</b> Mbështetja e rishikimit te programave shkollore për rritjen e aktiviteteve kulturore dhe sportive ne shkolla	Afat gjatë 2015	Drejtoria e Arsimit Fier, Këshilli i Qarkut, Organizatat Nderkombëtare, OJF-te, Bashkësia (Grupet e Organizuara ne Komunitet) , Mesuesit, nxënësit	" Rritja e frekuentimit te arsimiit te mesem ne 95% deri ne 2015
		<b>3 Media dhe Arsimi</b> Përfshirja e medias ne informimin e publikut rreth përpjekjeve te reja mbi arsimin dhe debate te hapura mbi problemet qe po përballen shkollat.	Afat shkurter 2006	Drejtoria e Arsimit Fier, Këshilli i Qarkut, Media, Mesuesit, nxënësit	" Rritja e përfshirjes se prinderve ne programin shkollor.
		<b>4 Ndihtma ndaj familjeve te varfra</b> Bashkepunim me Ministrine e Arsimit për te forcuar legjislacionin mbi arsimin ne mbështetje te familjeve te varfëra përmes fushatave ndërgjegjesuese	Afat mesem 2009	Drejtoria e Arsimit Fier, Këshilli i Qarkut, Organizatat Nderkombëtare, OJF-te, Bashkësia (Grupet e Organizuara ne Komunitet) , Mesuesit Familjet	
		<b>5 Aktivitete te tjera</b> Rritja e investimeve ne mbështetje te arsimit jashtëshkollor, aktivitete jashtëshkollore, pune vullnetare, konferenca për te rinj, seminare, aktivitete vullnetare	Afat mesem 2009	Drejtoria e Arsimit Fier, Këshilli i Qarkut, Organizatat Nderkombëtare, OJF-te, Bashkësia (Grupet e Organizuara ne Komunitet) , Mesuesit, nxënësit	
		<b>6 Studime mbi Punen e Femijeve</b> Fillimi i nje studimi mbi shfrytezimin e punës se femijeve ne Qarkun Fier	Afat shkurte 2006	Drejtoria e Arsimit Fier, Këshilli i Qarkut, Organizatat Nderkombëtare, OJF-te, Bashkësia (Grupet e Organizuara ne Komunitet) , Mesuesit, nxënësit.	
		<b>7.Punonjesis Socialë</b> Rritja e pjesëmarrjes se punonjeseve sociale ne shkolla dhe aktivitete te tjera jashtëshkollore duke i përfshirë në programet shkollore	Afat mesem 2009	Drejtoria e Arsimit Fier, Këshilli i Qarkut, OJF-te, Bashkësia (Grupet e Organizuara ne Komunitet) , Mesuesit, Studentet	
		<b>8 Mbështetje Financiare për nxënësit e minoriteteve</b> Bursa dhe programë të tjera mbështetëse për nxënësit romë	Afat mesem 2009	Drejtoria e Arsimit Fier, Këshilli i Qarkut, MASH, OJF-te, Bashkësia (Grupet e Organizuara ne Komunitet) , Mesuesit, Minoritetet	" Rritja e numrit te nxënësve te minoriteteve qe ndjekin shkollat dhe universitet dhe diplomohen

## OM 3: Nxitja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave

### Objektivat në kuadër kombëtar – Platforma e veprimeve për përmirësimin e statusit të grave në Shqipëri

- “Rritja e përgjegjesive gjinore ne organizmat shteterore dhe komitetet, ne sistemin gjyqesor dhe në të gjitha zyrat e administrates publike.”
- “Mbrotjtja e te drejtave te grave qe janë te përfshira ne aktivitet sociale, publike dhe politike dhe e drejta e organizimit te lire. Veçanërisht vemendje do t’u kushtohet në këtë drejtim grave rurale.”
- “Nxitja dhe mbrotjtja e te drejtave te grave përmes zbatimit te gjithë instrumenteve te te drejtave të njeriut veçanërisht te Konventes mbi Zhdukjen e te gjitha Formave te diskriminimit ndaj Gruas”
- “Gjenerimi dhe shpërndarja e të dhënave dhe informacionit për planifikim dhe vleresim”
- “Mundësia për gratë të drejtohen në institucionet e kredive. Nxitja e te drejtave ekonomike te grave dhe e pavaresise, duke përfshirë dhe mundësitë e punësimit e krijimin e kushteve të përshtatshme të punës dhe kontrollimin e burimeve te tjera ekonomike.”

### Problemet e gjinive në Qarkun e Fierit

#### Shqetësimet për të dhënat

Të dhënat e zërthyera gjinore përbëjnë problemin më të rëndë lidhur me analizën e të dhënave në qarkun e Fierit. Statistikat mbledhen në nivelin e komunave, bashkive, rretheve dhe Qarkut, por shumë rrallë janë të zërthyera mbi bazën e shqetësimeve për anën gjinore; kjo nuk është një çështje e veçantë për qarkun e Fierit, por shfaqet në shkallë kombëtare. Shumë nga të dhënat e zërthyera gjinore lidhen me të dhënat bazë demografike të rajonit dhe vështirë të shërbejnë si bazë e shëndoshë informacioni, mbi të cilën të përpunohen programe të frytshme dhe efektive. Mungesa e informacionit të zërthyer është një nga shtrëngesat kryesore për zhvillimin e mëtejshëm të Qarkut; ndryshimet në ekonomi, bujësi, sektorin social dhe gjendja e varfërisë i prekin burrat e gratë në mënyra të ndryshme, prandaj nevojiten programe të posaçme për të trajtuar nevojat e ndryshme. Që të kapërcehet kjo pengesë e madhe për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm me

aftësi për t’iu përgjigjur anëve gjinore ka rëndësi të shqyrtohet një varg programesh me ndjeshmëri gjinore të përfshira në Strategjinë e zhvillimit rajonal. Ka nevojë për një qëndrim tërësor, që nis me grumbullimin e të dhënave me orientim gjinor dhe pasohet me analizën që përcakton ndikimin e politikave e të programeve për gratë e burrat dhe sesi mund të trajtohen shtrëngesat e ndryshme. Meqë të dhënat janë baza mbi të cilën mund të hartohen analizat e programet, grumbullimi i të dhënave të zërthyera gjinore është një përparësi për Fierin.

#### Gratë dhe papunësia

Papunësia është një nga problemet më të mëdha në Fier, që ka pasoja të rënda nga ana gjinore. Ashtu si në shumë sektorë, papunësia për gratë karakterizohet nga mungesa e shanseve të barabarta. Ndërsa gratë përbëjnë një pjesë të madhe të të punësuarve (74,7% të të punësuarve në Qark janë gra), shumica dërrmuese e këtyre vendeve të punës janë me drejtim bujqësor dhe japin të ardhura të vogla. Gratë zënë fare pak poste drejtuese jashtë sektorit bujqësor. Burrat kanë prirje të gjejnë shanse më të mira punësimi. Gjatë dhjetë vjetëve të kaluara gratë kanë qenë të parat që kanë humbur vendet e punës, kur industritë dhe kompanitë bënë ristrukturimin. Me mbylljen e fabrikave, sektori i shërbimeve (si bizneset e bar/restoranteve dhe tregtia) përbënin një nga mundësitë e pakta për punësim, sidomos në zonat urbane. Mirëpo traditat dhe perceptimet shpesh nuk i lejojnë gratë që të punësohen në këta sektorë, shpesh të lidhur me punonjës ndihmës, që kanë paga më të ulëta dhe më pak mundësi për të ardhura shtesë. Në tregti gratë mund të merren vetëm me tregti të vogël në rrugë, ndërsa e gjithë veprimtaria serioze tregtare, e cila kërkon bisedime e marketim, bëhet prej burrave. Për më tepër, kujdesi për familjen ka qenë tradicionalisht fusha e grave. Keqësimi i shërbimeve të infrastrukturës sociale, si kopshtet e fëmijëve, ka bërë që gratë me fëmijë të vegjël të rrinë në shtëpi dhe janë më pak konkurruese në tregun e punës.

#### Gratë në zonat fshatare e në pronësinë e tokës

Gjendja e punësimit të grave në zonat fshatare kufizohet kryesisht me punët bujqësore. Traditat patriarkale ende mbeten të forta në zonat fshatare dhe burrat mbahen si krerët e familjeve, duke u dhënë të drejtën

e pronësisë mbi tokën krerëve meshkuj të shtëpisë. Njëkohësisht kontributi ekonomik i grave për ekonominë e përgjithshme shtëpiake nuk merret parasysh e nganjëherë edhe shpërfillet. Çështja e pronësisë ka ndërlikime serioze për të drejtën e pjesëtareve gra të ekonomisë shtëpiake për të marrë pjesë në marrjen e vendimeve në familje. Edhe më e rëndësishme është që mungesa e pronësisë e kufizon pavarësinë ekonomike të grave fshatare, shpesh i pengon që të marrin kredi dhe i ngushton shanset e tyre për anëtarësim në kooperativa e në biznese të tjera.

## Arsimimi

Shkalla e shkollimit për gratë është pak më e lartë sesa mesatarja kombëtare. Lidhur me shkollën bazë, ka një përpjesëtim relativisht të barabartë të ndjekjes nga ana e vajzave dhe djemve. Kjo normë ndryshon ndjeshëm kur shqyrtohen të dhënat për nivelin e shkollës së mesme. Në shkallë qarku, ka 6.153 vajza që i ndjekin krahasuar me 5.413 djem. Dallimi më i madh ndërmjet dy gjinive bëhet i dukshëm në rrethin e Lushnjes me mbizotërim rural, ku 2.446 vajza e ndjekin shkollën kundrejt 1.291 djemve. Diferenca e madhe në ndjekjen e shkollës së mesme ndërmjet dy gjinive vjen prej trysnive dhe mundësive që u paraqiten djemve për t'u përfshirë në biznesin e familjes ose në tregun e punës, si dhe për të emigruar për punë stinore. Nga një pikëvështrim tjetër, niveli i ulur i ndjekjes nga djemtë mund të ketë kuptim nga rolet tradicionale që u caktohen burrave e grave. Rrethi i Lushnjes jep shembull të qartë për këtë prirje, sepse atje djemtë largohen nga zonat rurale për të gjetur veprimtari të tjera ekonomike, ndërsa gratë mbeten dhe përfundimisht punojnë në qendrat bujqësore.

Ajo që bie më tepër në sy është se, me gjithë ndjekjen përgjithësisht më të madhe nga vajzat të shkollave të mesme, ka një rënie shqetësuese në numrin e përgjithshëm më krahasim me ato që ndjekin arsimin bazë. Më 2002-2003 pati 15.374 vajza që ndoqën shkollën tetëvjeçare; kjo shifër bie në 2.991 që ndjekin shkollën e mesme, me një pakësim të përgjithshëm prej 80%. Një rënie e ngjashme duket në ndjekjen e djemve ndërmjet dy niveleve të shkollave. Një numër faktorësh mund ta shpjegojë këtë, ndër ta largësia e madhe nga vendbanimi i vajzave deri në ndërtesat e shkollave të mesme, mungesa e sigurisë vetjake për gratë, mungesa e transportit publik ose e rrugëve të makinave, apo qëndrimet tradicionale, të cilat e ndalojnë gruan të

vazhdojë më tej arsimin. Duhet theksuar se arsytet për mungesat e ndjekjes nga vajzat janë të ndryshme nga të djemve. Grave u mohohen shanset për shkak të një vargu faktorësh shoqërorë e të tjerë, që bëjnë të largohen kundër dëshirës dhe të punojnë kryesisht në veprimtari të bujqësore, ndërsa djemtë largohen kryesisht me dëshirën e tyre (ndonëse është e qartë se trysnia nga familjet për të fituar mund të luajë një rol këtu) dhe e lënë shkollën për të gjurmuar rastet ekonomike, të cilat i gjejnë jashtë rrethit, rajonit të tyre e Shqipërisë.

Një aspekt i shkollimit që duhet shqyrtuar është dhe roli i grave mësuese në sistemin shkollor. Sot nuk ka të dhëna të mjaftueshme mbi bazën e të cilave të bëhej analiza.

## Gratë në poste drejtuese

Norma e pjesëmarrjes së grave në procesin e qeverisjes dhe në institucionet është mjaft e ulët në Fier. Përsëri, mungesa e të dhënave nuk jep mundësi për të bërë analiza të sakta. Megjithatë, kur shqyrtohen prirjet në shkallë vendi, del e qartë se gratë nuk janë pjesëmarrëse aktive në proceset e qeverisjes dhe në institucionet. Në nivel kombëtar, gratë përbëjnë vetëm 5,7% të parlamentit, 10,5% të ministrive dhe 4,3% të zëvendësministrave. Asnjë nga këto gra nuk është kryetaree një komisioni parlamentar. Niveli i ulët i pjesëmarrjes në shkallë vendi pasqyrohet në të dhënat për nivelin e qarkut. 2,7% e kryetarëve të Këshillave të komunave janë gra, si dhe 16,6 të kryetarëve të bashkive e 16,6% të kryetarëve të Këshillave bashkiakë. Niveli i ulët i pjesëmarrjes mund të lidhet me disa faktorë, ndër to trysnia sociale kundër grave, që hyjnë në ato që zakonisht quhen fushë e burrave dhe ligji zgjedhor kërkon që të gjithë kandidatët duhet të kenë nivelin arsimor universitar (gjë që është e paarrtshme për shumë gra për shkak të çështjeve që janë parashtruar në pjesën e mësipërme).

Politikat gjinore si për partitë politike, edhe për strukturat e shërbimeve civile kanë nevojë të përshtaten dhe të mbështeten nga drejtuesit kryesorë që të mbështesin veprimtari të përkatëse gjinore për t'u zbatuar nga personeli teknik e administrativ. Angazhimi i drejtuesve të nivelit të lartë e të mesëm në nivelin e krerëve të partive, drejtorët e departamenteve, kryetarët e njësisve, është me rëndësi kyç për të siguruar përfshirjen e perspektivave gjinore në të gjitha aspektet e

platformave të partive, në planifikimin e programeve rajonale, zbatimin, mbikëqyrjen dhe financimin. Përgjegjësitë për Pikat qendrore gjinore në nivelin e pushtetit rajonal e qendror janë përfshirë më 2000, pas miratimit të Planit Kombëtar të veprimit për përpunimin e grave. Mungesa e njohurive dhe e specialistëve pengojnë që pikat qendrore gjinore të përmendura të plotësojnë gjithë përgjegjësitë e tyre. Në shumicën e rasteve përgjegjësitë e lidhura me gjinitë i caktohen një posti që ekziston dhe shihen si “detyrë plotësuese” e jo si një pjesë integrale për të gjitha detyrat e personelit.

## Objektivat

*Objektivi 6: Zhdukja e dhunës mi bazë gjinore në të gjitha format, duke përfshirë dhunën falimjare, pabarazinë gjinore në punë dhe trafikimin e grave*

Aktorët dhe qytetarët në Fier e kanë përcaktuar dhunën kundër grave si një çështje kyç për barazinë gjinore. Strategjia përqendrohet te trajtimi i kësaj çështjeje nëpërmjet përmirësimit të shanseve ekonomike dhe nivelit të arsimit të grave, dy fushat kryesore për të zvogëluar ekspozimin e grave ndaj disa tipave të dhunës. Strategjia gjithashtu përqendrohet te krijimi dhe mundësimi i mjediist për gratë që të rrisin ndërgjegjësimin e tyre për çështjet e barazisë gjinore duke marrë këshillimin e nevojshëm në qendra të specializuara. Duhet marrë gjithashtu masa për të përmirësuar kuadrin ligjor e institucional që të sigurohet dhënia e mbështetjes nga institucionet lokale.

*Objektivi 7: Të ngrihet ndërgjegjësimi i publikut të gjerë për çështjet e barazisë së gjinive në familje dhe në shoqëri*

Shtimi i ndërgjegjësimit dhe i mirëkuptimit të burrave e grave për çështjet e lidhura me barazinë e gjinive përbën një përparësi në këtë Strategji. Disa probleme, si trysnia shoqërore që i pengon vajzat të ndjekin shkollën, janë pasojë e të kuptuarit të ngushtë të rolit të grave në shoqëri dhe një traditë e gjatë e lidhjes së grave kryesisht me punët shtëpiake. Për më tepër, është me rëndësi themelore nevoja për të pasur të dhëna të zërthyera për ekonomitë shtëpiake që të kuptohet më mirë pozita e gruas dhe për të përcaktuar çështje të tilla, si mundësia për të pasur vlera, informacion e shërbime.

## Objektivi 8: shtimi i pjesëmarrjes së grave në procesin e vendimmarrjes

Kuptohet që gratë ende luajnë rol dytësor në marrjen e vendimeve në shkallë vendi e në qark. Ka nevojë që të rritet roli drejtues i grave. Veprimtari që propozohen në këtë Strategji janë ngritja e aftësive të grave nëpërmjet trajnimit të fokusuar, sigurimi i shanseve të barabarta që u jepen burrave e grave nëpërmjet politikave dhe procedurave të përshtatshme.

## Synimet dhe treguesit





## TREGUESIT

### Synimi 6.1 - 6.5

Burimi

2015

2012

2009

2006

Viti Bazë  
Vlera

Njësia

Viti

Raporti femra/Meshkuj te arsimuar ne %	2001	0.85	ratio	0.9	0.9	0.9	1	INSTAT Zyra Rajonale
--	------	------	-------	-----	-----	-----	---	----------------------

## Objektivi 6: Zhdukja e dhunës mbi bazë gjinore në të gjitha format, duke përfshirë edhe dhunen ne familje, pabarazine gjinore ne pune dhe trafikimin e grave

Synimi 6.1: Rritja e mundësive ekonomike për gratë

Synimi 6.2: Ulja e numrit te rasteve te dhunesmbi bazë gjinore me 50 % deri ne 2015.

Synimi 6.3: Krijimi i institucioneve për t'iu përgjigjur rasteve emergjente te dhunes dhe trafikimit në nivel rajonal dhe bashkie.

Synimi 6.4: Informimi i vazhdueshem i publikut rreth ndihmes qe mund te jepet ne qendrat e grave dhe brenda ne polici, çdo muaj përmes medias lokale .

Synimi 6.5: Ngritja e përpjesëtimit burra-gra te arsimuara ne 1 deri ne 2015, dhe rritja e numrit te shkollave

### treguesit plotësues

- % e grave ne tregun e punës ne zonat rurale
- % e rasteve te raportuara mbi trafikimin dhe dhunen ndaj grave
- Numri i qendrave te grave te specializuara për t'iu përgjigjur rasteve te dhunes
- Numri i policeve që kanë marre nje trajnim sesi mund te veprojne me rastet e dhunes
- Numri i rasteve te raportuara dhe që kanë marre nje trajtim te specializuar ne qendrat e grave dhe zyrrat policore



## Objektivi 7: Nxitja dhe ndërgjegjjesimi i publikut te gjere mbi çështjet e barazisë gjinore ne shoqeri dhe ne familje

Synimi 7.1: Futja e statistikave te zbrërhyera gjinore me të dhenat ne familje.

Synimi 7.2: Rritja e numrit te historive te raportuara nga media mbi barazine gjinore

Synimi 7.3: Futja e konceptit te barazisë gjinore ne programet mesimore të shkollave të larta

### treguesit plotësues

- Bazë të dhënash që përmban te dhena të zbrërhyera gjinore në nivel lokal dhe rajonal
- Numri i programeve/publikimeve te medias ku janë trajtuar çështjet gjinore
- Numri i oreve ne shkollat e larta ku është trajtuar koncepti gjinor



## TREGUESIT

### Synimi 8.1 - 8.3

	Viti	Viti Bazë Vlera	Njesia	2006	2009	2012	2015	Burimi
Gratë ne poste menaxhuese	2001	30	%	32	34	37	40	Këshilli i Qarkut Fier
Gratë ne tregun e punës por ne sektorin jo bujqësor	2001	39.1	%	41	43	44	45	Këshilli i Qarkut Fier
Gra ne Këshillin e Qarkut Fier	2001	6.6	%	10	15	20	25	Këshilli i Qarkut Fier

## Objektivi 8: Shtimi i pjesëmarrjes së grave në procesin e marrjes së vendimeve

Synimi 8.1: Rritja e kapaciteteve te pikave kryesore gjinore në nivel rajonal dhe lokal

Synimi 8.2: Sigurimi qe rekrutimi ne forcat e policise dhe procedurat të promovojne barazine gjinore dhe jo te jene diskriminuese ndaj grave.

Synimi 8.3: Rritja e numrit te grave te emeruara ne poste drejtuese në nivel rajonal dhe lokal.

### treguesit plotësues

- Numri i pikave gjinore aktive në nivel rajonal dhe lokal.
- Numri trajnimeve te marra nga personat e kontaktit për çështjet gjinore
- Buxheti i qeverisjes lokale i caktuar me drejtim për t'i nxitur çështjet gjinore
- Procedura tepër te qarta marrjeje në punë përsa i përket trajtimit te barabarte mbi çështjet gjinore.
- Numri i grave te promovuara ne pune në nivelet e qeverisjes lokale dhe rajonale



## OM 3: Nxitja e Barazisë Gjinore dhe Fuqizimi i Rolit të Gruas

Synimet	Problemi	Emri i Programit dhe Aktiviteti	Afati kohor	Aktorët	Efekti
6.1	Numer i ulët i grave ne poste drejtuese në nivel lokal dhe kombëtar	8.1 Krijimi i mundësive të biznesit për gratë Nxitja e kushteve të përshtatshme për iniciativë sipërmarrëse për gratë në nivel lokal, duke përmirësuar mundësinë për kredi, orinetim biznesi	Afat Mesem 2009	Këshilli i Qarkut, Bashkrite, Komunitat Ministria e Punës, orgnaizatrat ndërkombëtare	" Me shumë gra ne poste drejtuese " Me shumë përfaqësuese gra ne Këshillin e Qarkut, Bashki apo Komune " Me shumë gra te punësuar ne sektore jo bujqësorë " Me shumë gra që kanë përfunduar arsimin e mesem
6.2 dhe 6.3	Mungesa e institucioneve për t'u përgjigjur rasteve emergjente te dhunes dhe trafikimit ne Qark	8.2 Monitorim për promovimin ne karriere Futja e nje sistemi për te monitoruar politikat ne nxitjen dhe promovimin ne karriere në nivel lokal dhe rajonal.	Afat shkurter 2006	OJQ dhe bashkësia	" Matja e tendencave (renie- ngritje) ne këshillin e Qarkut me qellim nxitjen e politikave zhvilluese dhe programeve te tjera për te trajtuar apo kontrolluar ngritjet ne numer
9.1	Regjistrimi i rasteve te dhunes Përmirësimi i sistemit te regjistrimit te tedhenave mbi rastet e dhunes dhe reagimi ndaj tyre ne kohe dhe menyre efektive.	9.1 Regjistrimi i rasteve te dhunes	Afat Mesem 2009	Forcat policore në nivel rajonal dhe lokal, Këshilli i Qarkut, organizatat ndërkombëtare	" Përmirësimi i mekanizmave për fëmrat dhe meshkujt për te raportuar rastet e dhunes apo abuzimet edhe ne familje
9.2	Qendra e Grave Krijimi dhe mbështetja e qendrës së grave. Qendra do të siguroje strehim për gratë e keqtrajtuara, të ofroje keshilla dhe trajtime, informacion mbi problemet gjinore për mesues, forcat e rendit administrativen, Këshillin e Qarkut.	9.2 Qendra e Grave	Afat shkurter 2006	Këshilli i Qarkut, OJF-te, Bashkësia qendrat e tjera të grave të ngritura në BE, organizatat ndërkombëtare	" Krijimi i nje qendre te përhershme për te zgjidhur dhe përmirësuar kushtet e grave në rajon dhe edukimin e bashkësiat mbi problemet gjinore
9.3	Zbatim i ligjit kunder trafikanteve Nje bashkepunim me i mire midis strukturave lokale qeverisese, gjykatave, avokateve dhe shoqerise civile për te forcuar zbatimin e ligjit kunder krimineleve dhe trafikanteve	9.3 Zbatim i ligjit kunder trafikanteve	Afat Mesem 2009	Forcat policore në nivel rajonal dhe lokal, Këshilli i Qarkut	" Përmirësimi i sistemit qe identifikon dhunen gjinore dhe trafikimin



### OM 3: Nxitja e Barazisë Gjinore dhe Fuqizimi i Rolit të Gruas

Synimet	Problemi	Emri i Programit dhe Aktiviteti	Afati kohor	Aktorët	Efekt
6.4 dhe 6.5	Mungesa e informacionit për ndergjegjesim të publikut mbi problemet e barazisë gjinore ne familje dhe shoqeri	<b>1 Ndergjegjesimi i publikut mbi problemet gjinore</b> Rritja e ndergjegjesimit te publikut mbi problemet gjinore (burra & gra), çështjet e dhunes, barazisë dhe trafikimi i grave.	Afat shkurter 2006	Këshilli i Qarkut, OJF-te	" Ngritja e ndergjegjesimit mbi problemet gjinore dhe stereotipat " Informim dhe përhapje informacioni
7.1 dhe 7.2	problemet e barazisë gjinore ne familje dhe shoqeri	<b>2 Media, Bashkësia dhe çështjet Gjinore</b> Nxitja e trajtimit nga bashkësia dhe media i koncepteve te problemeve gjinore me qellim eliminimin e stereotipave mbi burrat dhe gratë.	Afat shkurter 2006	Këshilli i Qarkut, Media, Shoqeria Civile	" Sensibilizimi i medias dhe trajtim me i gjere i problemeve gjinore
		<b>3 Statistika mbi çështjet Gjinore</b> Futja e statistikave të zëbërthvera për gjinitë mbledhjen e statistikave në nivel lokal dhe rajonal nga matjet individuale për të pasqyruar pabarazitë	Afat shkurter 2006	Këshilli i Qarkut, Organizata Nderkombëtare, Institucione Kerkimore, OJF-te	" Reflektimi me i mire dhe ndryshimet ne disponueshmerine nga gratë të burimeve dhe shërbimeve
		<b>4 Studime mbi Gratë Rome</b> Berja e nje studimi fizibiliteti mbi gjendjen e grave Rome. Gratë dhe vështirësite qe hasin ne familje, punësim, trafikim etj.	Afat shkurter 2006	Këshilli i Qarkut, Organizata Nderkombëtare, Institucione Kerkimore, OJF-te, Gratë Rome në rajon	" Ndertimi i nje kuptimi më të mire për bashkësinë dhe pallet e interesuara rreth problemeve qe hasin Gratë Rome ne Bashkësinë fterake.
		<b>5 Çështjet Gjinore ne Arsim</b> Trajtimi i temave mbi barazine gjinore ne shkollat bazë dhe të mesme	Afat gjatë 2015	Këshilli i Qarkut, Ministria e Arsimit, OJF-të, organizatat ndërkombëtare	
		<b>6 Qendrat Konsultuese</b> Krijimi i qendrave te konsultimit për t'u ofruar ndihme viktimave te dhunes	Afat Mesem 2009		" Ndhimna për rehabilitim ne shoqeri ne komunitet dhe shoqeri të viktimave te trafikua





### OM 3: Nxitja e Barazisë Gjinore dhe Fuqizimi i Rolit të Gruas

Synimet	Problemi	Emri i Programit dhe Aktiviteti	Afati kohor	Aktorët	Efekti
8.1, 8.2 dhe 8.3	Pjesëmarrje e ulët e grave në procesin e vendim marrjes	<b>1 Zhvillim i aftësive drejtuese</b> Rritja e kapacitetit drejtues/manaxhues për gratë e punësuara në KQ dhe qeverisjen lokale	Afat mesem 2009	Këshilli i Qarkut, Organizata Nderkombëtare, OJF, Komiteti i Grave.	" Krijimi i nje mjedisi aftësues për gratë te zhvillojne potencialin e tyre të plotë ne jeten ekonomike dhe sociale.
		<b>2 Sistem Monitorimi</b> Fuqja e nje sistemi te rregullt monitorimi mbi politikat e punësimit dhe praktikat ne KQ dhe nivelet e qeverisjes vendore	Afat shkurter 2006	Këshilli i Qarkut, Organizata Nderkombëtare, OJF, Komiteti i Grave.	
		<b>3 Pika kryesore te ÇËSHTJEVE gjinore</b> Sigurimi dhe forcimi i nje statusi te veçante te çështjeve kryesore te çështjeve gjinore për te promovuar konceptin e çështjeve gjinore në nivel lokal dhe rajonal si pjesë e mekanizmit institucional kombëtar për te siguruar barazine gjinore	Afat shkurter 2006	Këshilli i Qarkut, Organizata Nderkombëtare, OJF, Komiteti i Grave.	
		<b>4 Perspektivat e çështjeve Gjinore</b> Zhvillimi i programeve për te rritur kapacitetet e stafit ne administratat e qeverisjes lokale dhe rajonale qe te bëhet planifikimi i buxhetit edhe me perspektive gjinore gjithashtu	Afat mesem 2009	Këshilli i Qarkut, Organizata Nderkombëtare, OJF, Komiteti i Grave.	
		<b>5 Politikat Rajonale duke marrë parasysh çështjet gjinore</b> Formulimi i politikave rajonale për nxitjen e barazisë gjinore	Afat mesem 2009	Këshilli i Qarkut, Organizata Nderkombëtare, OJF, Komiteti i Grave.	

## OM 7: Sigurimi i qëndrueshmërisë së mjedisit

### Objektivat afatmesme kombëtare - SKZHSE:

- Përmirosim i dukshëm në infrastrukture dhe shërbime të lidhura me të, si uji i pijshëm, energjia elektrike, kanalizimet dhe sigurimi që të varferit t'i marrin keto shërbime;

### Problemet e mjedisit në Qarkun e Fierit

Fieri është një nga rajonet më të ndotura të Shqipërisë, 3 nga 9 pikat e nxehta me ndotje industriale, të përcaktuara nga UNEP ndodhen në Qarkun e Fierit. Problemet kryesore të mjedisit në Qarkun e Fierit lidhen me ndotjet nga industria e naftës dhe energjetike. Teknologjia e nxjerrjes së naftës dhe përpunimi i naftës, si dhe prodhimi i energjisë nga Termocentrali kanë pasur ndikim të jashtëzakonshëm mbi mjedisin, duke degraduar tokën, ajrin dhe ujin. Industritë nuk kanë trajtimin e përshtatshëm të gazrave që lëshohen dhe të ujërave të përdorura. Një sasi e madhe naftë ka ndotur rrjedhat ujore të rajonit. Lumi i Gjanicës, nga i cili merret ujë për të pirë nga banorët vendas, i ka tre kilometra të rrjedhës të ndotura me naftë, siç deklarojnë autoritetet vendore. Ka nevojë urgjente për modernizimin e këtyre industrive dhe për investime të mëdha në sistemet e mbikëqyrjes të industrive e në zonat e banuara, për të siguruar që cilësia e mjedisit të ruhet brenda standardeve të BE-së. Duhet ndërmarrë veprimtari për rehabilitimin e zonave tashmë të degraduara. Disa nga nismat e Albpetrolit të planifikuara për vitet e ardhshme që të ndryshohen pusët e naftës e të rehabilitohet toka do të kenë ndikim pozitiv të paktën 40% mbi tokën e ndotur deri në vitin 2015.

Gjatë periudhës së tranzicionit kanë dalë probleme të tjera kryesisht për shkak të zhvillimit urban. Rritja e shpejtë e popullsisë në zonat urbane ka sjellë trysni të madhe mbi infrastrukturën e ujit e të higjienës, duke sjellë nevojën për të përballuar një gjendje shqetësuese nga pushteti lokal. Sistemi i kanalizimeve është një çështje me rëndësi, të cilit nuk i është kushtuar vëmendja e duhur nga pikëpamja e studimeve dhe e financimeve. Ndonëse zonat urbane kanë përqindje

më të lartë populsi të lidhur me sistemin kanalizim, i cili sidoqoftë as nuk është i lidhur me ndonjë fabrikë trajtimi, në periferitë e bashkive, si dhe në zonat fshatare sistemi mbizotërues janë gropat septike. Ndotja që vjen prej ujit të përdorur në shtëpitë sjell ndotjen e lumenjve e të detit dhe i zvogëlon potencialet turistike të qarkut.

Në tërësi në qark afërsisht 70% e popullsisë nuk ka ujë të pijshëm në shtëpi. Gjendja është kritike po të mbahet parasysh rrjeti i vjetruar dhe problemet e lidhura me cilësinë e ujit. Kjo gjendje ka sjellë disa probleme shëndetësore dhe në fakt shkak kryesor i sëmundshmërisë në qark njoftohet se vjen nga sëmundjet prej ujit. Ka nevojë urgjente për të vlerësuar gjendjen për kushtet e rrjetit ekzistues dhe të rriten investimet për infrastrukturën e ujit. Veç kësaj, ka nevojë për të sqaruar e për të zbatuar kuadrin institucional e ligjor për administrimin e ujit, që të shmanget bashkërendimi i keq dhe mungesa e veprimit nga pikëpamja e investimeve, mirëmbajtjes dhe administrimit të sistemeve të ujit.

Shfrytëzimi i paligjshëm i burimeve natyrore (shpyllëzimi, peshkimi mbi masën e lejueshme etj.) gjithashtu kanë dalë si një çështje që meriton studime të mëtejshme dhe veprime. Sot vetëm 10,5 për qind e sipërfaqes së përgjithshme të rajonit të Fierit është e mbuluar me pyje. Ka nevojë të bëhet mbikëqyrje më e kujdesshme e burimeve ekzistuese dhe të hartohet një plan për ripyllëzimin e mbrojtjen e zonave pyjore.

Nismat për trajtimin e çështjeve që çojnë në sistemet e dobëta të administrimit të mjedisit në qarkun e Fierit janë në një vijë me përparësitë në shkallë vendi për fuqizimin institucional dhe të investimeve në mjedis. Ndër shembujt e skemave për të mënjeluar efektet e dëmshme mbi mjedisin bëjnë pjesë projekti i financuar nga BE për largimin e 850 m<sup>3</sup> mbetjeve të rrezikshme nga uzina e plehrave në Fier<sup>1</sup>, përmirësimet e sistemit të inspektimit të mjedisit<sup>2</sup> dhe ngritja e sistemeve të informimit për mjedisin në nivel kombëtar e lokal. Përveç këtyre përpjekjeve, Statusi i mjedisit<sup>3</sup> dhe pika të jera referimi në nivel rajoni, që janë marrë si pikënisje për gjendjen e mjedisit në Qarkun e Fierit, tregojnë se plotësimi i pikës 7 të OM për të siguruar

<sup>1</sup> REC 2003: REReP 1.2 Priority Environmental Investment Projects

<sup>2</sup> Law no. 8934 dt. 05.09.2002: On environmental protection

<sup>3</sup> Ministry of environment: Report on state of environment 1999-2000

qëndrueshmërinë e mjedisit, të synuar për vitin 2015, kërkon një anagzhim serioz dhe përfshirjen e aktorëve të ndryshëm në nivel kombëtar e rajonal.

## Objektivat

### *Objektivi 9: rehabilitimi i zonave të ndotura dhe zhdukja e ndotjes nga nafta në Qarkun e Fierit*

Ndotja e mjedisit në Fier në pjesën më të madhe lidhet me historinë e gjatë të veprimtarive industriale. Nafta, energjia dhe industritë e tjera e kanë degraduar rëndë tokën, ujin dhe ajrin. Për ta përmbysur këtë gjendje, kjo Strategji propozon që të zgjidhet problemi nga tre drejtime: (i) të pakësohet ndotja te burimi duke investuar për teknologjinë e re që është e pastër nga ana mjedisore, (ii) të rehabilitohet toka dhe rrjedhat ujore, dhe (iii) të shtohen sistemet mbikëqyrëse për ndotjen e ajrit e të ujit në burim dhe te zonat e prekurra. Ky objektivi është një nga sfidat kryesore që duhet të përballojë qarku i Fierit me bashkërendimin e duhur të gjithë aktorëve të përfshirë.

- 1 REC 2003: REReP 1.2 Projektet e investimeve mjedisore me përparësi
- 2 Ligji nr. 8934, dt. 05.09.2002: Mbi mbrojtjen e mjedisit
- 3 Ministria e mjedisit: Raport për gjendjen e mjedisit 1999-2000

### *Objektivi 10: të përmirësohet infrastruktura dhe planifikimi urban, si dhe të zvogëlohet degradimi i mjedisit*

Rritja e shpejtë e popullsisë urbane e ka rënduar mjedisin. Një nga sfidat e rëndësishme në qarkun e Fierit është menaxhimi i urbanizimit të shpejtë për të mbrojtur shëndetin publik dhe për t'i siguruar popullsisë mundësinë e përdorimit të infrastrukturës bazë, si uji dhe higjiena. Kjo Strategji propozon formulimin e një plani urban dhe të planeve të tjera sektoriale, si për transportin, trajtimin e plehrave, ujin e higjienën që të drejtohen më mirë investimet dhe të përmirësohet menaxhimi i qyteteve në rritje, për të zvogëluar ndikimin e tyre mbi mjedisin e për të ngritur cilësinë e jetës së qytetarëve. Ndryshimet në pronësinë e tokës gjithashtu kanë ushtruar trysni mbi mjedisin, duke shkaktuar humbjen e habitatit nga shpyllëzimi, erozioni, vërshimet e shterimi i shtresave të ujit të pijshëm. Ripullëzimi propozohet në këtë Strategji si fushë strategjike

për përmirësimin e cilësisë së mjedisit dhe shëndetit të qytetarëve.

## Synimet dhe treguesit



## TREGUESIT Synimi 9.1

Viti	Viti Bazë Vlera	2006	2009	2012	2015	Burimi
2001	200 km <sup>2</sup>	10	25	35	50	Alb Petroleum

Njësia

Rehabilitimi i tokës së ndotur nga nafta

## Objekti 9: Rehabilitimi i zonave të ndotura dhe zhdukja e ndotjes nga nafta në Qarkun e Fierit

Synimi 9.1: Rehabilitimi me 40 % litokës së ndotur nga nafta

## TREGUESIT Synimi 10.1 & 10.5

Viti	Viti Bazë Vlera	2006	2009	2012	2015	Burimi
2001	10.5	12	13	14	15	Zyra e Kadastrës Këshilli i Qarkut Fier
2001	30.16	40	50	60	70	Këshilli i Qarkut Fier

Njësia

Raporti sipërfaqeve të mbuluara me pyje

% e popullsisë me ujë brenda ndërtesave

Ndofta bakteriale e ujit

Ndertimi i një fushe plehrash rajonale

2001 65 % 40 30 25 0 MoH, IPH

2003 0 numer 1 1 1 Këshilli i Qarkut Fier

## Objekti 10: Përmirësimi i infrastruktures dhe planeve urbane, si dhe pakësimi i degradimit të mjedisit

Synimi 10.1: Shtimi i zonave të mbrojtura natyrore dhe sipërfaqes së mbuluar me pyje me 15% (OM)

Synimi 10.2: Përgjysmimi i popullsisë pa burime uji të pijshëm (OM)

Synimi 10.3: Përgjysmimi i popullsisë në kushte sanitare jo të përshtatshme

Synimi 10.4: Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave përmes futjes së programve ricikluese të mbeturinave dhe ndertimit të tre fushave sanitare të plehrave për qarkun

Synimi 10.5: Përgatitja e planeve sektoriale të lidhura me planin e përgjithshëm të zhvillimit

### tregues plotësues

- Përmirësimi dhe zbatimi i një kuadri rregullues në derdhjet e mbeturinave industriale dhe përcaktimi i standardeve të ndotjes së lejuar nga shkarkimet e gazrave deri në 2004
- Numri i planeve sektoriale të rajonit përgatitur dhe zbatuar nga Këshilli i Qarkut
- % e popullsisë që është e lidhur me sistemin e kanalizimeve
- Rritja totale e sipërfaqes së mbrojtur e cila në 2001 ishte 8815 Ha (Zyra e Kadastrës Këshilli i Qarkut Fier) Rehabilitimi i lumenjve Semani dhe Vjosa
- Numri aktivitetesh ndërgjegjësues të organizuara në nivel Rajonal



## OM 7: Sigurimi i qëndrueshmërisë së Mjedisit

### Synimet Problemi Emri i Programit dhe Aktiviteti

Synimet	Problemi	Emri i Programit dhe Aktiviteti	Afati kohor	Aktorët	Efekti
9.1	Ndotje e lartë sidomos ne zonat nafte mbajtëse në rajon	<b>1 Rikonstruksioni i rezervuareve të naftës</b> Zhvendosja e rezervuareve të naftës deri ne 2015 për të rehabilituar tokën	Afat gjatë 2015	Albpetrol, Këshilli i Qarkut, Agjencia dhe Ministria e Mjedisit	• Rehabilitimi i tokës se ndotur nga nafta
		<b>2 Mirembajtja e rezervuareve të naftës</b> Rikonstruksioni dhe mirembajtja e rezervuareve të naftës deri ne 2015	Afat gjatë 2015	Albpetrol, Këshilli i Qarkut, Agjencia dhe Ministria e Mjedisit	• Pakësimi i ndotjes dhe rehabilitimi i tokës se ndotur nga nafta
		<b>3 Ujërat e përdorura</b> Zbatimi i përpunimit teknologjik te ujerave deri ne 2006	Afat shkurter 2006	Albpetrol, Këshilli i Qarkut, Agjencia dhe Ministria e Mjedisit	• Ulja e ndotjes ne lumenj
		<b>4 Trajnime të stafit</b> Trajnimi i stafit qe punon ne shoqerite e naftës	Afat shkurter 2006	Albpetrol, Këshilli i Qarkut, Agjencia dhe Ministria e Mjedisit	• Krijimi i nje force punetore te afte ne industrine e naftës
		<b>5 Rehabilitimi i zones bregdetare</b> Rehabilitimi i zones bregdetare te ndotur nga nafta qe nga lumi Gjanica deri ne lumin Vjose .	Afat gjatë 2015	Albpetrol, Ministria e Mjedisit, Këshilli i Qarkut, OJF-te për mjedisin, Shoqeria civile	• Ulja e ndotjes ne zonat bregdetare
		<b>6 Studime mbi ndikimin e ndotjes mbi shendetin</b> Berja e nje studimi qe do të përpiqet te gjeje lidhjen midis ndotjes dhe ndikimit te saj ne popullisine e Qarkut Fier.	Afat shkurter 2006	Këshilli i Qarkut, Zyra Rajonale e Kadastrës, Organizatat Nderkombëtare, Albpetrol, Agjencia e mjedisit e rajonit	• Mbledhja e statistikave dhe analizimi i situatës se përgjithshme të ndotjes dhe shendetit ne Qarkun Fier • Rritja e ndergjegjesimit te kompanive te naftes dhe shoqerise civile mbi efektet dhe semundjet qe shkaktohen nga ndotja



## OM 7: Sigurimi i qëndrueshmërisë së Mjedisit

Synimet	Problemi	Emri i Programit dhe Aktiviteti	Afati kohor	Aktorët	Efekti
10.1	Zonat Natyrore dhe sipërfaqet me pyje të rrezikuara	<b>13.1 Hartimi i planit të menaxhimit të burimeve natyrore</b> Të përgatitet një plan për përmirësimin e menaxhimit të burimeve natyrore në qark	Afat mesem 2009	Këshilli i Qarkut, Zyra Rajonale e Kadastrës, Agjencia e mjedisit e rajonit	<ul style="list-style-type: none"> <li>Të përmirësohet menaxhimi i burimeve natyrore</li> </ul>
		<b>13.2 Pyllëzimet e Brezat e Gjelber</b> Ripyllëzimi i unazës së Ballshit, zonave kodinore të Fierit dhe të tjera deri në 2004	Afat gjatë 2015	Këshilli i Qarkut, Zyra Rajonale e Kadastrës, Agjencia e mjedisit e rajonit	<ul style="list-style-type: none"> <li>Rritja e sipërfaqeve natyrore të mbrojtura dhe sipërfaqeve të veshura me pyje</li> </ul>
		<b>13.3 Menaxhimi i zonave të mbrojtura</b> Hartimi i nje programi për menaxhimin efektiv të zonave të mbrojtura	Afat gjatë 2015	Ministria e Mjedisit, Këshilli i Qarkut, Departamenti i pyjeve, Agjencia e mjedisit e rajonit	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përmirëson menaxhimin e zonave të mbrojtura</li> </ul>
		<b>13.4 Fushate mbi qëndrueshmërinë e mjedisit</b> Fushate ndërgjegjësuese mbi mbrojtjen e mjedisit	Afat shkurtër 2006	Këshilli i Qarkut, Zyra Rajonale e Kadastrës, Organizatat Nderkombëtare, Agjencia e mjedisit e rajonit	<ul style="list-style-type: none"> <li>Rrit ndërgjegjësimin drejt qëndrueshmërisë mjedisore</li> </ul>



## OM 7: Sigurimi i qëndrueshmërisë së Mjedisit

Synimet	Problemi	Emri i Programit dhe Aktiviteti	Afati kohor	Aktorët	Efekti
10.2 dhe 10.3	Numri i popullsisë pa furnizim me uje te paster dhe të sigurte e pa kanalizime ujerash te zeza	<b>14.1 Trajtimi i Ujit</b> Ndertimi i sistemit trajtues te ujit deri ne 2008	Afat mesem 2009	Ministria e Territorit dhe Turrizmit, Departamentet rajonale, Prefektura, Këshilli i Qarkut	<ul style="list-style-type: none"><li>• Rritja e popullsisë me furnizim me uje te pjshem te paster dhe të sigurte</li><li>• Eliminimi i ndotjes bakterologjike</li></ul>
		<b>2 Furnizimi me uje</b> Përgatitja e studimeve te fizibilitetit dhe rritja e sistemit te furnizimit te ujit nepërmjet rindertimit te puseve apo stacioneve te pompimit.	Afat gjate 2015	Ministria e Territorit dhe Turrizmit, Departamentet rajonale, Prefektura, Këshilli i Qarkut	<ul style="list-style-type: none"><li>• Furnizim me uje te pishem 24 ore për pjesën më të madhe të popullsisë</li></ul>
		<b>3 Studim mbi ujin e pijshem</b> Fillimi i nje studimi mbi ujin e pijshem te Roskovecit qe të furnizohet nga rezervuari i Kurjanit	Afat shkurter 2006	Ministria e Territorit dhe Turrizmit, Departamentet rajonale, Prefektura, Këshilli i Qarkut	<ul style="list-style-type: none"><li>• Furnizim me uje te pijshem 24 ore</li></ul>
		<b>4 Manaxhimi i Burimeve te ujit</b> Krijimi i programeve mbi manaxhimin e ujit për të siguruar përdorim të qëndrueshëm të burimeve dhe zvogëlimin e ndotjes me mbikëqyrje e forcimin e institucioneve	Afat mesem 2009	Ministria e Territorit dhe Turrizmit, Departamentet rajonale, Prefektura, Këshilli i Qarkut, Ministria e Mjedisit	<ul style="list-style-type: none"><li>• Rritja e efijences ne përdorimin e burimeve ujore dhe mbrojtjen e shtresave ujore.</li></ul>
		<b>5 Rritja e Higjienes</b> përgatitja e nje studimi fizibiliteti dhe një plani veprimesh për te rritur përqindjen e popullsisë te mbuluar nga rrjeti i ujrave te zeza	Afat shkurter 2006	Ministria e Territorit dhe Turrizmit, Departamentet rajonale, Prefektura Këshilli i Qarkut	<ul style="list-style-type: none"><li>• Reduktimi i ndotjes se ambientit</li></ul>
		<b>14.8 Krijimi i nje paneli për konsumatorin</b> krijimi i panelit te konsumatorit dhe nje sistemi informative si vend për te nxitur strategjine dhe politikat dhe të merret opinioni i aktorëve	Afat shkurter 2006	Këshilli i Qarkut Bashkite, Komunat, Shoqëria Civile, OJF-te, Bashkësia (Grupet e Organizuara ne Komunitet)	<ul style="list-style-type: none"><li>• Reduktimi i ndotjes se ambientit</li></ul>



## OM 7: Sigurimi i qëndrueshmërisë së Mjedisit

### Synimet Problemi Emri i Programit dhe Aktiviteti

Synimet	Problemi	Emri i Programit dhe Aktiviteti	Afati kohor	Aktorët	Efektet
10.4	Mungese menaxhimit të mbetjeve	<b>1 Fushate mbi Mjedisin</b> Ngritja e çështjeve të mjedisit në Qarkun Fier për të nxitur praktikën mbi menaxhimin urban mbi pleherat, të tilla si reduktimin e hedhjes së mbeturinave dhe praktikën e riciklimit dhe reduktimit të mbetjeve.	Afat shkurtër 2006	Ministria e Mjedisit; Këshilli i Qarkut, Shoqëria Civile, OJF-te, Bashkësia (Grupet e Organizuarave në Komunitet)	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave përmes programeve të riciklimit dhe ndërtimit të fushave të pleherave</li> </ul>
		<b>2 Plan mbi Mbetjet</b>	Afat shkurtër 2006	Autoritetet lokale	<ul style="list-style-type: none"> <li>Menaxhim i përmirësuar i mbledhjes së plehrave dhe hedhjes së tyre në nivel Qarku</li> </ul>
		<b>3 Studime për krijimin e një industrie ricikluese</b> Studime fizibiliteti për mundësitë e riciklimit të dhe mbështetjes për rehabilitimin e uzinave ricikluese të letres dhe plastmasit në Lushnjë	Afat shkurtër 2006	Agjencitë Mjedisore, Ministria e Mjedisit, Këshilli i Qarkut	<ul style="list-style-type: none"> <li>Rrit mundësinë për reduktimin e plehrave që do të hidhen</li> </ul>
		<b>4 Fushat e plehrave</b> Nërtimi i një fushe plehrash rajonale	Afat mesëm 2009	Këshilli i Qarkut, Organizata ndërkombëtare, Ministria e Mjedisit	<ul style="list-style-type: none"> <li>Zvogëlon ndotjen e mjedisit</li> </ul>





## OM 7: Sigurimi i qëndrueshmërisë së Mjedisit

Synimet	Problemi	Emri i Programit dhe Aktiviteti	Afati kohor	Aktorët	Efekti
10.5	Mungese e planeve sektoriale dhe planeve të përgjithshme zhvillimi	<b>16.1 Nderthurja e strategjive</b> përgatitja e planeve të nderlidhura në nivel rajonal (përdorimi i tokës, transporti, etj.)	Afat shkurtër 2006	Këshilli i Qarkut	<ul style="list-style-type: none"><li>• Përdorim dhe menaxhim me i mire i burimeve natyrore</li></ul>
		<b>16.2 Përgatitja e planeve lokale</b> Mbështetje në përgatitjen e planeve të zhvillimit në Komuna dhe Bashki	Afat shkurtër 2006	Këshilli i Qarkut, Komunitat, Bashkite	<ul style="list-style-type: none"><li>• Përdorim dhe menaxhim me i mire i burimeve lokale</li></ul>
		<b>16.3 Ndertime pa leje</b> Zhvillimi i nje mekanizmi dhe forcimi i organizmave kontrolluese dhe parandaluese për ndertimet pa leje	Afat mesem 2009	Këshilli i Qarkut, Komunitat, Bashkite	<ul style="list-style-type: none"><li>• Zvogelon përkeqsimin e mjedisit</li></ul>

## Objektiv për Fierin : Përmirësimi i Qeverisjes Lokale

**Objektivat afatgjata kombëtare - SKZHSE:** Thellimi i reformave dhe modernizimi i Institucioneve shtetërore sipas standardeve të një shoqërie demokratike dhe një shoqërie të orientuar drejt ekonomisë së tregut

### Problemet e qeverisjes në Qarkun e Fierit

Qytetarët e Qarkut të Fierit kanë kërkesë të madhe për demokraci. Aktorët në mbledhjet e grupit tematik kanë përcaktuar katër çështje kryesore që duhen trajtuar: niveli i ulët i pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje, niveli i ulët i përhapjes së informacionit, korrupsioni dhe frytshmëria e ulët e institucioneve publike.

Lufta kundër korrupsionit dhe zbatimi i sistemeve efektive e të përgjegjshme për përdorimin e burimeve publike u përcaktuan nga aktorët si çelësi për të garantuar që burimet nuk shpërdorohen. Veprimet për ta arritur këtë Synim paraqiten në SKZHES dhe në kuadrin e PAS si një objektiv për qeverinë shqiptare, duke qenë një nga përparësitë në qarkun e Fierit. Zbatimi i rregullave e procedurave të qarta në institucionet publike quhen si veprime të rëndësishme krahas me programet e reformave të qeverisë qendrore për të pakësuar pasojat e korrupsionit.

Sipas Raportit të zhvillimit njerëzor 2002, qeverisja demokratike kërkon më tepër sesa politika e institucioneve, që sigurojnë shërbime publike efektive. Ajo kërkon intuits të rregulla vepruese të drejta, si dhe vendime gjatë proceseve që u japin vend njerëzve dhe u mundësojnë t'u kërkojnë përgjegjësitë autoriteteve. Një sistem i mirë politik që nxit përgjegjshmërinë e qeverisë dhe zërin e njerëzve, duke përfshirë grupet e pakicave e gratë, rrjedhimisht janë themeli për të arritur synimet e Vizionit për Fierin.

Ka një vullneti politik për të nxitur pjesëmarrjen e publikut dhe informimin e qytetarëve, por ka nevojë të çojë në veprime të institucionalizuara. Autoritetet qeveritare duhet të ngrenë sisteme që të sigurojnë

përhapjen sistematike të informacionit dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin politik. Një nga shembujt janë forumet publike për planifikimin, financimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarive shtetërore. Qarku i Fierit mund të mbështetet në përvojën e formulimit të OM për planifikimin pjesëmarrës që ta vijojë këtë praktikë.

## Objektivat

### Objektivi I 1: Të pakësohet korrupsioni dhe të shtohet pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje

Kjo Strategji përqendrohet te arritja e këtij objektivi përmes shtimit të mekanizmave të pjesëmarrjes dhe institucionalizimit të saj si një rrugë për të shtuar transparencën. Përveç kësaj, të ngrihet ndërgjegjësimi i qytetarëve kundër korrupsionit dhe instrumentet publike për të njoftuar rastet e korrupsionit, si linjat e hapura telefonike.

### Objektivi I 2: Të përmirësohet efektshmëria e pushtetit vendor

Përmirësimi i efektshmërisë së qeverisjes në Strategji trajtohet përmes rishikimit dhe sqarimit të strukturës së pushtetit e të roleve, si dhe duke zhvilluar aftësitë e personelit qeveritar.

### Synimet dhe treguesit





## TREGUESIT

### Synim 11.1 - 11.3

Burimi

2015

2012

2009

2006

Viti Bazë  
Vlera

Viti

Njesia

Numri i debatore mbi rishikimin, monitorimin, zbatimin e politikave dhe planeve ne këshillin e Qarkut	2003	0	Numer / vit	4	4	4	4	Këshilli i Qarkut
---	------	---	-------------	---	---	---	---	-------------------

Numri i mbledhjeve publike te mbajtura ne përgatitjen dhe prezantimin e buxhett	2003	0	Numer / vit	2	2	2	2	Këshilli i Qarkut
---	------	---	-------------	---	---	---	---	-------------------

### Objekti 11: Të pakësohet korrupsioni dhe të shtohet pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje

- Synim 11.1: Struktura pjesëmarrse të publikut për planifikimin dhe monitorimin e aktiviteteve te qeverise për te rritur transparencen dhe funksionimin mbi baza te rregullta
- Synim 11.2: Botime mbi procedurat e rekrutimit dhe punësimit të personelit, prokurime mallrash dhe sherbimesh në të gjitha nivelet e qeverisjes
- Synim 11.3: Personeli teknik dhe të zgjedhurit e qeverisjes lokale te përfshihen ne programe trajnuese çdo vit
- Synim 11.4: Krijimi dhe funksionimi i nje kuadri te qarte ligjor dhe procedurave te punës

## treguesit plotesues

Numri i materialeve informative te publikuara për te informuar njerezit rreth aktiviteteve te qeverisjes

Numri i revizioneve te brendshme dhe të raportimit

Numri I procedurave te publikuara

% e lajmerimeve për punësim te publikuara ne gazete

Norma e sherbimeve te ofruara me efektivitet (numri i diteve për çdo procedure sipas standardeve te përcaktuara)

### Objekti 12: Të përmirësohet efektshmëria e pushtetit vendor

Synim 12.1: Trajtime vjetore të personelit teknik dhe të zgjedhureve në pushtetin lokal

Synim 12.2: Zhvillimi dhe zbatimi i nje kuadri te qarte organizativ dhe procedurave te punës

Synim 12.3: Plane financiare ne përputhje me planet e përgjithshme të zhvillimit

## treguesit plotesues

Numri i personelit teknik të trajnuar

Numri i te zgjedhurve lokale të trajnuar

Organigrama, statuti, deklarata e misionit, dhe termat e references për çdo zyre dhe personel për Këshillin e Qarkut, Komunitat dhe Bashkite

% e aktiviteteve te buxhettit e bere siaps planeve te plota

Objektiv për Fierin: Përmirësimi i Qeverisjes Lokale		Emri i Programit dhe Aktiviteti		Afati kohor	Aktorët	Efektë
Synimet	Problemi					
11.1	Korrupsioni dhe mungesa e e strukturave pjesëmarrëse për planifikim dhe monitorim të qeverisjes për të rritur transparencën	<p><b>1 Takimet të hapura për publikun</b></p> <p>Mbajtja e mbledhjeve të rregullta me aktorët gjatë vitit planifikues dhe monitorues të strategjisë dhe politikave të saj. Shtimi i kësaj si një klauzole dhe detyre në planin e punës dhe statutin e KQ.</p>	Afat shkuter 2006	Qeverisja lokale, departamentet, Këshilli i Qarkut, Media lokale Sherbimet publike, Administrata, OJF-te, Bashkësia (Grupet e Organizuara ne Komunitet) dhe shoqeria civile.	<ul style="list-style-type: none"> <li>Rritja e numrit të takimeve pjesëmarrëse me publikun dhe strukturave të tjera pjesëmarrëse që do të mbledhen mbi baza të rregullta për planifikim dhe monitorim të aktiviteve të qeverisjes (buxheti, politikat etj.)</li> <li>Rritja e debatit ne Këshillin e Qarkut përsa i përket zbatimit, rishikimit të planeve dhe politikave</li> </ul>	
		<p><b>2 Masat Antikorrupsion</b></p> <p>Rritja e transparencës dhe përgjegjësise ne identifikimin e burimeve të korrupsionit ne sigurimin e shërbimeve (tendera, prokurime) dhe politikave mbi stafin përmes raportimit dhe revizionit</p>	Afat gjate 2015	OJF-te, Departamentet e Qeverisjes Lokale, Këshilli i Qarkut,	<ul style="list-style-type: none"> <li>Identifikim i burimeve të korrupsionit.</li> </ul>	
		<p><b>3 Linja dhe Fushate Anti-korrupsion</b></p> <p>Krijimi i nje linje publike anti -korrupsion për te kerkuar keshille mbi rastet e korrupsionit te hasura</p>	Afat mesem 2009	Këshilli i Qarkut, OJF-te, Bashkësia (Grupet e Organizuara ne Komunitet)	<ul style="list-style-type: none"> <li>Sigurimi i nstrumentave shoqerise civile për te raportuar dhe kerkuar keshilla ne identifikimin e korrupsionit</li> </ul>	
		<p><b>4 Fushate mbi Antikorrupsionin</b></p> <p>Rritja e ndergjegjesimit kunder korrupsionit përmes nje fushate anti korrupsion intensive</p>	Afat shkuter 2006	Këshilli i Qarkut	<ul style="list-style-type: none"> <li>Hapja e nje kanali për mbledhjen dhe raportimin e rasteve te korrupsionit</li> </ul>	
		<p><b>5 Mobilizimi Social-Vullnetarizmi</b></p> <p>Nxirtja dhe rritja e atmosferes se përshtatshme për dytetarët te ndermarrin iniciativa vullnetare në të gjitha programet e qeverisjes sociale apo ekonomike</p>	Afat gjate 2015	Këshilli i Qarkut, Organizatat Nderkombëtare, shoqeria civile, OJF-te, Bashkësia (Grupet e Organizuara ne Komunitet)	<ul style="list-style-type: none"> <li>Zhvillimi i shpirtit te vullnetarizmit çon ne zhvillim ekonomik dhe social për rajonin</li> </ul>	
		<p><b>6. Ngritja e pjesëmarrjes së grave në politikë</b></p> <p>Të mbështeten programet për të rritur ndergjegjesimin dhe zhvillimin e aftësive të grave në qark</p>	Afat mesem 2006	Ministria e punës, Këshilli i Qarkut, OJF, organizatatata ndërkombëtare	<ul style="list-style-type: none"> <li>Të rritet përfaqësimi i grave në poste drejtuese</li> </ul>	



## Objektiv për Fierin: Përmirësimi i Qeverisjes Lokale

Synimet	Problemi	Emri i Programit dhe Aktiviteti	Afati kohor	Aktorët	Efekt
11.2, 11.3 dhe 11.4	Mungesa e procedurave të qarta për punësimin e personelit, prokurimeve të mallrave dhe shërbimeve dhe shpërndarjes së tyre për të gjitha nivelet lokale.	<b>18.1 Qendra e Informacionit</b> Zhvillimi i qendrave të informacionit publik në institucionet qeverisëse dhe faqe përkatese të internetit për përhapjen e informacionit. Publikimi i lajmerimeve gjatë punësimit të stafit të ri në sigurimin e shërbimeve (tendera, prokurime) dhe shpërndarjen e tyre në të gjitha nivelet e qeverisjes.	Afat mesem 2009	Këshilli i Qarkut	
		<b>18.2 Manualët dhe Kode Etike</b> Përgatitja e manualeve për rekrutimin e personelit, prokurimet e mallrave dhe shërbimeve dhe shpërndarjen e tyre dhe kode sjelljeje dhe etike në të gjitha nivelet e qeverisjes.	Afat mesem 2009	Këshilli i Qarkut	
		<b>18.3 Rishikimi i Pagave</b> Rishikimi i politikave mbi pagat për departamente të caktuara si mbledhja e taksave, planifikimi urban dhe shërbimet publike.	Afat gjatë 2015	Këshilli i Qarkut, Nepunësit e shërbimit civil	<ul style="list-style-type: none"><li>• Përmirësimi i pagave dhe shpërblyeve për të ulur korrupsionin</li></ul>

## Objektiv për Fierin: Përmirësimi i Qeverisjes Lokale

Synimet	Problemi	Emri i Programit dhe Aktiviteti	Afati kohor	Aktorët	Efektet
12.1, 12.2 dhe 12.3	Nevoja për përmirësimin e efektivitetit të qeverisjes lokale	<b>19.1 Plane PUNE</b> Përgatitja e planeve të punës në bazë të rregullit.	Afat shkuter 2006	Këshilli i Qarkut	<ul style="list-style-type: none"> <li>Rritja e kapaciteteve të administratës së qeverisjes lokale përmes procedurave të rregulluara të punësimit dhe trajnimeve po të tilla.</li> </ul>
		<b>19.2 Inventari</b> Përgatitja e një inventari mbi burimet	Afat shkuter 2006	Këshilli i Qarkut	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përmirësimi i punësimit të stafit duke ulur kështu rastet e korrupsionit</li> </ul>
		<b>19.3 Vlerësimi mbi nevojat</b> Berja e një vlerësimi të nevojave organizative dhe përgatitja e një strategjie për përmirësimin e përbushjes së detyrave me efektshmeri	Afat shkuter 2006	Këshilli i Qarkut	<ul style="list-style-type: none"> <li>Rritja e kapacitetit të zgjedhurve përmes programeve të rregullta trajnimi.</li> </ul>
		<b>19.4 Reformulimi i Strukturës Organizative</b> Pajisja me Organigramat, statuti misioni dhe termat e Referencës për çdo zyre për Këshillin e Qarkut dhe për këto Komune dhe Bashki	Afat mesem 2009	Këshilli i Qarkut, Nepunësit Civile	
		<b>19.5 Monitorimi i SRZH</b> Krijimi i një sistemi monitorues për të ndjekur ecurinë e SRZH gjatë gjithë zbatimit të saj. Ky sistem do të mbledhë të dhëna gjatë gjithë procesit.	Afat gjate 2015	Këshilli i Qarkut, Organizatat Nderkombëtare	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndjek dhe siguron që objektivat e SRZH përbushen në afat</li> </ul>
		<b>19.6 Trajnime të Administratës Qeverisëse</b> Rritja e kapaciteteve lokale të administratës duke rritur numrin e personelit të kualifikuar përmes procedurave të punësimit dhe trajnimeve të rregullta	Afat shkuter 2006	Këshilli i Qarkut, Organizatat Nderkombëtare	
		<b>19.7 Trajnime të të Zgjedhurve</b> Rritja e kapaciteteve të zgjedhurve përmes trajnimeve të rregullta	Afat shkuter 2006	Këshilli i Qarkut, Organizatat Nderkombëtare	
		<b>19.8 Futja e planeve Financiare</b> Berja e planeve financiare në përputhje me planet e përgjithshme për zhvillim.	Afat mesem 2009	Këshilli i Qarkut	

# Kapitulli 4

## Zbatimi dhe Monitorimi

*SRZH të Fierit është një kuadër elastik për zhvillimin e qarkut, monitorimi pjesëmarrës dhe rishikimi vështrohen si proces që vazhdon për sa kohë zgjat Strategjia.*



## Zbatimi dhe Monitorimi

SRZH në Qarkun e Fierit ka si qëllim krijimin e një kuadri për zhvillim të plotë dhe të duhur dhe manaxhimin e rajonit për të udhëhequr procesin vendim marres në të ardhmen. Vlera e kësaj strategjie do të përcaktohet gjerësisht se sa me sukses rekomandimet e tij do të mbështëten dhe zbatohen në të gjitha nivelet e Qeverisjes, organizatat rajonale dhe bashkësia. Zbatimi me sukses i SRZH do të varet nga nga vazhdimësia e bashkepunimit midis intersave të ndryshme dhe komunitetet në rajon. Qëllimi i përbashket është të përmiresoj rrethanat në rajon, të panifikojë të ardhmen e tij dhe të manaxhojë me mirë vlerat e tij ambientale, mjedisore, ekonomike dhe sociale.

Kordinimi është elementi kryesor për zbatimin dhe monitorimin e SRZH. Kordinimi i mirë do të lejojë përdorimin më të mirë të burimeve të disponueshme dhe një drejtim më të mirë të përpjekjeve në nivel rajonal dhe kombëtar për të mobilizuar burimet shtese për potesimin e nevojave.

Kjo do të kërkojë një korpërim dhe kordinim midis të gjitha niveleve të qeverisjes, shoqërisë civile, sektorit private dhe bashkësiat. Kekohet e njëjta përgjegjësi për zbatimin e saj së bashku me Këshillin e Qarkut edhe nga organizata të tjera përgjegjëse. Te drejtat dhe kompetencat e agjencive individuale qeverisëse dhe organizatave të tjera zbatuese dhe autoriteteve duhet respektuar, duke përfshirë përgjegjësinë për zhvillim dhe fonde të programeve brenda sferave të interesit.

Për ta lehtësuar zbatimin dhe monitorimin e SRZH do të jetë e nevojshme të krijojme udhëzuesit e duhur dhe të asistojmë në procesin e monitorimit dhe zbatimit. Procesi i monitorimit dhe zbatimit duhet të përdori strukturat administrative dhe organizatat që të mos kemi

një dyfishim dhe mbivendosje të punës, dhe në mënyrë të vazhdueshme të informojë dhe përfshijë qytetarët dhe aktoret. Procesi i përgjithshëm i kordinimit dhe aktivitetet për zbatim është një kërkesë dhe pjesë e formës së strategjisë (SRZH). SRZH dhe zbatimi në vijshmeri mund të shikohet në tre faza (referohu Fig)

### Faza 1. Përgatitja e SRZH

SRZH është një dokument i përgatitur me pjesëmarrjen e qytetarëve dhe aktoreve dhe e aprovuar nga KQ.


### Faza 2. Zbatimi dhe monitorimi

Faza 2 do të përbehet nga tre elemente kryesore. Fillimisht është nevoja të vendosim dhe kordinojmë zbatimin e rezultateve të SRZH që priten të jenë përgjegjëse dhe të kryhen nga KQ dhe agjenci qeveritare dhe organizatat rajonale përkatese. E dyta, SRZH rekomandon studime të metejshme të cilat nevojiten të kryhen në fazën 2 paralelisht me aktivitetet e tjera për zbatim.

Për zbatimin e aktivitetëve dhe puna shtese që mund të kryhet do të japë rezultate si shtimi i informacionit shtese, të dhënave dhe rekomandimeve. Rezultate priten të futen në dokumentin e SRZH në vijim. Duhet të njohim që procesi i monitorimit është një proces në vazhdim dhe duhet të sigurojë përfshirjen e aktoreve dhe qytetarëve.

### Faza 3. Vleresimi dhe rishikimi

SRZH ka nevojë të vleresohet dhe të rishikohet në momente të caktuara nga KQ për të siguruar që ngjallet bashkëhore dhe të rishikohen pjesët që kanë nevojë për ndryshim në kontekstin e kohës.






## Roli dhe aktivitetet

Keshilli I Qarkut do të zbatojë SRZH në kordinim dhe partneritet me aktoret dhe bashkësinë. Për kordinuar zbatimin, vleresimin dhe monitorimin, një përfaqesues I forte I KQ kerkohet. KQ nevojitet të luajë një rol kyesor në bashkërendimin e aktiviteteve, të veprime si “forca drejtuese” në zbatimin, monitorojë ecurinë e bërë në zbatim, të bëjë rishikimin periodik të SRZH që të sigurojë që ajo do të ngelet e tanishme dhe do të reflektojë ndryshimin e situatave, nxisi bashkepunimin midis komuniteteve dhe aktoreve dhe forcimi I bashkepunimit dhe kordinimit midis agjencive dhe aktoreve të tjere.

Struktura Organizative ashtu si dhe funksionet specifike të secilit departament në KQ do të vleresohen në një ushtrim për vleresimin institucional I cili do të udhëhiqet nga KQ. Megjithatë konkluzionet e këtij ushtrimi mund të sjellin ndryshime në strukturën e KQ dhe mund të parashikohet nga KKZHQ do të jetë pjesë e kësaj strukture dhe do të luajë një rol në monitorimin dhe zbatimin e SRZH dhe në sigurimin e keshillave mbi probleme që mund të lindin gjatë procesit. Për më tepër ZPZH ose njësi të tjera kyce bashkërenduese në KQ do të kenë një rol kyç në bashkërendimin e aktoreve dhe procesin e zbatimit dhe monitorimit. Do të ketë për detyrë manaxhimin e bazave të të dhënave për të monitoruar progresin dhe për të shpërndarë informacionin për përfshirjen e aktoreve dhe qytetareve.

Takime të rregullta të KQ në të cilin bashkësia dhe aktoret janë të ftuar të marrin pjesë, duhet të organizohen në mënyrë të rregullt për të diskutuar ecurinë në zbatimin e kësaj strategjie. Grupi I kordinim zhvillimit, krijuar me qëllimin që të përfshijë organizatat për zhvillim kombëtare dhe nderkombëtare në Rajoon e Fierit (OJF-te Kombëtare dhe nderkombëtare donatore etj.) në planifikimin e zhvillimit brenda kuadrit rajonal, do të luajë një rol të rëndësishëm për përdorim efektiv të burimeve në projektet e zhvillimit e cila do të ketë si qëllim të arrijë objektivat e përcaktuara në SRZH

Baza e të dhënave të KQ e cila fillimisht është krijuar në 2000 me mbështetjen e USAID dhe Bankes Botërore, dhe plotësimin më tej nga PQV-PNUD me hartat GIS. Informacioni duhet të përditesohet dhe të sistemohet në një program të caktuar. Kjo do të përmbajë linjen baze për monitorimin dhe treguesit e zgjedhur në procesin planifikues të SRZH për arritjen e OM-ve. KQ e ka njohur problemin që ka lidhje me mbledhjen e të dhënave të besueshme dhe të shumëllojshme dhe ka caktuar fonde në buxhetin e këtij viti për të kryer sondazhe sic duhet për SRZH. Kjo praktike tregon kapacitetin dhe angazhimin e KQ për të siguruar sondazhe periodike që do të nevojiten për të monitoruar treguesit e SRZH. SRZH do të jetë përgjegjëse për të kordinuar dhe përditesuar këto baze të të dhënash dhe informacioni.





**Sondazh i opinionit  
publik**


shtojca |




## Përmbledhje e përfundimeve Rrethet e Mallakastrës, Lushnjes dhe Fierit - Korrik 2003

### • Numri i pyetsorëve të analizuar:

Një total prej 2000 pyetsorësh u shpërndanë dhe 1969 u mbledhën në tre rrethe, nga të cilët 360 në zona urbane dhe 1609 në zona rurale.



### • Karakteristikat e personave që u përgjigjën



Nga ata që dhanë përgjigje 54 % ishin meshkuj dhe 46% femra. Shumica e të intervistuarve 75%, ishin të grupmoshës 25-64 vjeç. Grupet e pakicës përbëjnë 4% të atyre që u përgjigjën.

### • Rezultatet e pyetsorit

#### Pyetje:A jeni dakord me përcaktimin mbi vizionin e zhvillimit në Fier?

Po: 1949

Jo: 15

Nuk u përgjigjën: 5

#### Pyetje:A keni ndonjë koment shtesë?

Duhet të punojmë për të arritur këtë vision sa më shpejt të jetë e mundur.

Duhet të ketë angazhim të madh të qeverisë për të arritur këtë vision.

**Pyetje:A jeni dakord me pesë fushat parësore të Strategjisë: reduktimi i varfërsisë, përmirësimi i kushteve të arsimit, nxitja e barazisë gjinore, sigurimi i qëndrueshmërisë mjedisore dhe përmirësim i qeverisjes?**

---

**Po:** 1969

**Jo:** 0

Shënim: përgjigjet e mëposhtme janë grupuar dhe vendosur sipas paraqitjes së tyre në pyetsor.

**Pyetje:A ka ndonjë temë që nuk është identifikuar dhe ju mendoni se është e rëndësishme për Qarkun e Fierit? Nëse po, cila është ajo:**

---

- Përcaktimi si prioritet i zhvillimit të zonave rurale.
- Lufta kundër papunësisë
- Hapja dhe rikonstruktimi i qendrave rikrijuese për të rinjtë dhe fëmijët.
- Rrugët, sistemi i ujësjellësit, energjia elektrike në zona rurale.
- Zhvillimi i infrastrukturës, ujësjellësit, sistemit të ujitjes, shkollave të mira, zonave sportive dhe mundësia e marrjes së kredive nga fermerët.
- Ujë dhe drita 24 orë në ditë.

**Pyetje: Çfarë veprimi/strategjie ju rekomandoni për të trajtuar temën që ju e vlerësoni si shumë të rëndësishme?**

---

- Përfshirje e komunitetit Roma në zbatimin e kësaj strategjie.
- Fokus në reduktimin e varfërsisë ekstreme në pakicat Roma.
- Rritje e mundësive të punësimit për personat e shkolluar nga komuniteti Roma.

--	--

---

# shitojca 2

---





**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**MINISTRIA E FINANCEVE**  
**DREJTORIA E SKZHES**

Blv. "Deshmoret e Kombit"

Tel/Fax: 04 269 649

Data 01.08.2003

**Per:** Z. Ilir Dano  
Kryetar i Qarkut  
Fier

**Subjekti:** Perputhshmeria e objektivave dhe masave te Strategjise rajonale te zhvillimit te Qarkut te Fierit me Strategjine Kombetare te Zhvillimit Ekonomik dhe Social.

Strategjia Kombetare e Zhvillimit Ekonomik dhe Social perben dokumentin themelor qe percakton objektivat afatgjata te zhvillimit ekonomik dhe social te vendit, objektivat afatmesme si dhe planin e masave publike prioritare per arritjen e ketyre objektivave.

Ne kuader te bashkepunimit te Drejtorise se Strategjise Kombetare te Zhvillimit Ekonomik dhe Social me institucionet rajonale lokale persa i perket perputhshmerise se Objektivave te SKZHES dhe atyre te strategjive rajonale, jane zhvilluar nje sere takimesh me perfaqesues te Qarkut te Fierit dhe te Programit te Qeverisjes Vendore te PNUD, konkretisht Z. Shaqir Kurti shef i Zyres se Programimit dhe Zhvillimit, Qarku Fier dhe Znj. Roberta Losio, kordinatore e qarkut, Programi i Qeverisjes Vendore, PNUD dhe perfaqesues te Drejtorise se SKZHES-se.

Keto takime jane zhvilluar si ne zyrat tona tek Ministria e Financave ashtu edhe zyrat e programit te Qeverisjes Vendore te PNUD-it.



Pas nje shqyrtimi te draftit te Strategjise Rajonale te Fierit ne perputhje me OZHM (Objektivat e Zhvillimit te Mijevjecarit) te hartuar nga Qarku Fier ne asistencen dhe mbeshtetjen e Programit te Qeverisjes Vendore, PNUD, dhe si rezultat i ketyre takimeve, mund te themi se shihet nje perputhje e objektivave te ketij plani rajonal zhvillimi me ato te SKZHES. Kuptohet qe duke qene nje plan rajonal eshte edhe me i detajuar ne lidhje me rrethin e Fierit, por perseri keto dokumenta jo vetem qe nuk bien ne kundersiztim me njeri-tjetrin por ecin ne drejtime paralele.

**Adrian CIVICI**  
  
**DREJTOR**

--	--

# shtojica 3





REPUBLIKA E SHQIPERISE  
KESHILLI I QARKUT FIER

1442  
25/08/03

V E N D I M

Nr 24 Date 22.08.2003

Ne mbeshtetje te ligjit Nr 8652 date 31/07/2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" neni 13 mbi funksionet e Qarkut, Keshilli I Qarkut Fier ne mbledhjen e tij te dates 22.08.03, pasi diskutoi mbi Strategjine Rajonale te Zhvillimit te Qarkut:

V E N D O S I:

Te miratoje "Strategjine Rajonale te Zhvillimit" te Qarkut sipas materialit te pergatitur nga seksioni I Programim Zhvillimit ne bashkepunim me UNDP/LGP.



Ilir DANO

Kryetar



## Referencat

Commission of the European Communities. 2001. *Report from the Commission to the Council on the work of the EU/Albania High level Steering Group, in preparation for the negotiation of a Stabilization and Association Agreement with Albania*. Brussels.

Council of Ministries – Republic of Albania. 2001. *National Strategy for Socio-Economic Development*. Tirana.

Council of Ministries – Republic of Albania. 2003. *Progress report for implementation 2002, objectives and long term vision of the NSSED, priority action plan for 2003*. Tirana.

Ministry of Local Government and Decentralization. 2003. *Policy Document on Council of the Region's role*. Albania.

Republic of Albania. National Committee for Decentralization. 1999. *National Strategy for Decentralization and Local Autonomy*. Tirana.

Republic of Albania. 2003. *Strategy for the improvement of live conditions of the Roma minority – draft proposal*. Tirana.

Sen, Amartya. 1999. *Development as Freedom*. Oxford University Press, New York.

UNDP (United Nations Development Programme). 2002. *Human Development Report. Deepening Democracy in a fragmented world*. New York.

UNDP (United Nations Development Programme). 2003. *Human Development Report. Millennium Development Goals: a compact among nations to end human poverty*. New York.

UNDP (United Nations Development Programme). 2002. *Linkages between the National Strategy for Socio Economic Development, Stabilization and Association Agreement, and the Millennium Development Goals. Position paper*. Tirana.

UNICEF (United Nations Children's Fund). 2001. *National Strategy for Children (5 years plan)*. Tirana.

United Nations General Assembly. 2000. *United Nations Millennium Declaration. Resolution adopted by the General Assembly*. New York.

World Bank/FAO. 2002. *Rural Development Strategy. Underpinning Growth and Sustainable Development*. Tirana.

Ministry of Territorial Adjustment and Tourism. 2003. *Water Supply and Sanitation Strategy- Draft version*. Tirana.